

CËNUESHMËRIA E POLITIKËS SHQIPTARE NGA NDËRHJRJET E HUAJA

Qershor 2024

Ky studim u përgatit nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI) në partneritet me Qendrën për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare (CIPE) si pjesë e projektit ***"Shqipëri: Të ndërtojmë integritetin zgjedhor dhe qëndrueshmërinë e partive politike ndaj ndikimit të jashtëm destabilizues"***. Projekti u financua nga Zyra e Mbretërisë së Bashkuar për Punët e Jashtme, Komonuelthin dhe Zhvillimin (FCDO) nëpërmjet Ambasadës Britanike në Tiranë. Pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të NDI-së, CIPE-s ose të donatorit.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
KONTEKSTI: NDËRHYRJET E HUAJA NË SHQIPËRI DHE NË BALLKANIN PERËNDIMOR	8
OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	12
RRUGA 1: FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE	16
a. Si shfaqen ndërhyrjet e huaja në kontekstin e financimit të fushatave zgjedhore?	16
b. Cilat janë cënueshmëritë institucionale kryesore të sistemit të financimit të partive politike në Shqipëri?	21
RRUGA 2: MANIPULIMI I MJEDISIT TË INFORMACIONIT	27
a. Si shfaqet kjo ndërhyrje?	27
b. Cilat janë cënueshmëritë institucionale kryesore në Shqipëri?	35
RRUGA 3: FLUKSET E KAPITALIT GËRRYES	42
a. Si shfaqet kjo ndërhyrje?	42
b. Cilat janë cënueshmëritë institucionale madhore në Shqipëri?	46
SHTOJCAT	50
Shtojca 1: Rekomandime	50
Shtojca 2: Stoku i IHD-ve	54
Shtojca 3: Tregtia – Mallrat e importuar	55



01

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KONTEKSTI: NDËRHYRJET E HUAJA NË SHQIPËRI

Parandalimi i ndërhyrjeve të huaja është thelbësor për mbrojtjen e parimeve të demokracisë, duke siguruar që procesi politik të mbetet i lirë, i drejtë dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve. Anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe ndjekja e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) kanë siguruar një shkallë mbrojtjeje ndaj ndërhyrjeve të huaja. Megjithatë, vendi nuk është i paprekshëm nga ndërhyrjet e huaja të mundshme. Për shkak edhe të mungesës së hulumtimeve lidhur me ndërhyrjen e huaj në politikën shqiptare, të kuptuarit e objektit, natyrës dhe ndikimit të ndërhyrjeve të huaja, Shqipëria nuk ka mundur të hartojë akoma një strategji të mirë-strukturuar kundërveprimi. Mostrajtimi i ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike dhe zgjedhore mund të çenojë besimin te demokracia dhe vlerat e saj, të dobësojë institucionet demokratike dhe të lëkundë themelet e qeverisjes demokratike. Ky studim ndjek një qasje parandaluese duke u mbështetur te përvojat e vendeve të tjera dhe hartëzimin e rrugëve për ndikim që po shfrytëzohen aktualisht, si dhe ato që mund të synohen në të ardhmen. Gjithashtu, ai paraqet rekomandime që synojnë mbylljen e hendeqeve që mund të përdorin fuqitë e huaja me interesa për të destabilizuar progresin e Shqipërisë në drejtim të integritetit në BE.

Për shkak të vendndodhjes strategjike dhe rëndësisë në tregtinë dhe sigurinë evropiane, Ballkani

Perëndimor është shndërruar në një fushëbetejë të rëndësishme në konkurrencën për pushtet global. Këto vende po preken gjithnjë e më shumë nga ndikimi i Kinës dhe Rusisë, në veçanti duke qenë se e ardhmja e tyre për integrim në institucionet evropiane politike dhe të sigurisë mbetet e pasigurt. Qëllimet strategjike të Rusisë në Ballkanin Perëndimor përfshijnë ndërprerjen e nismave të mbështetura nga Perëndimi për demokratizim dhe paqe rajonale, mbështetjen e qëndrimit pro-rus në Serbi, varësinë energjetike të rajonit nga gazi rus dhe pengimin e zgjerimit të mëtejshëm të NATO-s. Nga ana tjetër, Kina synon të krijojë dhe mbrojë infrastrukturën tregtare që lehtëson qarkullimin e mallrave kineze në Bashkimin Evropian. Investimet kapitale kineze krijojnë edhe ndërvarësi të konsiderueshme ekonomike dhe marrëdhënie me elitat politike vendase, duke i dhënë Kinës epërsinë që mund të përdoret për qëllime politike më të gjera

Rritja e polarizimit global dhe rënia relative e ndikimit perëndimor në arenën ndërkombëtare kanë fuqizuar fuqitë rajonale, siç janë Turqia, Hungaria dhe shtetet e Lindjes së Mesme, si Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite dhe Irani. Këta aktorë rajonalë kanë fituar ndikim të konsiderueshëm, duke u mundësuar atyre të ndikojnë te përpjekjet për demokratizim dhe të vendosin prani të konsiderueshme në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë. Shqipëria është një nga kombet më properëndimore në rajonin e Ballkanit, duke shërbyer si një qendër kryesore për nisma të ndryshme sigurie të SHBA-së dhe BE-së, e projektuar për ta afruar rajonin më ngushtë me Perëndimin. Roli i saj proaktiv dhe konstruktiv në formësimin e politikave rajonale, përfshirë nismat lidhur me paqen, pajtimin, reduktimin e varësisë për energji nga Rusia dhe mbrojtjen e infrastrukturës ekonomike jetike nga ndikimi kinez, e kanë vënë atë në shënjestër për ndërhyrje të huaja.

Shqipëria ka ndasi dhe dobësi të ndryshme socio-politike që e bëjnë atë të ndjeshme ndaj ndërhyrjeve të huaja. Këto përfshijnë problemet me shtetin e së

drejtës, mosbesimin social¹, polarizimin politik por dhe diversitetin fetar. Ekonomia e Shqipërisë po përballlet aktualisht me disa nevoja të paplotësuara për investime² që pengojnë rritjen dhe zhvillimin e saj të përgjithshëm. Mangësitë financiare shfaqen në disa fusha kritike, si infrastruktura, kujdesi shëndetësor, arsimi, shërbimet sociale, duke kufizuar mundësinë e vendit për të ofruar shërbime bazë dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët e tij. Duke pasur parasysh të ardhmen e pasigurt për anëtarësimin në BE, këto mangësi e bëjnë Shqipërinë të prekshme ndaj ndikimit financiar nga regjimet autoritare që kërkojnë të zgjerojnë ndikimin e tyre gjeopolitik nëpërmjet mjeteve ekonomike. Vendndodhja gjeografike strategjike e Shqipërisë që kufizohet me tregun e BE-së, së bashku me cënueshmëritë socio-ekonomike vendase, ka krijuar kushte të favorshme për krimin e organizuar ndërkombëtar, që mund të shfrytëzohet si një shteg për ndërhyrje të huaja.

Ky studim përdor një proces analitik rigoroz, që mbështetet në shqyrtimin e gjerë të dokumentacionit dhe në intervista me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë. Ai shqyrton cënueshmëritë nga ndërhyrjet e huaja nëpërmjet tre rrugëve kryesore: *financimit të fushatave zgjedhore; manipulimit të mjedisit të informacionit dhe flukseve të "kapitalit gërryes"*. Nëpërmjet krahasimit të përvojave të vendeve të tjera dhe se si mund të ndodhin këto ndërhyrje në Shqipëri, studimi synon të hedhë dritë mbi shfaqjet e mundshme në kontekstin shqiptar.

RRUGA 1: FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE

Aktorët e huaj kanë shfrytëzuar një shteg specifik për të ndërhyrë në politikën e brendshme të një shteti të caktuar duke financuar “palë të treta” (subjekte jogaruese në fushata zgjedhore), sidomos nëpërmjet reklamave për zgjedhjet në media sociale.

Legjislacionit zgjedhor të Shqipërisë, që ngjason me atë të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, i mungon rregullimi për shpenzimet e “palëve të treta”. Ky boshllëk ligjor i lejon këta aktorë me burime të dyshimta financimi që të ndikojnë në fushatat zgjedhore. Prania e burimeve të paidentifikuara dhe të fshehta pas reklamave në mediat sociale gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 dhe 2023 tregon një cënueshmëri reale ndaj ndërhyrjeve të huaja në zgjedhjet e ardhshme në Shqipëri³. Për trajtimin e kësaj çështjeje nevojiten nisma ligjore, sidomos në kontekstin e përdorimit të gjerë të reklamave digjitale për qëllime të fushatës zgjedhore. Legjislacioni që rregullon financimet e partive dhe të zgjedhjeve kërkon garanci shtesë për zbatimin efektiv. Këtu përfshihet përmirësimi i përkufizimeve ligjore të subjekteve financuese, duke autorizuar raportim financiar më të shpeshtë dhe më të detajuar të partive politike, dhe duke vendosur sanksione më të rrepta, përfshirë kriminalizimin e financimeve të huaja të paligjshme

Qeveritë e huaja përdorin instrumente specifike për të kanalizuar burime për politikanët dhe partitë politike, përfshirë subjekte tregtare (të regjistruar si persona fizikë ose juridikë); “skemat e dhuruesve fiktivë”; dhe/ose kriptomonedhat. Ka pak të dhëna të drejtpërdrejta që tregojnë se këto kanale janë përdorur për të ndikuar në zgjedhjet në Shqipëri. Megjithatë, ka mundësi që këto lloj ndërhyrjesh të jenë duke ndodhur ose mund të ndodhin në një të ardhme të afërt për shkak të mangësive ligjore apo zbatimit të dobët të ligjeve për zgjedhjet.

Kuadri ligjor aktual për financimin e partive politike dhe të fushatave zgjedhore krijon hapësira që subjekte të huaja të financojnë parti politike nëpërmjet shoqërive guaskë (persona juridikë). Meqenëse sipas raporteve financiare të partive politike, dhurimet nga personat juridikë për qëllime të fushatave politike janë të rralla, Shqipëria mund të ndjekë shembullin e shumë

1 Kryesisht për shkaqe historike që lidhen me periudhën e komunizmit.

2 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

3 <https://balkaninsight.com/2021/06/01/untold-story-dark-money-israeli-advisers-and-an-albanian-election/>

vendeve evropiane për të ndaluar dhurimet nga personat juridikë.

Legjislacioni i Shqipërisë që rregullon kriptomonedhat është ende në hapat e parë dhe nuk parashikon kritere transparence për transaksionet. Ligjet që rregullojnë zgjedhjet duhet të marrin në konsideratë ndalimin e dhurimeve dhe shpenzimeve në kriptomonedha përpara se të shfaqen si problem.

Zbatimi i duhur i ligjeve të financimit politik kërkon edhe rritje të kapaciteteve, burimeve dhe mandatit ligjor për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe funksionimin e koordinimin të strukturuar të tij me një larmi organesh të tjera shtetërore me funksione mbikëqyrëse. Duhet të përcaktohet një format i koordinimit ndërinstitutional, si për shembull me organe që rregullojnë çështje të pastrimit të parave ose të medias.

RRUGA 2: MANIPULIMI I MJEDISIT TË INFORMACIONIT

Marrëdhënia simbiotike ndërmjet pronarëve të medias, biznesit dhe politikës pengon gazetarinë profesionale në interes të publikut në Shqipëri. Më konkretisht, shkalla e lartë e informalitetit në sektorin e medias dhe niveli i ulët i transparencës/mbikëqyrjes së financimeve të mediave dhe çështjet e konfliktit të interesit në Shqipëri, krijojnë hapësirë dhe vend për financim nga aktorë të huaj. Gjithashtu, në botën e medias *online* shumë të parregulluar, pronësia anonime krijon hapësirë për pandëshkueshmëri dhe për mungesë transparence lidhur me dezinformimin e pakontrolluar.

Operacionet e dezinformimit të Rusisë kanë hapësirë të kufizuar për të përdorur “pushtetin e butë” dhe për të promovuar pikëpamjet e Kremlinit në Shqipëri për shkak të orientimit të qartë gjeopolitik të vendit drejt Perëndimit. Megjithatë, ka një hapësirë të bollshme

për të ‘ndotur’ fshehurazi mjedisin e informacionit në mënyrë të tillë që të ushqejë narrativat vendase në përputhje me objektivat taktike ruse si dhe për të fuqizuar aktorët dhe rrjetet që mund të kthehen në aktorë politikë me të drejtë vetoje. Megjithëse mediat si RT dhe Sputnik nuk publikojnë në shqip, fushatat e tyre të dezinformimit dhe narrativat pro Kremlinit vazhdojnë ende të mbërrijnë te audiencat shqiptare nëpërmjet burimeve të palëve të treta, duke çuar përpara më zgjuars qëllimet e politikës së jashtme të Kremlinit, edhe pse me pak fakte lidhur me ndikimin e tyre.

Në shumë demokraci, përpjekjet ruse për luftën e dezinformimit kanë dëshmuar se kanë mbështetur grupe dhe rrjete ekstremiste që promovojnë narrativa kundër të drejtave të grave dhe të individëve që i përkasin komunitetit LGBTQI+, si një portë hyrëse për t’u dhënë shtysë kompleteve antiperëndimore te konservatorët socialë. Këto narrativa janë pasqyruar disi edhe në Shqipëri gjatë viteve të fundit për shkak të një larmie aktorësh dhe rrjetesh mjaft aktive me akses në median tradicionale dhe në mediat *online*, që janë mjaft të cenueshme ndaj titujve bombastikë mashtrues dhe lajmeve të rreme. Megjithatë, nuk ka të dhëna të qarta që tregojnë se këto narrativa në Shqipëri po mbështeten drejtpërdrejt nga fushatat e dezinformimit rus. Përkundrazi, mjedisi vendas dhe tensionet shoqërore ekzistuese ofrojnë terren që këto narrativa të shfaqen dhe të përhapen.

Narrativat mediatike që kanë vënë në pikëpyetje besueshmërinë e zgjedhjeve dhe integritetin e institucioneve në Shqipëri, sidomos reforma në drejtësi e sponsorizuar nga Perëndimi, kanë qenë të njohura në Shqipëri. Megjithëse këto narrativa janë në masë produkt i polarizimit politik vendas, sulmeve të sponsorizuara nga grupe interesi vendase ose i padrejtësive të vërteta qytetare me institucionet e dobëta, ato janë ushqyer, me raste, nga ndërhyrje të dyshuara të huaja nëpërmjet sulmeve kibernetike⁴.

Përpjekjet e diplomacisë publike kineze në Shqipëri, që synojnë të ndërtojnë një imazh pozitiv të vendit, me sa duket po japin fryte nëpërmjet bashkëpunimit të strukturuar me platforma mediatike në Shqipëri, marrëdhënieve me gazetarë miqësorë me Kinën, si dhe bashkëpunimit kulturor nëpërmjet Institutit Konfuci. Në vend të angazhimit në dezinformim të menjëhershëm, Kina e shfrytëzon praninë e saj mediatike (Radioja Ndërkombëtare e Kinës) si një mjet propagande për të projektuar një imazh të favorshëm dhe për të rritur ndikimin e saj global. Megjithëse ndikimi mund të mos jetë i konsiderueshëm për momentin, nuk mund të shpërfilllet mundësia për ndikim.

Turqia është një aktor tjetër rajonal me një gjurmë mediatike, përpjekjet e së cilës për dezinformim përqendrohen kryesisht te shënjestrimi i drejtuesve të Komunitetit Mysliman në Shqipëri, që ajo i konsideron të lidhur me “rrjetin e Gylenit”. Në vitet e fundit, media të ndryshme *online* në Shqipëri kanë treguar afërsi dhe lidhje gjithnjë e në rritje me Turqinë. Edhe pse këto kanale mediatike nuk janë domosdoshmërisht me ndikim ose mjaft popullore, ato paraqesin narrativa urrejtjeje ose publikojnë përmbajtje propagandistike që favorizon Turqinë dhe denigron rivalët ose kundërshtarët e saj politikë. Një bashkëpunim i kohëve të fundit ndërmjet transmetuesve publikë të Shqipërisë dhe Turqisë ka ngritur shqetësime për rëndim të propagandës turke në Shqipëri.

Propaganda e Iranit në Shqipëri, kryesisht e shpërndarë nëpërmjet medias së sponsorizuar nga shteti, si “Pars Today” në gjuhën shqipe, përqendrohet te promovimi i interesave gjeopolitike dhe narrativave ideologjike të Iranit. Këtu përfshihet portretizimi i Mujahedin-e-Khalq (MEK) si një organizatë terroriste dhe që kritikon vendet perëndimore. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ndikimi i përgjithshëm i propagandës së Iranit në Shqipëri mbetet i kufizuar.

Vendimmarrësit, organizatat mediatike, komuniteti gazetaresk, shoqëria civile dhe palët e tjera përkatëse

të interesit, siç janë institucionet e pavarura, duhet të punojnë së bashku për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie më të madhe për pronësinë e mediave, financimet dhe konfliktin e interesit. Ata duhet të intensifikojnë përpjekjet për vetërregullim, duke mbështetur gazetarinë në interes të publikut dhe duke zhvilluar programe formale dhe joformale që nxisin edukimin mbi median dhe informimin. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos kufizojë lirinë e shprehjes dhe që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Organet shtetërore në Shqipëri duhet të bëjnë përpjekje konkrete në drejtim të përafrimit të legjislacionit me Aktin Evropian të Shërbimeve Digjitale dhe Aktin për Lirinë e Medias, si një qasje e përshtatshme kur bëhet fjalë për ndryshimet e mundshme ligjore për trajtimin e dezinformimit.

Është thelbësore që në Shqipëri të nxitet një mjedis mediatik i qëndrueshëm, i cili mbështet lirinë e shprehjes, pluralizmin dhe pavarësinë mediatike duke përmirësuar kushtet e punës së gazetarëve, duke luftuar vetëcensurimin dhe duke trajtuar përqendrimin e pronësisë mediatike dhe aksesin e kufizuar në informacionin publik. Forcimi i kapaciteteve të redaktorëve dhe gazetarëve për të identifikuar dhe luftuar narrativat e huaja të dëmshme, së bashku me mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve, përfshirë kontrollin e fakteve dhe qëndrueshmërinë e sigurisë kibernetike, janë hapa të rëndësishëm për trajtimin e dezinformimit në Shqipëri.

RRUGA 3: FLUKSET E KAPITALIT GËRRYES

Megjithëse nuk janë konstatuar investime të huaja direkte (IHD) të konsiderueshme nga burime të njohura kapitali gërryes, Shqipëria nuk është e paprekshme nga risku që elitat vendase të angazhohen në transaksione me individë dhe subjekte të huaja me agjenda të fshehta. Shkalla e disa projekteve të investimit, sidomos ato në pasuritë e paluajtshme, si dhe partneritetet publike-private (PPP), të cilave

4 <https://faktoje.al/shqiperia-pre-e-sulmeve-kibernetike/>
<https://www.reporter.al/2023/09/25/sulm-i-ri-kibernetik-mbi-institucionet-publike-dhe-private-ne-shqiperi/>

shpesh u mungon transparenca, krijojnë hapësirë për kanalizimin e kapitalit gjërryes, i cili mund të përdoret për të ndikuar në politikën shqiptare.

Gjurmët e IHD-ve kineze në Shqipëri janë relativisht modeste në krahasim me praninë e tyre në disa vende të tjera në Ballkanin Perëndimor. Shumë nisma nuk janë konkretizuar dhe disa investitorë kinezë në sektorë strategjikë janë tërhequr, duke ulur mundësinë për varësi politike. Liderhipi politik i Shqipërisë ka qenë skeptik për përfitimet ekonomike të bashkëpunimit nëpërmjet formatit 16+1⁵, por ka vijuar të jetë pjesë e grupit për të mbajtur një dialog me Pekinin.

Shqipëria ka një regjim të hapur të investimeve të huaja të parashikuar për të tërhequr IHD-të, por i mungon një mekanizëm i vlerësimit formal, i cili do të kufizonte ose ndalonte IHD-të që kërcënojnë sigurinë kombëtare ose rendin publik. Shqipërisë i nevojitet legjislacion i ri që krijon një Mekanizëm të Shqyrtimit të Investimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, i cili siguron mbrojtjen e duhur për sigurinë kombëtare dhe rendin publik, dhe mbron konkurrueshmërinë.

Flukset e kapitalit gjërryes mund të përfitojnë nga abuzimet me masat mbrojtëse në Marrëveshjet e Investimeve Ndërkombëtare (IIA). Gjuha e IIA-ve duhet të përditësohet për të qartësuar të drejtën sovranë për të mbrojtur rendin publik, sigurinë kombëtare dhe sektorët e ndjeshëm ekonomikë dhe strategjikë. Agjencitë qeveritare dhe autoritetet e pavarura duhet të përmirësojnë koordinimin dhe të sigurojnë përputhshmëri rregullatore në rastin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare, caktimin e statusit të Investitorit Strategjik, zbatimin e dispozitave të Pronarit të Vetëm Përfitues (PVP) dhe konkurrencën e tregut.

5 Bashkëpunimi ndërmjet Kinës dhe vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (Kinë-EQL, Kinë-EQL, gjithashtu 14+1; më parë 17+1 nga 2019 në 2021 dhe 16+1 nga 2021 në 2022) është një nismë e Ministrisë së Punëve të Jashtme Kineze, për të promovuar marrëdhëniet e biznesit dhe investimeve midis Kinës dhe 14 vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL, EQL): Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Greqia, Hungaria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia dhe Sllovenia..

6 "Russia and China are Penetrating Balkan's at West's Expense [Rusia dhe Kina po depërtojnë në Ballkan në kurriz të Perëndimit]." Balkan Insight.

02

KONTEKSTI: NDËRHYRJET E HUAJA NË SHQIPËRI DHE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

1. Për shkak të vendndodhjes së tij strategjike dhe rëndësisë në tregtinë dhe sigurinë evropiane, Ballkani Perëndimor megjithëse i vogël, është një pjesë e rëndësishme e fushës gjeopolitike në konkurrencën e madhe për pushtet. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë bërë më vulnerabël nga ndikimi i Kinës dhe Rusisë, si rezultat i perspektivës së paqartë për integrimin e tyre në institucionet evropiane politike dhe të sigurisë.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, fuqi të huaja si Kina dhe Rusia janë bërë më të vendosura dhe strategjike në qasjen e tyre ndaj Ballkanit Perëndimor, duke e parë rajonin si një nga "hallkat e dobëta" në Evropë.⁶ Kjo pikëpamje vazhdon pasi BE-ja e ka ngrirë praktikisht procesin e anëtarësimit deri vonë, ndërkohë që të paktën tre vende mbeten ende jashtë NATO-s. Kjo gjendje "harrese e integritit" për Ballkanin Perëndimor zgjeroi shumë nga cënueshmëritë vendase të rajonit dhe krijoi mundësi për t'u shfrytëzuar nga aktorë të huaj. Humbja e besueshmërisë të kushtëzimi për anëtarësim në BE ka dobësuar vrullin

dhe incentivat për reforma demokratike, duke nxitur llojin e drejtuesve autoritarë. Që prej atij momenti, anëtarësimi në BE ka shërbyer si një instrument i rëndësishëm i paqes. Zbehja e rëndësisë së procedurave të integritit ringriti pyetje për strukturën e sigurisë së rajonit, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi që Rusia të vetëfaktorizohej si një partner dhe aktor i sigurisë. Ritmi i ngadaltë i anëtarësimit në BE e ka privuar rajonin nga burimet e konsiderueshme të financimeve për zhvillim, që ishin jetike për vendet në fazat e hershme të anëtarësimit, duke krijuar një mundësi që Kina të hynte dhe të mbushte këtë hendek.

2. Qëllimet strategjike kryesore të Rusisë në Ballkanin Perëndimor janë: të cenojë proceset e demokratizimit dhe paqes rajonale të sponsorizuara nga Perëndimi; të mbështetë orientimin pro-rus të Serbisë; të ruajë varësinë energjetike të rajonit nga gazi rus dhe të pengojë zgjerimin e mëtejshëm të NATO-s. Roli proaktiv i Shqipërisë në disa prej këtyre çështjeve rajonale e bën atë shënjestër për ndërhyrje ruse.

Rusia është pozicionuar si mbrojtëse e interesave serbe në rajon. Ky perceptim përforcohet shpesh nga kanalet mediatike pro qeverisë në Serbi, që mund të amplifikojnë narrativën e Rusisë si aleat i besueshëm për Serbinë. Ky projektim shërben si një burim i rëndësishëm pushteti për Rusinë në marrëdhëniet e saj me Serbinë, sidomos tek ato segmente të popullsisë që identifikohen fuqimisht me ndjenja nacionaliste, dhe më tej në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Po ashtu, Rusia ka krijuar varësi energjetike të konsiderueshme në rajon, sidomos në Serbi, e cila mbështetet ndjeshëm te gazi rus për ngrohje.⁷ Kremlini nuk e përdor këtë

pushtet për ta tërhequr Ballkanin (madje edhe Serbinë) formalisht në ndonjë nga strukturat e tij gjeopolitike, por synon të ruajë gjendjen aktuale dhe t'i shkaktojë Perëndimit shqetësime për sigurinë në "oborrin" e tij.⁸ Rusia e përdor ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor si pazar me Perëndimin për interesat e saj strategjike në hapësirën post-sovjetike, si për shembull duke bërë krahasime të shpeshta ndërmjet pavarësisë së Kosovës dhe Krimesë, ose Donbasit. Nëpërmjet bashkëpunimit të saj të strukturuar me Serbinë, Rusia ka fuqi efektive vetoje për zgjerimin e NATO-s (në Bosnjë Hercegovinë dhe Kosovë) dhe mund të ngadalësojë zgjerimin e BE-së në pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Përpyekjet ruse për të penguar zgjerimin e NATO-s u bënë të dukshme gjatë rolit të saj aktiv në vitin 2018 për të cenuar marrëveshjen ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut në lidhje me emrin e kësaj të fundit⁹, ose me grushtin e shtetit në vitin 2016 në Mal të Zi.¹⁰ Një element kryesor i strategjisë së Rusisë është të ruajë ndikimin e saj në Serbi dhe të pengojë rrugën e saj drejt Perëndimit. Ajo synon ta arrijë këtë duke i mbajtur tensionet etnike në rajon në nivele të larta, sidomos marrëdhëniet shqiptaro-serbe, si dhe duke penguar përpyekjet e drejtuara nga Perëndimi, të cilat do të mundësonin zgjidhjen e konflikteve dypalëshe dhe etnike.¹¹ Kjo gjë e lejon atë të mbajë gjallë kërcënimin për konflikte etnike brenda dhe përreth kufijve të NATO-s. Kjo është arsyeja se përse Rusia vazhdon të jetë një nga aleatët e natyrshëm të forcave nacionaliste reaksionare në të gjithë rajonin, që promovon gjendjen aktuale dhe tërheq dhe amplifikon në mënyrë aktive narrativat e tyre. Për shkak të pushtetit të saj të projektuar, Rusia shpesh instrumentalizohet dhe përdoret nga drejtuesit rajonalë si "përbindëshi" për të shantazhuar

7 "Serbia 'in a hurry' to reduce energy dependence on Russia [Serbia në ngut për të ulur varësinë energjetike nga Rusia]." Financial Times.

8 "Russia's Strategic Interests and Tools of Influence in the Western Balkans [Interesat strategjike të Rusisë dhe instrumentet e ndikimit në Ballkanin Perëndimor]" – NATO STRATCOM.

9 "Tensions Escalate Between Greece and Russia, with Macedonia in the Middle [Përshkallëzohen tensionet ndërmjet Greqisë dhe Rusisë, me Maqedoninë në mes]" – New York Times.

10 "Russian Malign Influence in Montenegro: The Weaponization and Exploitation of History, Religion and Economics [Ndikimi i dëmshëm rus në Mal të Zi: armatimi dhe shfrytëzimi i historisë, fesë dhe ekonomisë]." Qendra për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS).

11 "In the Western Balkans, the West is trying to push Russia out [Perëndimi përpiqet ta nxjerrë Rusinë jashtë Ballkanit Perëndimor]." Washington Post.

Perëndimin dhe për të lehtësuar presionin mbi reformat e demokratizimit.

3. Qëllimi strategjik i Kinës në Ballkanin
Perëndimor është të zhvillojë dhe sigurojë akses në infrastrukturën tregtare që do të lehtësonte hyrjen e mallrave kineze në Bashkimin Evropian. Prania e kapitalit kinez krijon edhe varësi të konsiderueshme ekonomike dhe marrëdhënie me elita politike që i japin Kinës pushtet, që mund të përdoret për qëllime të tjera politike.

Objektivi kryesor i Kinës në Ballkanin Perëndimor është zhvillimi i Rugës Ekspres Tokë-Det (LSER), që është një komponent i Nismës “Brez dhe Rugë” (BRI), e cila do të rriste kapacitetin e portit të Pireut në pronësi të kinezëve për të shërbyer si një qendër për kalimin e mallrave kineze në BE nëpërmjet Evropës Qendrore.¹² Kina ka investuar edhe në logjistikë në vendet në kufi me Ballkanin Perëndimor, si në Slloveni, Kroaci dhe Hungari, si pjesë e përpjekjeve për ta shndërruar LSER-në në një rrjet të konsoliduar transporti. Qëllimi i dytë kryesor është rritja e gjurmës së investimeve ekonomike kineze dhe lidhjeve politike, sidomos me Serbinë, duke parë rëndësinë e saj në rajon. Strategjia ekonomike përfshin edhe zhvillimin e varësive, përfshirë përdorimin e financimeve për zhvillim, që ishte një problem i mprehtë sidomos për Malin e Zi.¹³ Në saxe të përmirësimit të besimit reciprok nëpërmjet varësisë ekonomike, BRI-ja synon të sigurojë një hapësirë të favorshme strategjike për Kinën në planin afatgjatë.¹⁴ Gjithashtu, ajo synon të zgjerojë peshën diplomatike të Kinës në arenën ndërkombëtare duke shtuar numrin e vendeve që votojnë pro për çështje që kanë lidhje me Kinën. Megjithëse Rusia shihet shpesh si një kërcënim më i ngutshëm për sigurinë, politika e Kinës mund të

shihet më gjerë duke krijuar gradualisht një ekosistem ndikimi, përfshirë shitjen e teknologjisë ushtarake ose të mbikëqyrjes, zhvillimin e lidhjeve akademike dhe kulturore, i cili do ta bënte atë një aktor të rëndësishëm në formësimin e së ardhmes së rajonit.¹⁵

4. Rritja e polarizimit të shumëfishtë dhe rënia relative e pushtetit perëndimor në nivel global kanë fuqizuar fuqitë rajonale, përfshirë Turqinë, Hungarinë dhe shtetet e Lindjes së Mesme, si Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabinë Saudite dhe Iranin, që të shfaqen si aktorë të rëndësishëm me ndikim; që të cenojnë reformat për demokratizim dhe që të zhvillojnë peshë dhe prani të konsiderueshme në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Një anëtar i NATO-s, konkretisht Turqia, nuk ofron projekte gjeopolitike alternative dhe nuk perceptohet si një vend që dëshiron të ndërpresë aspiratat transatlantike të Shqipërisë ose rajonit. Turqia e konsideron Ballkanin Perëndimor kryesisht si një treg eksporti dhe destinacion për investime. Megjithatë, Turqia kërkon që të ruajë në mënyrë aktive ndikimin mbi popullsinë myslimane në rajon nëpërmjet investimeve humanitare dhe kulturore, përfshirë krizat si Covid-19 dhe tërmetet e fundit në Shqipëri. Turqia nxit edhe dezinformimin që ushqen kultin e Erdoganit dhe që promovon statusin e pushtetit të Turqisë dhe aspiratën për t’u bërë drejtuese globale e vendeve islamike (duke nxitur tërthorazi narrativat kundër Perëndimit), si dhe përpjekjet e Erdoganit për të ndërtuar lidhje të forta personale me drejtues rajonalë.¹⁶ Ndikimi mbi popullsinë myslimane dhe lidhjet personale me drejtuesit përdoren shpesh për qëllime transaksionale të bashkëpunimit për çështje me rëndësi për Erdoganin, dhe një çështje e tillë që është shfaqur në Shqipëri lidhet me masat

ekstragjyqësore për të spastruar institucionet e lidhura me rrjetin e Gylenit, siç pohohet nga Turqia, ose për investime nga biznese që janë miqësore me regjimin turk (të pranishme në të gjithë rajonin).¹⁷ Gjithashtu, Turqia i sheh marrëdhëniet me Shqipërinë si të rëndësishme nga prizmi i konkurrencës së saj me Greqinë. Po ashtu, Hungaria është bërë një aktor i rëndësishëm që e konsideron Ballkanin Perëndimor të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e saj dhe kërkon të ndikojë në zhvillimet e tij. Një nga qëllimet e shumta të qeverisë autoritare të Viktor Orbanit është të ushqejë lidhjet e ngushta me regjimet dhe partitë e ngjashme në rajon. Ky qëllim është bërë i dukshëm në mbështetjen e tij publike ndaj Vuçiç, Dodik dhe ish-kryeministrit në arrati të Maqedonisë së Veriut, Nikola Gruevski.¹⁸ Irani ka zhvilluar një fokus mjaft antagonist në Shqipëri në sajë të strehimit të lëvizjes opozitare MEK dhe e ka akuzuar qeverinë shqiptare për mbështetje të terrorizmit, duke e lejuar MEK-un të ushtrojë veprimtarinë në territorin e saj. Nga ana tjetër, Emiratet e Bashkuara Arabe e kanë zgjeruar praninë e tyre prej më shumë se një dekade, përgjithësisht përmes huave dhe investimeve private në projekte të pasurive të paluajtshme, kryesisht në Serbi,¹⁹ por edhe në zhvillimin e madh të pasurive të paluajtshme në Shqipëri.²⁰

5. Shqipëria është ndoshta vendi më pro-perëndimor në Ballkanin e gjerë që shërben si një qendër dhe platformë për shumë nisma të SHBA-së dhe BE-së për sigurinë, të cilat synojnë ta orientojnë rajonin sa më pranë Perëndimit. Roli aktiv dhe konstruktiv i Shqipërisë në formësimin e politikës rajonale, nga çështjet e paqes dhe pajtimit, te reduktimi i varësive të energjisë nga Rusia, te mbrojtja e infrastrukturës

ekonomike kritike nga Kina, e bën atë shënjestër për ndërhyrje të huaja.

Pozicioni gjeopolitik i Shqipërisë si një pikë hyrëse nga Adriatiku dhe Joni në Ballkan, si dhe prania e shqiptarëve etnikë në katër shtete të tjera në rajon²¹, e bëjnë atë një faktor të rëndësishëm në strukturën e sigurisë së Ballkanit Perëndimor. Si një vend anëtar i NATO-s që prej vitit 2009, Shqipëria ka filluar që prej dhjetëvjeçarit të fundit që të kalojë nga roli i saj tradicional si konsumator i sigurisë perëndimore, drejt shndërrimit në një lider më aktiv i sigurisë dhe një shtyllë e zgjerimit të NATO-s dhe BE-së. Shoqëria dhe politika shqiptare përqafojnë pothuajse në mënyrë instinktive qëndrimet pro NATO-s dhe pro BE-së për çështjet kryesore dhe ndjekin një agjendë konstruktive në rajon që është kryesisht në përputhje me Perëndimin. Në përgjithësi, Shqipëria është vetëpozicionuar rregullisht si një bastion kundër ndikimit rus në rajon²² dhe shërben si një bazë dhe platformë kryesore e shumë nismave perëndimore të sigurisë. Kjo është e dukshme sidomos nga pikëpamja ushtarake, por edhe si pjesë e përpjekjeve të gjera të SHBA-së dhe BE-së për ta shkëputur Ballkanin Perëndimor nga varësia ndaj burimeve energjetike ruse. Shqipëria ka ndjekur një politikë të matur bashkëpunimi me Kinën, e cila është pasuar me lëvizje si heqja e regjimit të vizave për shtetasit kinezë²³, por edhe ngërçe politike që kanë tkurrur numrin e investimeve kineze.

6. Shqipëria ka ndarje dhe cenueshmëri të konsiderueshme socio-politike që krijojnë hapësirë për ndërhyrje të aktorëve të huaj. Këtu përfshihen: diversiteti i saj fetar; pikat e dobëta në shtetin e së

12 “China’s approach to the Western Balkans [Qasja e Kinës ndaj Ballkanit Perëndimor]”. Instituti Clingendael.
13 “How A Chinese-Built Highway Drove Montenegro Deep Into Debt [Si një autostradë e ndërtuar nga kinezët e zhyti në borxh Malin e Zi]”. NPR.
14 Po aty
15 “Beyond Economic Considerations: New Frontiers of Chinese Influence in the Western Balkans [Përtej konsideratave ekonomike: kufij të rinj të ndikimit kinez në Ballkanin Perëndimor]” – Sbunker dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
16 “Transition to what? Western Balkans democracies in a state of illiberal equilibrium [Kalim në çfarë? Demokracitë e Ballkanit Perëndimor në një gjendje ekuilibri joliberal]” – Sbunker ->

17 Po aty
18 “Balkan Csardas: Hungarian Foreign Policy Dance [Kërcim hungarez në Ballkan: vallëzim hungarez i politikës së jashtme]” – Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë.
19 “Serbia: The UAE’s Best Friend in the Balkans [Serbia: miku i ngushtë i Emirateve të Bashkuara Arabe në Ballkan]” – Gulf International Forum.
20 “Albania, UAE-based Eagle Hills in 2 bln Euro deal for Durres port expansion [Shqipëri, Eagle Hills me bazë në UAE marrëveshje 2 miliardë eurosh për zgjerimin e portit të Durrësit]” – SEE News.
21 Katër shtetet janë: Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.
22 “Albania pitches itself as bastion against Russian influence [Shqipëria vetëpozicionohet si bastion kundër ndikimit rus]”, B92.
23 “Albania Backs Scrapping Visas for Chinese in Snub to EU [Shqipëria mbështet heqjen e vizave për kinezët si mospërfillje ndaj BE-së]” – Balkan Insight. ->

drejtës; si dhe shkalla e lartë e mosbesimit social dhe polarizimit politik.

Shoqëria shqiptare është e larmishme në aspektin fetar, e megjithatë është homogjene në aspiratat e saj properëndimore dhe laike në orientimin e saj për shkak të trajektores historike unike në të cilën u ndërtua identiteti shqiptar. Epërsia e identitetit etnik mbi përkatësinë fetare siguron një burim të fortë qëndrueshmërie kundër përpjekjeve të huaja për të nxitur ndasitë me motive fetare ose etnike, edhe pse disa cënueshmëri janë shfrytëzuar nga grupe ekstremiste. Një tjetër pikë e cënueshmërisë janë institucionet e gjyqësorit dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri, të cilat u janë nënshtruar reformimit të vazhdueshëm për shkak të korrupsionit të konsiderueshëm, duke siguruar pandëshkueshmëri të klasës politike dhe elementëve të krimit të organizuar. Një reformë madhore e gjyqësorit, e sponsorizuar nga Perëndimi, ka prishur deri tani shumë interesa edhe pse nuk i ka përmbushur plotësisht pritshmëritë e publikut. Këto pakënaqësi kanë krijuar një terren të favorshëm për aktorët e huaj për të rrezikuar reformat demokratike dhe për të ushqyer narrativa kundër Perëndimit. Shoqëria shqiptare karakterizohet nga një nivel i lartë polarizimi politik dhe një shkallë e lartë mosbesimi ndërpersonal, me narrativa përçarëse të amplifikuara nga një skenë mediatike klienteliste. Këto elemente të shoqërisë shqiptare cenojnë institucionet shtetërore dhe sociale, zvogëlojnë kapacitetin social për konsensus dhe krijojnë një mjedis shumë të favorshëm për lulëzimin e propagandës.

7. Ekonomia e Shqipërisë ka nevojë të paplotësuar për investime, që në kontekstin e të ardhmes së anëtarësimit të ngadaltë në BE krijojnë hapësirë për flukse të kapitalit gjërryes nga regjimet autoritare. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë që kufizon tregun e BE-së dhe cënueshmëritë e saj socio-ekonomike vendase ka krijuar një terren të favorshëm për krimin e organizuar ndërkombëtar, i cili mund të shërbejë si një kanal për ndërhyrje të huaja.

Shqipëria është një vend me ekonomi në zhvillim të vrullshëm me mangësi të konsiderueshme në infrastrukturën publike, hapësirë të kufizuar fiskale dhe nevojë për IHD. Megjithatë, ritmi i ngadaltë i aderimit në BE ka ulur shumën e financimeve të BE-së që ishin të disponueshme për vendet në fazat e mëparshme të aderimit. Në kontekstin e legjislacionit të dobët dhe të shtetit të dobët të së drejtës, mbështetja e Shqipërisë te partneritetet publike-private për investimet në infrastrukturë dhe lulëzimi i sektorit të ndërtimit (mjaft informal) krijojnë një hapësirë të konsiderueshme për flukset e kapitalit gjërryes (shihni përkufizimin në Kutizën 1), që mund të përdoret për të ndikuar në politikën e saj. Normat mbresëlënëse të rritjes ekonomike të Shqipërisë në dekadat e fundit nuk janë përkthyer në kushte më të mira sociale për të gjithë. Ka një përqendrim gjeografik të përjashtimit dhe cënueshmërisë ekonomike: kushtet sociale dhe ekonomike janë ndjeshëm më të këqija në pjesën veriore rurale dhe në “periferitë urbane” brenda rajonit më të pasur ndërmjet Tiranës dhe Durrësit.

Kutiza 1: Përkufizimi i kapitalit gjërryes

Qendra për Ndërmarrjet Private Ndërkombëtare (CIPE) e përshkruan termin gjërryes si “flukse të kapitalit të paqartë që i mungon orientimi në treg, me motive për të shfrytëzuar mangësitë në qeverisje për të ndikuar në zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale në vendet përfituese”. Investimet që vijnë nga regjime autoritare që janë të lidhura në mënyrë të pandashme me keqqeverisjen në vendet përfituese mund të identifikohen si kapital gjërryes. Demokracitë e cënueshme janë në risk infiltrimi nga kapitali gjërryes që mund të rrisë varësitë e borxhit dhe të arrijë motive politike kryesore, duke aprivat. Një studim i mëparshëm, i mbështetur nga CIPE, hulumtoi efektet e investimeve gjërryese në Maqedoninë e Veriut, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi, duke raportuar për pasoja negative ekonomike dhe mjedisore të investimeve kineze në rastet e autostradës nga Bari në Boljare në Mal të Zi, autostradës Kichevo-Ohër në Maqedoninë e Veriut, dhe ndotjes së ajrit në qytezën e Borit në Serbinë lindore. Ky studim nuk e përfshin Shqipërinë.

Pozicioni strategjik i Shqipërisë si një portë hyrëse në tregun e BE-së (duke u kufizuar me dy vende anëtare të BE-së, me Greqinë dhe Italinë), i ndërthurur me institucionet e saj të dobëta dhe cënueshmëritë sociale kanë ofruar mundësi për grupet e krimit të organizuar, shumë prej të cilëve me lidhje ndërkombëtare, që të depërtojnë thellë në shoqëri, ekonomi dhe politikë.

03 OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

8. Çështja e ndërhyrjeve të huaja në politikën e Shqipërisë është përgjithësisht e re, për të cilën ka kufizime të konsiderueshme në kërkime/të dhëna. Ky studim ndjek një qasje parandaluese duke identifikuar cënueshmëritë që po shfrytëzohen aktualisht dhe që mund të synohen në të ardhmen, duke u bazuar te përvojat e vendeve të tjera. Studimi i shqyrton ndërhyrjet e huaja nga një pikëpamje më e gjerë, jo si të kufizuara te proceset zgjedhore, por si diçka që formëson vazhdimisht rezultatet politike.

Studimi i ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike në mbarë botën ka qenë subjekt i kërkimeve të thelluara në vitet e fundit. Megjithatë, në Shqipëri ajo është një çështje e kohëve të fundit për të cilën ka vetëm disa studime të kufizuara. Mungesa krahasuese e kërkimeve ekzistuese përbënte një sfidë lidhur me përcaktimin e objektit të çështjeve për t’u përfshirë si cënueshmëri kryesore në këtë vlerësim. Për këtë qëllim, ekipi i ekspertëve i angazhuar në këtë detyrë, ndërmori shqyrtime të brendshme dhe

një seri konsultimesh paraprake me palë kyçe të interesit, përfshirë partitë politike, shoqërinë civile, ekspertët dhe zyrtarët e administratës zgjedhore²⁴ me qëllim fokusimin e duhur të objektit të studimit. Nëpërmjet këtyre konsultimeve paraprake, ekipi i kërkimit arriti në dy përfundime kryesore. Së pari, mungesa e të dhënave të qarta dhe të vazhdueshme për ndërhyrjet e huaja e bëri atë disi joefektiv për t’u përfshirë në hartëzimin e detajuar të rasteve në Shqipëri. Nga ana tjetër, duhet t’i kushtohet vëmendje masave parandaluese, duke u mbështetur te mënyra se si këto ndërhyrje kanë ndodhur në vende të tjera. Së dyti, përqendrimi vetëm te ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore do të shpërfillte me gjasë format më të rëndësishme të ndikimit të huaj që formësojnë ekonominë, median dhe politikën e përgjithshme të Shqipërisë. Nga ana tjetër, këto ndikime të mëdha prekin më shumë rezultatet në zgjedhje sesa veprimtaritë gjatë fushatës. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e politikës shqiptare, përfshirë financimin e fushatave, zhvillohet nëpërmjet kanaleve joformale, është thelbësore që të merret në konsideratë roli i madh i aktorëve të huaj.

9. Ky studim bazohet në një proces analitik metodik rigoroz dhe në shqyrtimin e gjerë të dokumentacionit dhe në intervista me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë. Ai shqyrton cënueshmëritë e ndërhyrjeve të huaja nëpërmjet tre rrugëve kryesore: financimit të fushatave zgjedhore; manipulimit të mjedisit të informacionit dhe flukseve të kapitalit gjërryes. Ai tregon se si po shfaqen aktualisht këto ndërhyrje në Shqipëri dhe në vende të tjera demokratike; ai nxjerr në pah cënueshmëritë institucionale kryesore të Shqipërisë dhe jep rekomandime se si duhen trajtuar ato.

“Ka mjaftueshëm para në vend; politikanët shqiptarë nuk kanë nevojë për para të huaja për të financuar fushata” – kjo ishte përgjigjja e përgjithshme nga opinioni i ekspertëve për pyetjen lidhur me rolet e aktorëve të huaj në politikën shqiptare. Kjo i referohet shpesh

dominimit të burimeve vendase, si ato nga bizneset e mëdha ose krimi i organizuar. Megjithatë, duke qenë se shumica e asaj që ndodh në ekonominë dhe politikën shqiptare është e zhytur në informalitet, përfshirë financimin e mediave; financimin e fushatave ose projektet e mëdha të ndërtimit, dhe për vetë faktin se krimi i organizuar mund të ketë karakter ndërkombëtar, mungesa e transparencës krijon hapësirë që elementë të huaj t'i shfrytëzojnë cenueshmëritë. Për më tepër, pjesa më e madhe e ndërhyrjeve, si për shembull ato në hapësirën mediatike, mund të ndodhin në formën e “kontributeve në natyrë” nga aktorë dhe media të huaja, siç është nxitja e narrativave të caktuara. Të gjitha këto


elemente janë marrë në konsideratë për përcaktimin e tre rrugëve kryesore të ndërhyrjeve të huaja në zgjedhje (Grafiku 1). Studimi përdori një qasje me faza për t'i kuptuar këto rrugë (shihni Grafikon 2). Analiza u bazua gjerësisht te shqyrtimi i dokumentacionit dhe te një larmi intervistash me ekspertë vendas (gjithsej 45 intervista gjysmë të strukturuar) që u zhvilluan gjatë periudhës maj-qershor 2023. Intervistat u zhvilluan me ekspertë të njohur nga bota akademike dhe shoqëria civile, puna e të cilëve përqendrohet te legjislati i zgjedhor, media, çështjet ndërkombëtare, siguria, tendencat e investimeve, etj. Ekipi i NDI-së intervistoi edhe persona kyç nga institucionet shtetërore përkatëse.

Rrugët e ndërhyrjeve të huaja në politikën shqiptare

	VEPRIMTARITË DEZINFORMUESE TË HUAJA DASHAKEQE	FLUKSET E KAPITALIT GËRRYES NGA AKTORË TË HUAJ DASHAKEQË	FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE
MJETET	• SULMET KIBERNETIKE (SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE) • GJENERIMI I PËRMBAJTJES • TROLL-ET E PAVËRTETA NË INTERNET	• IHD-TË NË SEKTORËT STRATEGJIKË • PPP-TË NË INFRASTRUKTURËN PUBLIKE • INVESTIMET NË PRONAT E PATUNDSHME	• MBËSHTETJA E DREJTPËRDREJTË E FUSHATAVE ZGJEDHORE • SHPENZIMET E PAVARUARA
PËRDORIMI	AMPLIFIKIMI I NARRATIVAVE	KANALIZIMI I BURIMEVE FINANCIARE	
NDIKIMI	KONTRIBUTET E TËRTHORTA DHE TË DREJTËPËRDREJTA PËR RRJETET POLITIKE/AKTORËT ME INTERESA TË MBIVENDOSUR NË SHQIPËRI		

Grafiku 1: Rrugët e ndërhyrjeve të huaja në politikën shqiptare

Procesi analitik (fazat)



Grafiku 2: Proceset (fazat) analitike

04

RRUGA 1: FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE DHE FUSHATAVE ZGJEDHORE

a. Si shfaqen ndërhyrjet e huaja në kontekstin e financimit të fushatave zgjedhore?

10. Aktorët e huaj kanë zhvilluar mënyra të shumta për të shfrytëzuar boshllëqet ligjore dhe/ose për të shkelur ligjet për financimin e partive politike për të ndërhyrë në zgjedhje në vende të tjera. Megjithëse faktikisht nuk ka raste të gjykuara plotësisht për këtë çështje në nivel ndërkombëtar (dhe vetëm pretendime për këtë veprimtari në Shqipëri), ndërhyrjet e huaja nëpërmjet financimit të partive politike kanë qenë subjekt i studimeve të besueshme në vende të tjera, të cilat janë përdorur për të hedhur dritë mbi cënueshmëritë e sistemit të fushatave zgjedhore në Shqipëri.

Studimi ndikues ("studimi i fshehtë") i Aleancës për Sigurimin e Demokracisë mbi paratë e huaja të fshehta për të financuar ndërhyrjet politike²⁵ paraqet një analizë të thelluar të rrugëve të përdorura për këto ndërhyrje, bazuar në një shqyrtim të gjerë të raportimit me burime të hapura. Objekti i problemit është i rëndësishëm dhe gjithnjë në rritje. Megjithëse zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në SHBA dhe referendumi i vitit 2016 i Mbretërisë së Bashkuar mbi anëtarësimin në BE janë ndoshta shembujt më të njohur, janë identifikuar mbi 100 raste të këtyre ndërhyrjeve në më shumë se 30 vende, me një rritje drastike në shpeshtësi në shtatë vitet e fundit.²⁶ Raportet zgjedhore të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE-ODIHR) në vitet e fundit kanë përfshirë rekomandime për vendet për trajtimin e paqartësive në legjislacionin për financimin e fushatave zgjedhore,²⁷ udhëzimin e organeve mbikëqyrëse për të rritur besueshmërinë e raportimit mbi dhurimet në natyrë, rregullimin e fushatave zgjedhore të palëve të treta dhe për rritjen e kapaciteteve dhe autoritetit të organeve mbikëqyrëse. Megjithëse jo të synuara për ndërhyrje të huaja në vetvete, është e lehtë të shohësh se si këto lloje pikash të dobëta mund të shfrytëzohen nga shtete të huaja që kërkojnë t'u shmangen ndalimeve mbi financimet e huaja të partive politike dhe zgjedhjeve. Kanalet kryesore të ndërhyrjes që kanë lidhje me kontekstin shqiptar janë përcaktuar në grafikun 3 më poshtë:

Mënyrat e financimit të huaj (in) direkt të partive politike dhe fushatave



Grafiku 3: Rrugët për financimet e huaja indirekte (direkte) të partive politike dhe fushatave

Gjatë gjithë intervistave të zhvilluara për këtë studim, pjesëmarrësit pretenduan shpesh se partitë politike në Shqipëri vazhdimisht nuk përfshijnë dhurime dhe shpenzime të caktuara në raportet e tyre që i dorëzojnë KQZ-së, gjë që përbën mosraportim dhe/ose mosvlerësim të saktë të dhurimeve në natyrë. Ata pretendonin edhe se shqyrtimi nga KQZ-ja i raporteve është i pamjaftueshëm dhe se praktikën e mosraportimit të plotë kalojnë pa u zbuluar. Shembulli i cituar më shpesh për të ilustruar se si këto praktika mbulojnë bërjen publike të financimeve me burime të huaja përfshinte pagesat e supozuara për lobim nga ligjvënësit amerikanë. Pretendimet²⁸ përqendrohen te pagesat e bëra ndaj lobistit dhe të raportuara prej

tij te autoritetet amerikane në vitin 2017 për punën e zhvilluar në emër të një partie opozitare shqiptare. Burimi i fondeve të përdorura në këto pagesa duket se lidhet me një shoqëri guaskë të regjistruar në Skoci, në pronësi të dy shoqërive guaskë (në Belize) me shtetas rus në pozicione drejtuese. Këto pagesa nuk u përfshinë në raportet e financimit të fushatave të partive politike. Nëse pagesat janë bërë për të paguar kostot e lobimit të partisë me dijeninë e partisë, ato do të ishin dhurime në natyrë që ligjërisht do të duhej të përfshiheshin në raportin e zgjedhjeve të partisë si kontribute dhe shpenzime të partisë.²⁹

11. Një rrugë tjetër specifike që aktorët e huaj e kanë përdorur për të ndërhyrë në politikën e vendeve është duke financuar shpenzimet e subjekteve joganues në fushata zgjedhore (të njohur edhe si "palë të treta"), në veçanti për reklama në media sociale. Legjislacioni i Shqipërisë, i ngjashëm me atë të vendeve të tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nuk rregullon shpenzimet e "palëve të treta", gjë që krijon hapësirë për subjektet joganues me burime të dyshimta financimi për t'u përfshirë dhe për të kontribuar në fushata zgjedhore. Fenomeni i reklamave në mediat sociale nga burime të paidentifikuara dhe të paqarta, i vënë re në zgjedhjet e vitit 2021, tregon se ai është një hapësirë reale për ndërhyrje të huaja në zgjedhjet e ardhshme në Shqipëri. Nevojiten përpjekje legjislative për të trajtuar çështjen e shpenzimeve të palëve të treta, përfshirë reklamat digjitale.

Në garat zgjedhore në shumë vende gjatë dekadës së fundit është konstatuar rritje e shpenzimeve për fushata zgjedhore nga subjekte apo individë që nuk garojnë në zgjedhje si kandidatë ose parti politike (p.sh., si "subjekte joganues" ose "palë të treta") dhe që veprojnë në mënyrë të pavarur prej tyre. Për shembull, shpenzimet nga joganuesit gati u dyfishuan në Mbretërinë e Bashkuar nga viti 2010 deri në 2019. Aktualisht, ka pasur një rritje dramatike të përdorimit të mediave sociale në fushatat zgjedhore. Në rastin e Letonisë, këto

25 "Covert Foreign Money [Paratë e huaja të fshehta]" Aleanca për Sigurimin e Demokracisë, Fondi Gjerman Marshall. Shihni edhe, "Legal Loopholes and the Risk of Foreign Interference [Boshllëqet ligjore dhe risku për ndërhyrje të huaja]", Parlamenti Evropian ->

26 Po aty në 1.

27 Për rekomandime lidhur me trajtimin e paqartësive ligjore, shihni raportet përfundimtare të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it për zgjedhjet e hershme presidenciale dhe zgjedhjet parlamentare në Serbi të datës 3 prill 2022, zgjedhjet parlamentare dhe referendumin në Hungari të datës 3 prill 2022, dhe zgjedhjet vendore në Maqedoninë e Veriut në datat 17&31 tetor 2021. Raporti përfundimtar i Ekspertëve të Zgjedhjeve i ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare në Estoni të datës 5 mars 2023 përfshiu nevojën për të ofruar udhëzime mbi dhurimet në natyrë. Për rekomandime lidhur me rritjen e kapaciteteve të organeve mbikëqyrëse, shihni raportet përfundimtare të ODIHR-it për zgjedhjet presidenciale në Çeki të datës 13&14 janar 2023, zgjedhjet presidenciale/parlamentare në Bosnjë-Hercegovinë të datës 2 tetor 2022 dhe zgjedhjet e hershme presidenciale dhe parlamentare në Bullgari të datës 2 prill 2023. Të gjitha raportet janë të disponueshme në faqen e internetit të ODIHR-it, në adresën <https://www.osce.org/odihr/elections/121544>.

28 <https://www.motherjones.com/politics/2023/11/lulzim-basha-albania-russia-biniatta-trade/>

29 Nëse pagesat janë bërë për ta ndihmuar partinë në zgjedhje, por pa dijeninë e partisë, ato do të ishin shpenzime të palëve të treta, që aktualisht janë të parregulluara në Shqipëri.

shpenzime u rritën nga 69,296 euro në vitin 2010 deri në 294,405 euro në vitin 2018.³⁰ Shembulli i SHBA-së nga viti 2016 (shihni tekstin në Kutizën 2) mund të jetë një nga fushatat politike *online* më të hershme dhe më të mirëdokumentuara të paguara nga aktorë të huaj. Pavarësisht disa veprimeve të ndërmarra nga platformat e mediave sociale për ta trajtuar këtë çështje, ka pasur raste të shumta të fushatave të reklamave *online* të ndërmarra nga Rusia, Kina, Irani dhe vende të tjera që prej vitit 2018, që përfshinin vende në Evropën Perëndimore, Ukrainën, Ballkanin Perëndimor dhe disa vende afrikane.³¹

Kutiza 2:
Rasti i zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA³²

Zgjedhjet e vitit 2016 në SHBA janë një shembull i mirëdokumentuar i aktorëve të huaj që shpenzojnë shuma të mëdha parash për reklama me pagesë në media sociale për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

Agjencia e Kërkimit në Internet (IRA), një organizatë ruse e financuar nga oligarku rus Yevgeniy Prigozhin dhe shoqëritë e tij të tjera, ndërmorën një operacion të gjerë për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale në SHBA me qëllim favorizimin e fushatës së Donald Trump-it. Krahas krijimit të llogarive të rreme dhe një larmie grupesh në mediat sociale, IRA shpenzoi rreth 100,000 dollarë për më shumë se 3,500 reklama në Facebook. Megjithatë, reklamën me pagesë përfaqësonin vetëm një pjesë të vogël të fondeve që IRA shpenzoi për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në SHBA, mbulimi i tyre ishte i konsiderueshëm dhe u përdorën për të rritur audiencën për postimet e saj organike. Pretendohet se këto reklama “mund të kenë ndihmuar që përmbajtjet e IRA-s të arrinin aq shumë shikues amerikanë sa votuan realisht në zgjedhje.”

Ka pak informacione zyrtare lidhur me objektin e shpenzimeve të palëve të treta në Shqipëri, pasi reklamën në mediat sociale janë të parregulluara. Megjithatë, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) monitoroi reklamën në mediat sociale në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 në Shqipëri dhe konstatoi se u shpenzuan rreth 40,000 dollarë për reklama në mediat sociale nga burime të paidentifikuara. Kjo tregon se fenomeni i palëve të treta është tashmë i pranishëm në mjedisin politik shqiptar dhe është një rrugë lehtësisht e aksesueshme për ndërhyrje të huaja. Pa rregullim, shtetet e huaja mund të paguajnë fshehurazi për fushata keqinformimi të parashikuara për të ndikuar në fushatën zgjedhore, mund të advokojnë drejtpërdrejt pro ose kundër partive dhe kandidatëve, dhe/ose të mbështetin grupe që ndërmarrin veprimtari përçarëse në zhvillimin e fushatave.

Në shumë juridiksione, përfshirë Shqipërinë, shpenzimet e palëve të treta nuk janë rregulluar dhe në juridiksione të tjera, objekti i rregullimit është i ngushtë.³³ Përkufizimi i medias në Kodin Zgjedhor të Shqipërisë është mjaft i kufizuar pasi nuk përkufizon median sociale, por përqendrohet vetëm te media tradicionale. Në mungesë të rregullimit, nuk ka mbikëqyrje qeveritare mbi burimin ose shumën e fondeve të shpenzuara nga palët e treta.³⁴ Mungesa e rregullimit krijon mundësi për anashkalimin e rregullave të vendosura mbi kandidatët dhe partitë politike. Në shumicën e juridiksioneve nuk ka rregulla ose ka rregulla të pamjaftueshme për identifikimin e atyre që autorizojnë ose paguajnë për reklama, dhe

për objektin e shpërndarjes. Disa platforma kanë ndërmarrë hapa për ta trajtuar këtë hendek rregullator duke u kërkuar reklamuesve të regjistrohen dhe të krijojnë arkiva reklamimi. Megjithatë, jo të gjitha platformat i kanë miratuar këto masa dhe ka kritika lidhur me efektivitetin e atyre që i kanë zbatuar. Vendet kanë filluar ta trajtojnë hendekun rregullator me rekomandime në pritje të BE, propozime ligjore të prezantuara por jo të miratuara në SHBA dhe ligje për zhvillimin e fushatave të palëve të treta dhe reklamën me pagesë në mediat sociale të miratuara në disa vende, si në Letoni.³⁵ Në mars të vitit 2024, BE-ja prezantoi një rregullore të re për transparencën dhe shënjestrimin e reklamave politike, që synonte luftën kundër manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjeve të huaja në zgjedhje.³⁶ Rregullorja do t’u mundësojë qytetarëve të identifikojnë lehtësisht reklamën politike, të njohin sponsorët e tyre dhe të kuptojnë nëse i kanë marrë reklamën e synuara, duke i fuqizuar në këtë mënyrë për të marrë vendime të informuara. Gjithashtu, kjo do të sigurojë respektimin e të drejtave të privatësisë në reklamën politike dhe do të mbështesë lirinë e mendimit dhe fjalës.

Rekomandime

Duhet të prezantohen rregullime ligjore (ligje dhe akte nënligjore) për të trajtuar çështjen e zhvillimit të fushatës nga palë të treta/jogaruese, përfshirë reklamën digjitale me pagesë. Këto rregullime duhet të përshtaten për të shmangur kufizimin e parregullt të lirisë legjitime të shprehjes.

12. Instrumentet shtesë që qeveritë e huaja kanë përdorur për të kanalizuar burime për politikanët dhe partitë politike përfshijnë subjekte tregtare (të regjistruar si persona fizikë ose juridikë); “skemat e dhuruesve fiktivë”³⁷; dhe/ose kriptomonedhat³⁸. Ka pak të dhëna të drejtpërdrejta që tregojnë se këto kanale janë përdorur për të ndikuar në zgjedhjet në Shqipëri. Megjithatë, ka mundësi që kjo ndërhyrje të jetë duke ndodhur tashmë dhe mund të ndodhë në të ardhmen për shkak të zbatimit të dobët të ligjeve.

Qeveritë e huaja dhe agjentët e tyre njihen për përdorimin e *shoqërive tregtare (njohur edhe si persona juridikë)* si baza për të vendosur praninë e tyre ligjore dhe rrjedhimisht edhe për mundësinë për të dhuruar në vendet e synuara ku lejohen dhurimet nga shoqëritë tregtare. Kërkesat për regjistrimin e një personi juridik varen nga legjislacioni vendas, por në shumë vende me ekonomi tregu, ato nuk janë shumë detyruese. Në fakt, shumë vende, përfshirë Shqipërinë, nuk e ndalojnë krijimin e shoqërive “guaskë” (shoqëri pa asete ose operacione biznesi aktive). Disa vende, përfshirë edhe Shqipërinë, po kërkojnë tashmë më shumë transparencë në lidhje me pronësinë nëpërmjet regjistrave të pronarëve përfitues. Megjithatë, këto rregullore mund të përmbajnë shumë përjashtime, të kërkojnë vetëm bërjen publike të pronarëve përfitues mbi një prag specifik dhe mund të mos monitorohen dhe zbatohen gjithmonë në mënyrën e duhur. Po ashtu, shumë shoqëri tregtare vendase janë filiale të personave juridikë të huaj, duke krijuar mundësi për injektim parash nga shoqëria e huaj mëmë, të cilat më pas mund të përdoren për qëllime të fushatave

30 Shihni International IDEA, “Regulating Online Campaign Finance: Case Study on Latvia” [“Rregullimi i financimit të fushatave online: rast studimor për Letoninë”] në <https://www.idea.int/sites/default/files/regulating-online-campaign-finance-latvia-en.pdf> (vizituar më 29 qershor 2023).

31 Studim i fshehtë në f. 40-43.

32 *Report On the Investigation into Russian Interference in the 2016 Presidential Election* [Raport mbi hetimin e ndërhyrjes ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016] Këshilltari i Posaçëm Robert S. Mueller, <https://www.justice.gov/archives/sco/file/1373816/download> (vizituar më 30 qershor 2023)

33 Vetëm gjashtë vende të OSBE-së kanë rregullore për palët e treta që prej fillimit të vitit 2022 dhe objekti i legjislacionit të këtyre vendeve është i ndryshëm.

34 Tani OSBE-ODIHR përfshijnë rekomandime për rregullimin e shpenzimeve të palëve të treta në raportet e tyre të vëzhgimit të zgjedhjeve, sikurse bëjnë në raportin e tyre për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 në Shqipëri. Shihni <https://www.osce.org/files/f/documents/5/1/493687.pdf> në faqen 17. Shihni edhe Udhëzimet e OSBE/ODIHR / Komisionit të Venecias për rregullimin e partive politike, botimi i 2-të, CDL-AD(2020)032, paragrafët 218 – 222 dhe 255-256. Financimet e palëve të treta në lidhje me fushatat zgjedhore përkufizohen si “[c] shpenzime për fushatë të bëra në mënyrë të pavarur për kandidat ose parti me qëllim promovimin ose kundërshtimin e një kandidati ose partie, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi”. Shihni <https://www.osce.org/files/f/documents/8/1/538473.pdf>.

35 Propozimi për një Rregullore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transparencën dhe shënjestrimin e reklamave politike, (COM(2021) 731 përfundimtar); Propozimi për një Rregullore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për statutin dhe financimin e partive politike evropiane dhe fondacioneve politike evropiane, 25 nëntor 2021, (COM(2021) 734 përfundimtar)

36 Rregullorja e re e BE-së për reklamën politike

37 “Dhurues fiktiv” është një person që ia dhuron paratë e dikujt një kandidati ose partie politike duke përdorur emrin e tij ose saj. Dihet se në shumë vende, dhurues të palejuar, qofshin ata të huaj apo vendas, përfshihen në skema të dhuruesve fiktivë që mund të variojnë nga operacione të përmasave të vogla në ato të mëdha.

38 Financimet e huaja të organizatave bamirëse dhe jofitimprurëse janë identifikuar si një boshllëk tjetër i mundshëm për ndërhyrje të huaja në financat zgjedhore. Kërkesa ndaj organizatave jofitimprurëse për të zbuluar financimet nga burimet e huaja të financimit ka ngjallur shqetësime se disa qeveri po i përdorin këto ligje për të penguar debatin demokratik dhe lirinë e organizimit. Shihni GJEDNJ 2022c, që përfshin Aktin për Agjentët e Huaj Rusë, dhe Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, Komisioni kundër Hungarisë (Transparenca e organizimeve), Çështja gjyqësore C78-18, 18 qershor 2020. Shihni edhe, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2023/702577/EXPO_ATA\(2023\)702577_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2023/702577/EXPO_ATA(2023)702577_EN.pdf). Në kontekstin e shqetësimeve për liritë themelore dhe mundësinë për abuzim që vjen nga kjo rregullore, nuk rekomandojmë që të kërkohej bërja publike e këtyre financimeve për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri në këto momente.

zgjedhore. Studimi ‘Covert’ nxori në pah disa raste kur personat juridikë ishin përdorur si mjete jo vetëm për të shmangur rregullat kundër dhurimeve të huaja, por edhe për ndërhyrje të huaja (p.sh., për të dobësuar shtetin e synuar).³⁹ Ndryshe nga rastet e tjera që përfshijnë shtesa transaksionesh ndërmjet subjekteve të shumta, rasti i *Lev Parnas* dhe *Igor Fruman* është një shembull relativisht i thjeshtë (Shihni Kutizën 3 më poshtë).

Kutiza 3:
Rasti i Lev Parnas-it dhe Igor Furman-it

Në pranverën e vitit 2018, Parnas, Igor Fruman, Andrey Kukushkin dhe Andrey Muraviev, një oligark rus, vendosën të nisnin një biznes që synonte marrjen e licencave të shitjes me pakicë të kanabisit në Shtetet e Bashkuara. Si pjesë e këtij plani, Muraviev ra dakord për t'i dërguar 1 milion dollarë, nëpërmjet një sërë llogarish bankare, Fruman-it dhe Parnas-it për të financuar qindra mijëra dollarë në kontributet politike që ata kishin dhënë ose premtuar për të dhënë përpara zgjedhjeve të nëntorit 2018. Qëllimi i dhurimeve ishte të favorizoheshin kandidatët që mund të ishin në gjendje të ndihmonin PARNAS-in dhe bashkëpunëtorët e tij për të marrë licencat për kanabis dhe marijuanë. Për të fshehur faktin se Maraviev ishte dhuruesi i vërtetë i parave, fondet u dërguan në një llogari bankare biznesi të kontrolluar nga vëllai i Fruman-it dhe më pas dhurimet u bënë në emër të PARNAS-it dhe Fruman-it. Gjithashtu, të tjerë kanë pretenduar se z. Parnas dhe z. Fruman e përdorën më pas aksesin e tyre politik për të shkarkuar ambasadorin e asaj kohe të SHBA-së në Ukrainë dhe se ata “punonin në mënyrë sekrete për rusët dhe ukrainasit për ta ndihmuar Trump-in të merrte informacione për kundërshtarin e tij politik kryesues, Joe Biden, të cilat mund ta dëmtonin këtë të fundit”.

Gjithashtu, ka të dhëna që tregojnë se interesa të huaja i kanë fshehur financimet e tyre duke u dhënë para dhuruesve të ligjshëm që më pas të kontribuonin në financimin e kandidatëve dhe partive politike (dhuruesit fiktivë). Me sa duket këto dhurime vijnë nga dhurues të ligjshëm, por fondet e përdorura nuk vijnë realisht nga dhurues të identifikuar. Ky fenomen nuk kufizohet te dhurimet nga burime të huaja, por mund të përdoret nga burime të paligjshme dhurimesh dhe

është një rrugë e lehtë për t'u përdorur nga qeveri të huaja për injektim parash në fushatat zgjedhore të një vendi tjetër (shihni Kutizën 4).

Kutiza 4:
Rasti i George Nader-it

George Nader, një biznesmen amerikan me lidhje të ngushta me Princin e Kurorës së Emirateve të Bashkuara Arabe, u padit në SHBA për kanalizim të kontributeve nëpërmjet dhuruesve fiktivë në lidhje me zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Nader u shpall fajtor për kanalizimin e mbi 3.5 milionë dollarëve në dhurime të paligjshme për fushata nëpërmjet një biznesmeni nga Kaliforniapër të blerë aksesin dhe ndikimin në Uashington. Dhurimet u drejttoheshin fillimisht komisioneve të veprimeve politike të lidhura me Hillary Clinton dhe më vonë atyre të lidhura me kandidatin fitues Donald J. Trump. Në aktakuzë deklarohet se ai e kishte bërë këtë për të fituar “favor” dhe “mbështetje të mundshme financiare” nga një qeveri e huaj e paspecifikuar, për të cilën shumë persona arritën në përfundimin se ishte Princi i Kurorës i Emirateve të Bashkuara Arabe.

Gjithashtu, *kriptomonedhat* mbeten një industri gjerësisht e parregulluar në Shqipëri, pavarësisht përdorimit të tyre të gjerë në nivel global në dhjetëvjeçarin e fundit. Transaksionet në kriptomonedha shpesh nuk i identifikojnë personat e përfshirë në transaksion në asnjë lloj regjistri transparent ose të aksesueshëm⁴⁰. Kjo liri veprimi krijon terren favorizues për fshehjen e origjinës së huaj të dhurimeve dhe shpenzimeve për fushata zgjedhore, gjë që cenon thelbin e rregullores së financimit të partive politike, konkretisht transparencën. Po ashtu, kandidatët, partitë dhe palët e treta mund t'i përdorin kriptomonedhat për shpenzime fushatash, duke fshehur burimin e vërtetë të fondeve që përdoren për të financuar shpenzimet. Zgjedhjet e vitit 2016 në SHBA japin një shembull se si mund të përdoren transaksionet në kriptomonedha për të mbrojtur origjinën e huaj të fondeve.

39 Studim i fshehtë në f. 25-26 dhe f. 83-84.
40 <https://www.monitor.al/e-ardhmja-e-pastrimit-te-parave-permes-kriptomonedhave/>

Kutiza 5:
Kriptomonedhat dhe hakerimi rus i kompjuterëve të partive politike

Edhe një herë, shqyrtimi i thelluar dhe hetimet penale në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në SHBA përbëjnë një shembull të bazuar në të dhëna. U ngrit një akuzë për një grup rus për hakerimin e kompjuterave të Partisë Demokratike. Akuza detajon se si të paditurit (në emër të shërbimit rus të inteligjencës ushtarake, të njohur si GRU) pastruan para nëpërmjet një serie transaksionesh në kriptomonedha për të blerë ato që nevojiteshin për misionin e hakerimit. Këtu përfshiheshin pagesa për artikuj, si servera, regjistrime në domene dhe shpenzime të tjera të ngjashme.

Në bazë të intervistave me ekspertë vendas, financimet politike vendase të paregjistruara dhe mungesa e mbikëqyrjes së thelluar të rregullave aktuale janë më shqetësuese sesa ndërhyrjet e huaja në financimin e zgjedhjeve dhe partive politike. Kanë dalë disa të dhëna që tregojnë për përdorimin e subjekteve tregtare me pronësi të paqartë në financimin e shërbimeve të lobimit përtej oqeanit për partitë politike shqiptare (shihni Kutizën 6). Gjithashtu, ligjet shqiptare për financimin e partive politike kanë hendeqe që mund të shfrytëzohen nga aktorë të huaj që kërkojnë të ushtrojnë ndikim (shihni seksionin e radhës mbi cenueshmëritë institucionale).

Kutiza 6:
Shembull i financimeve të mundshme të huaja në financimin e partive politike shqiptare⁴¹

Në vitin 2020, Gjykata e Apelit në Tiranë rrëzoi akuzat kundër drejtuesit të Partisë Demokratike dhe dy zyrtarëve të tjerë të nivelit të lartë, lidhur me lobimin në SHBA në vitin 2017. Gjykata e Apelit u pajtua me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se nuk gjeti prova që tregojnë se Partia Demokratike kishte paguar një shumë prej 500,000 dollarësh për lobim, gjë që çoi në mosvërtetimin e të dyja akuzave, atë të falsifikimit të formularëve të deklarimit të pasurisë dhe atë të pastrimit të parave. Prokurorët e Tiranës hetuan një pagesë prej 500 mijë dollarësh për lobistin amerikan Nick Muzin, i cili kishte deklaruar në regjistrimin e tij FARA se pagesa ishte bërë në emër të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Gjykata nuk gjeti prova të besueshme për ekzistencën e një kontrate ndërmjet Partisë Demokratike dhe Muzin-it, dhe për faktin se paratë ishin paguar realisht nga PD-ja.

41 “Kontrata e fshehtë e PD-së me lobistin amerikan, transferta milionëshe përmes kompanisë offshore”. Reporter.al Dosja e lobimit rus, dy vjet pas zvarritjes në sistemin e drejtësisë dhe në fund Basha harrohet - en.Faktoje.al

a. Cilat janë cënueshmëritë institucionale kryesore të sistemit të financimit të partive politike në Shqipëri?

13. Kuadri ligjor aktual për financimin e partive politike krijon hapësira që subjekte të huaja të financojnë parti politike nëpërmjet shoqërive guaskë (persona juridikë). Shqipëria mund të ndjekë shembullin e shumë vendeve evropiane për të ndaluar shprehimisht dhurimet për fushatat zgjedhore nga personat juridikë.

Neni 21 i Ligjit “Për partitë politike” parashikon se “ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike të huaja ose private...,” dhe neni 92/1(1) i Kodit Zgjedhor (2021) lejon vetëm subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre që të marrin financime për fushata zgjedhore nga persona juridikë vendas. Në asnjërin ligj nuk ka përkufizim se çfarë është një “subjekt i huaj” ose “person juridik i huaj”. Gjithashtu, siç u përmend më herët, ligji nuk i ndalon shoqëritë guaskë ose shoqëritë vendase të kontrolluara nga të huaj që të shpenzojnë para për zgjedhjet në Shqipëri. Prandaj, kufizimet aktuale ligjore nuk janë shumë të vlefshme për të penguar përdorimin e personave juridikë si mjet për ushtrimin e ndërhyrjeve të huaja.

Shqipëria mund të ndjekë hapat e vendeve që janë përpjekur të vendosin kufizime kundër dhurimeve nga shoqëritë guaskë dhe/ose për të kufizuar përdorimin e pushtetit ekonomik të shoqërive tregtare në arenën politike. Kjo qasje ka qenë një sukses i dyshimtë. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar (MB), vetëm shoqëritë e regjistruara në MB, të themeluara dhe që ushtrojnë aktivitetin në MB, mund të japin dhurime dhe hua të ligjshme. Megjithatë, termi “ushtrojnë aktivitetin” interpretohet gjerësisht për të përfshirë startup-et dhe shoqëritë guaskë. Nga ana tjetër, ligji mund të ndryshohet për t'u lejuar subjekteve, pronarët përfitues të të cilëve janë shtetas shqiptarë, që të angazhohen në veprimtari të financimit të partive politike. Kjo do të kërkonte zbardhjen e të gjithë

pronarëve përfitues të subjektit ligjor, jo vetëm në kohën e regjistrimit, por edhe kur kryhen shpenzimet për fushata. Ligji shqiptar për krijimin e regjistrit të pronarëve përfitues (ata me interesa 25 për qind) mund të jetë i dobishëm, por kjo qasje do të kërkonte besim te ky mekanizëm dhe zbatimi i tij. Ligji mund të kërkojë që çdo shpenzim nga personat juridikë të financohet nga veprimtaritë e tyre tregtare në Shqipëri. Megjithatë, kjo qasje nuk është e thjeshtë. Do të ishte e vështirë që përfituesit të vlerësojnë ligjshmërinë e dhurimeve kur ato merren dhe kjo gjë do të haste vështirësi në zbatim.

Duke pasur parasysh këto shqetësime, është ndoshta jo befasues fakti që një numër në rritje vendesh i ndalojnë dhurimet nga personat juridikë. Ky është tashmë rasti i 40 për qind të vendeve evropiane dhe 27.2 për qind të vendeve në mbarë botën.⁴² Arsyt kryesore për ndalimin e shpenzimeve për zgjedhje nga personat juridikë janë: 1) sfidat e ndeshura për të dalluar se cilat shoqëri tregtare janë mjaftueshëm “kombëtare/vendase” për të marrë pjesë në procesin zgjedhor; 2) shqetësimi se zërat e tregut ekonomik nuk duhet të dominojnë në tregun politik; dhe 3) nocioni se vetëm ato që kualifikohen për të votuar duhet të dhurojnë ose shpenzojnë para për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.⁴³

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 në Shqipëri, nga raportet përfundimtare të dorëzuara nga tre partitë kryesore politike u konstatua se vetëm shtatë persona juridikë bënë dhurime për fushatën, dhe këto dhurime zinin më pak se 5 për qind të fondeve të përgjithshme të fushatës. Kjo tregon se personat juridikë nuk janë aktualisht një burim i konsiderueshëm i financimeve të pranuar. Rrjedhimisht, mbyllja e këtij hendeku duke ndaluar dhurimet nga këto burime nuk do të kishte një efekt të rëndësishëm te mirëqenia financiare e partive politike. Intervistat e kryera me një larmi bashkëbiseduesish

për këtë studim siguruan mbështetje të rëndësishme për të shtyrë përpara ndalimin e dhurimeve nga personat juridikë.

Rekomandime

Duhet t'i kushtohet vëmendje parandalimit të personave juridikë për të shërbyer si kanale për financimet e huaja. Mënyra më e drejtpërdrejtë për ta ulur këtë mundësi për ndërhyrje të huaja do të ishte ndalimi i dhurimeve dhe i shpenzimeve zgjedhore nga këto subjekte. Mund të jetë e dobishme që të konsultohen autoritetet rregullatore të financimit të partive politike në ato vende evropiane ku janë miratuar këto ndalime, për të përcaktuar nëse kanë sjellë pasoja ose probleme të paqëllimshme. Aktualisht, ligji trajton vetëm ndihmën/dhurimet “e huaja” për partitë dhe kandidatët. Ai nuk i ndalon personat/subjektet e huaja për të bërë shpenzime në lidhje me zgjedhjet. Ky përjashtim duhet të rregullohet me ndryshime ligjore dhe ligji duhet të përfshijë një përkufizim se çfarë do të thotë termi “subjekt i huaj”. Gjithashtu, ligji duhet të përcaktojë se çfarë quhet “dhurim” ose “ndihmë”. Në kuadër të parandalimit, ligji duhet të ndalojë nxitjen/kërkesën e dhurimeve/shpenzimeve të huaja për fushata dhe kjo duhet të përfshihet si vepër penale në Kodin Penal.

14. Regjimi rregullator i Shqipërisë për financimin e partive politike është vulnerabël ndaj skemave të “dhuruesve fiktivë” që mund të fshehin para të huaja. Zgjerimi i objektit të detajeve në deklaratat e dhuruesit dhe rritja e përgjegjësisë penale për deklaratat e rreme nëpërmjet Kodit Penal mund të shërbejnë si element i mundshëm shkurajues për abuzimin me ligjin.

42 <https://www.idea.int/data-tools/question-view/529> (vizituar më 8 maj 2023)

43 Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara mori vendimin kontradiktor, me votimin 5-4, se dispozita për lirinë e shprehjes në kushtetutë e ndalon qeverinë të kufizojë shpenzimet për fushatat politike nga korporatat në çështjen *Qytetarët e Bashkuar kundër Komisionit Federal të Zgjedhjeve* 558 SHBA. 310 (2010).

“Skemat e dhuruesve fiktivë” janë të vështira për t'u zbuluar për shkak të natyrës së tyre të fshehtë, por ka alternativa që duhen marrë në konsideratë për t'u mbrojtur dhe/ose për të zbuluar “dhuruesit fiktivë”. Legjislacioni shqiptar kërkon që dhuruesit të dorëzojnë një deklaratë ku pohohet se ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 92/1 të Kodit Zgjedhor për të bërë dhurime. Dhuruesit duhet të deklarojnë se nuk janë person juridik ose aksionar i tij, që:

- ka përfituar fonde ose kontrata publike;
- ushtron veprimtari në fushën e medias;
- ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ose ka detyrime monetare ndaj shtetit.

Ka hapësirë për të zgjeruar deklaratën e dhuruesit për të kërkuar që këta të fundit të pohojnë se dhurimet vijnë nga fondet e tyre dhe nuk janë në emër të dikujt tjetër. Gjithashtu, mund të jetë e dobishme që të shqyrtohet sanksioni i vendosur për dhuruesit në nenin 173(7) për bërjen e deklaratave të rreme. Aktualisht, sanksioni vendos një gjobë deri në 30 për qind të shumës së dhuruar. Rritja e shumës dhe krijimi i përgjegjësisë së mundshme penale për dhuruesit realë dhe fiktivë mund të shërbejnë si elemente shkurajuese ndaj këtyre skemave.

Zbulimi i skemave të dhuruesve fiktivë është i vështirë. Në disa vende, si në SHBA, dhuruesit duhet të deklarojnë jo vetëm emrin dhe adresën e tyre, por edhe emrin e punëdhënësit të tyre dhe profesionin e tyre. Ky informacion bëhet publik dhe organi mbikëqyrës dhe publiku mund të kenë akses në informacion për modelet që ngrenë dyshime për burimin e vërtetë të fondeve. Megjithëse këto kërkesa raportimi ofrojnë një databazë të pasur informacionesh, ato mund t'i shkurajojnë qytetarët për të dhuruar para nga frika e shpagimit ose hakmarrjes. Në vende të tjera, baza e të dhënave të dhuruesve e organit mbikëqyrës lidhet me bazat e të dhënave të institucioneve të tjera shtetërore, çka mundëson sinjalizimin me anë të “flamujve të kuq” që aktivizohen

kur vihet në dyshim aftësia financiare e dhuruesit për të bërë dhurimin e raportuar (p.sh., kur nuk ka të ardhura të raportuara në autoritetin tatimor ose kur dhuruesi merr ndihmë sociale, etj.).

Shqipëria duhet të parashikojë një vepër të re penale në Kodin Penal lidhur me dhuruesit që dorëzojnë deklaratat të rreme në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore. Vepra penale do ta bëjë më të vështirë që shtetet dhe aktorët e huaj të ndërhyjnë duke frenuar sjelljen kriminale dhe shkurajimin e palëve të treta për të mbështetur aktorët e huaj në atë sjellje. Ajo duhet të parashikojë se deklaratat e rreme të dhuruesve në financimin e zgjedhjeve dhe partive politike në Shqipëri përbëjnë vepër penale që nuk duhet të tolerohet, si dhe të tregojë angazhimin e Shqipërisë për ta trajtuar atë.

Rekomandime

KQZ-ja duhet të marrë në konsideratë ndryshimin e deklaratave të dhuruesve për t'u kërkuar atyre që të pohojnë se po e bëjnë dhurimin nga fondet e veta dhe jo në emër të dikujt tjetër. Po ashtu, rekomandohet ndryshimi i ligjit për të rritur sanksionet ndaj financimit ose lejimit të përdorimit të emrit si dhurues fiktiv. Do të ishte e vlefshme që të shqyrtoheshin alternativat për lidhjen e bazës së të dhënave të dhuruesit të KQZ-së me bazat e tjera publike të të dhënave për të sinjalizuar rastet e dhuruesve fiktivë.

15. Legjislacioni i Shqipërisë që rregullon kriptomonedhat është ende në hapat e parë dhe nuk trajton kërkesat për transparencë të transaksioneve. Ligji për partitë politike dhe Kodi Zgjedhor duhet të ndalojnë dhurimet e kriptomonedhave përpara se ato të shfaqen si problem.

Shqipëria ka miratuar së fundmi një ligj për të rregulluar shoqëritë e kriptomonedhave. Ky ligj u kërkon këtyre subjekteve që të përmbushin disa

kushte të përgjithshme dhe kritere specifike për t'u bërë tregtarë të licencuar të kriptomonedhave. Deri më sot, nuk është regjistruar ende asnjë shoqëri. Megjithatë, ligji nuk trajton kërkesat e transparencës për transaksionet individuale në kriptomonedha. Kjo është një fushë që mund të përdoret për qëllime dashakeqe të ndërhyrjeve të huaja. Gjatë intervistave tona, një bashkëbisedues parashitroi se kriptomonedhat nuk përdoren ende në Shqipëri dhe se do të ishte e parakohshme që kjo çështje të trajtohej tani. Bashkëbiseduesit e tjerë ishin më mbështetës për të ndërmarrë masa parandaluese tani. Rregullimi i kriptomonedhave zgjerohet qartësisht përtej përdorimit të tyre për qëllime politike dhe do të duhet kohë për t'u zhvilluar. Megjithatë, një zgjidhje mund të ishte ndryshimi i Kodit Zgjedhor dhe Ligjit "Për partitë politike" për të ndaluar të gjitha transaksionet në kriptomonedha kur bëhet fjalë për dhurimet dhe shpenzimet zgjedhore/të partive politike.

Rekomandime

Ligji për partitë politike dhe Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohen për të ndaluar transaksionet në kriptomonedha në lidhje me dhurimet politike dhe shpenzimet e partive/zgjedhore.

16. Legjislacioni që rregullon financimin e zgjedhjeve dhe partive politike duhet të sigurojë garanci shtesë për të mundësuar zbatimin e tij, përfshirë këtu përmirësimin e disa përkufizimeve ligjore të subjekteve financuese; kërkesën për raportim më të shpeshtë dhe të detajuar të financave nga partitë politike që do të publikohen në kohë dhe në mënyrë miqësore me përdoruesin, si dhe vendosjen e sanksioneve më të rrepta, përfshirë kriminalizimin e financimeve të huaja të paligjshme.

Shqipëria forcoi disa pjesë të kuadrit ligjor për rregullimin e financimit të partive dhe zgjedhjeve nëpërmjet ndryshimeve të vitit 2021 në Kodin Zgjedhor. Megjithatë, nevojiten ndryshime të

mëtejshme për të forcuar kuadrin rregullator dhe për të parandaluar financimet e huaja. Plani fillestar i ndryshimeve që kërkohej është evidentuar nga raportet ndërkombëtare. Për shembull, në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, të vitit 2022, pohohet se Kuvendi i Shqipërisë duhet të miratojë një ligj të unifikuar për financimin e partive politike dhe fushatave. Në raportin e tyre më të fundit, OSBE/ODIHR konstaton sërish se Shqipëria duhet të veprojë mbi rekomandimet e dhëna më parë, përfshirë rregullimin e shpenzimeve të palëve të treta.

Në lidhje me ndërhyrjet e huaja, duhen trajtuar katër masa specifike. Së pari, është çështja e përkufizimeve ligjore. Ligji "Për partitë politike" ndalon *ndihmën financiare dhe materiale* për partitë nga qeveri ose ente të huaja publike ose private, si dhe nga ente publike shqiptare ose ato me pjesëmarrje në kapitalin shtetëror. Megjithatë, ligji lejon *dhurata dhe ndihma* nga një parti ose bashkim ndërkombëtar partish, nga fondacione ose organizata politike shqiptare ose të huaja, si dhe nga persona shqiptarë fizikë dhe juridikë privatë. Ligji "Për partitë politike" nuk i përkufizon "subjektet e huaja publike ose private", dhe as parashikon një përkufizim ligjor se çfarë quhet "dhuratë" ose "ndihmë".

Çështja e dytë lidhet me sanksionet. Aktualisht, sipas legjislacionit shqiptar, financimet e huaja të paligjshme të partive politike dhe fushatave të tyre zgjedhore trajtohen si një kundërvajtje administrative e ndëshkueshme me gjobë. Në rastet kur një kandidat ose parti politike pranon dhe përdor financime nga burime të huaja, legjislacioni nuk parashikon trajtimin e tyre në mënyrë të qartë dhe shteruese. Për shembull, në vende të tjera të rajonit, pranimi dhe përdorimi i fondeve të huaja trajtohet si vepër penale. Këto shkelje duhet të klasifikohen si vepra të rënda penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të qartë dhe pa lënë hapësirë për interpretim.

Çështja e tretë është ajo e shpeshtësisë së raportimit. Aktualisht, partitë politike raportojnë për financat

e tyre çdo vit dhe për financimet zgjedhore pas zgjedhjeve. Mund të jetë e dobishme që partitë politike të raportojnë në baza tremujore ose gjashtëmujore, pasi kjo do të siguronte një transparencë më të menjëhershme dhe potencialisht do të shpërndante përpjekjet mbikëqyrëse të KQZ-së në mënyrë të barabartë gjatë gjithë vitit. Njëfarë niveli i raportimit parazgjedhor për të ardhurat zgjedhore do të ishte në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe rekomandimet e mëparshme të OSBE-ODIHR-it.⁴⁴

Çështja e katërt lidhet me publikimin e të dhënave që i raportohen KQZ-së. Kushtetuta e Shqipërisë (Neni 9) mishëron parimin themelor të transparencës duke parashikuar se "burimet financiare të partive dhe shpenzimet e tyre bëhen gjithmonë publike". Që transparenca të jetë kuptimplotë, të dhënat duhet të paraqiten në mënyrë të tillë që të lejohet shqyrtimi i lehtë dhe referencat e kryqëzuara, dhe duhet të jenë të disponueshme në kohë. Kjo u mundëson organeve mbikëqyrëse, gazetarëve investigativë, organizatave të shoqërisë civile, kundërshtarëve politikë dhe publikut të shqyrtojnë informacionin dhe të sinjalizojnë autoritetet për rastet e mundshme të papajtueshmërisë.

Rekomandime

Kuvendi duhet të miratojë legjislacion gjithëpërfshirës dhe të qartë që përputhet me qëllimin për të ndaluar hyrjen e parave të huaja në procesin zgjedhor, mbështetur në përvojën dhe pikëpamjet e institucionit(-eve) mbikëqyrës (-e), organizatave të shoqërisë civile dhe atyre që do të rregullohen nga ligji. Institucionet mbikëqyrëse kanë nevojë për burime të mjaftueshme (njerëzore, financiare dhe teknike) për të ndërmarrë veprime këshillimore, mbikëqyrëse dhe zbatuese, për të siguruar që rregullat që ndalojnë financimet e huaja të kuptohen dhe të zbatohen.

Rregullat duhet të sigurojnë transparencën e parave të përdorura në zgjedhje duke garantuar që publikimi i të dhënave financiare të jetë i shkarkueshëm dhe i lexueshëm elektronikisht, dhe që informacioni të vihet në dispozicion të publikut në kohën e duhur. Të gjitha institucionet e përfshira në mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave që parandalojnë financimet e huaja (p.sh., Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, institucionet kundër pastrimit të parave dhe gjykatat) duhet të punojnë së bashku dhe të tregojnë vullnet politik për zbatimin e ligjit kundër financimeve të huaja.

17. Zbatimi efektiv i ligjeve të financimit politik dhe fushatave zgjedhore kërkon edhe forcim të kapaciteteve për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe funksionimin dhe koordinimin e tij të strukturuar me një sërë organesh të tjera shtetërore me funksione të përshtatshme mbikëqyrëse. Duhet të vendoset një formë e koordinimit institucional, si për shembull me organe që rregullojnë çështje të pastrimit të parave ose të medias.

Në vitet e fundit, janë bërë ndryshime të konsiderueshme në strukturën, stafin dhe kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me financat politike. Disa kanë vënë re përmirësime në nivelin e transparencës së financimeve politike, ndërsa të tjerë kanë kritikuar nivelin e shqyrtimit dhe të auditimit që u kushtohet raporteve financiare, duke vënë në dyshim saktësinë e informacionit të raportuar. Shumë persona kanë deklaruar se partitë politike shpenzojnë shumë më shumë në fushatat e tyre zgjedhore nga sa kanë regjistruar në raportet e tyre. Raportet financiare që i dorëzohen KQZ-së duhet të shqyrtohen nga ekspertë të fushës, për të siguruar që ato pasqyrojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e rregulluara aktualisht, dhe që gjithçka është e dokumentuar në mënyrën e duhur.. Duhet të monitorohen shpenzimet për zgjedhje për të

44 Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2022. OSBE/ODIHR, Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023

siguruar që raportet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të sakta, dhe që çdo mangësi e identifikuar të hetohet.

Nëse legjislati ndryshohet në mënyrë që të parashikojë shpenzimet zgjedhore të palëve të treta dhe të reklamave në mediat sociale, ngarkesa e punës e KQZ-së do të rritet ndjeshëm. Për këtë do të duhen burimet e nevojshme për prodhimin e materialeve të mira udhëzuese, monitorimin e shpenzimeve të palëve të treta dhe të mediave sociale, dhe zbatimin e rregullave të reja. Burimet e nevojshme ka gjasa që të përfshijnë staf shtesë të mirëtrajnuar, programe të teknologjisë së informacionit dhe lidhje me baza të tjera të dhënash shtetërore. Megjithatë, trajtimi i ndërhyrjeve të huaja nuk është diçka që KQZ-ja mund ta bëjë vetëm. Asistenca për monitorim mund të sigurohet nga grupet e shoqërisë civile dhe të dhënat financiare të ofruara nga gazetarët investigativë që janë të disponueshme për publikun në kohë dhe në format miqësor me përdoruesin.

Gjithashtu, çështjet e ngritura nga burimet e huaja të financimeve janë ndërsektoriale dhe me gjasë përfshijnë edhe luftën kundër pastrimit të parave, regjistrimin e personave juridikë, pronësinë e mediave dhe ndjekjen penale të aktorëve vendas dhe/ose të huaj. Ata që synojnë të ushtrojnë ndërhyrje të huaja nuk bazohen vetëm te një rrugë e vetme dhe veprimtaritë e tyre kanë shpesh disa elemente, duke çuar në krijimin e termit fushata “me shumë vektorë”.⁴⁵ Në bazë të diskutimeve me disa bashkëbisedues, duket se ndërhyrjet e huaja në arenën politike të Shqipërisë (dhe në sistemin e saj të financimit politik në veçanti) renditen dukshëm në fund të agjendës së organeve përkatëse mbikëqyrëse dhe nuk trajtohen në mënyrë aktive dhe të koordinuar. Kjo çështje duhet të jetë prioritet për të gjitha institucionet publike që mbikëqyrin aspektet e procesit të fushatave zgjedhore dhe duhet të ketë një mekanizëm që i bën bashkë këto institucione për qëllime

të parandalimit, monitorimit, hetimit dhe sanksionimit të atyre që angazhohen në ndërhyrje të huaja në financimet politike shqiptare.⁴⁶

Ligjet organike të secilit institucion publik duhet të rishikohen për të siguruar se e përfshijnë këtë çështje si pjesë të fushëveprimit të institucionit dhe për të autorizuar drejtuesin e lartë të çdo institucioni që të koordinohet mbi bazë ndërinstitutionale. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të angazhohet në rolin e koordinatorit për këtë qëllim dhe të ketë detyrën për të thirrur mbledhje dhe për të raportuar veprimtaritë e ndërmarra.

Rekomandime

Të rivlerësohen kërkesat e KQZ-së për burime njerëzore dhe teknike për të përballuar sfidat e rregullimit të shpenzimeve të palëve të treta, reklamave në mediat sociale dhe forcimin e masave për ndalimin e burimeve të huaja të financimit. Të merret parasysh krijimi i një grupi pune ndërinstitutional që synon trajtimin e financimit të huaj të partive politike dhe shpenzimet zgjedhore.

45 Citim për studimin e fshehtë në f. 59.

46 Pa kërkuar që të jemi tepër përshkrues në lidhje me përmbajtjen dhe formatin, rekomandojmë që ligjet organike të secilit institucion publik përkatës të rishikohen për të siguruar se e përfshijnë këtë çështje si pjesë të fushëveprimit të institucionit dhe për të autorizuar drejtuesin e lartë të çdo institucioni që të koordinohet mbi bazë ndërinstitutionale. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të angazhohet në rolin e koordinatorit për këtë qëllim dhe të ketë detyrën për të thirrur mbledhje dhe për të raportuar veprimtaritë e ndërmarra.

05 RRUGA 2: MANIPULIMI I MJEDISIT TË INFORMACIONIT

a. Si shfaqet kjo ndërhyrje?

18. Operacionet e dezinformimit⁴⁷ të Rusisë kanë hapësirë të kufizuar për të përdorur “pushtetin e butë” dhe për të promovuar pikëpamjet e Kremlinit në Shqipëri për shkak të orientimit të qartë gjeopolitik të vendit. Megjithatë, mbetet hapësirë e bollshme për ta cenuar mjedisin e informacionit në mënyrë të fshehtë, duke bërë që: 1) të nxitin narrativat e brendshme, që përkohë me objektivat taktikë të Rusisë; dhe: 2) të fuqizohen aktorët dhe rrjetet, që mund të shndërrohen në faktorë me veto politike.

Qëndrimet publike ndaj Rusisë në Shqipëri nuk janë pozitive, madje mund të thuhet se shumica e popullsisë ka një qëndrim armiqësor ndaj saj.⁴⁸ Vendi nuk ka asnjë lidhje gjuhësore ose kulturore me Rusinë, as alternativa politike apo rrjete kryesore që mbështesin krijimin e lidhjeve të forta me Rusinë.

Në fakt, diskutimet rreth ndikimit të Rusisë në vend përqendrohen kryesisht te shkëmbimi i akuzave ndërmjet partive politike për pasjen e lidhjeve me Rusinë. Gjithashtu, në Shqipëri nuk ka portale lajmesh të njohura publikisht se janë nën pronësi ruse që promovojnë hapur narrativat në mbështetje të Rusisë. Megjithatë, mungesa e tyre nuk do të thotë se dezinformimi rus në Shqipëri nuk është i pranishëm në mënyra më të fshehura. Një studim i kohëve të fundit nxori në pah se, megjithëse portalet mediatike ruse të sponsorizuara nga shteti (RT dhe Sputnik) nuk publikojnë lajme në gjuhën shqipe, në portalet shqipe kanë qarkulluar narrativa në mbështetje të Kremlinit, veçanërisht sa i përket pushtimit të Ukrainës.⁴⁹

Doracaku i Kremlinit⁵⁰ mund të shërbejë për të kuptuar se si mund të identifikohen mënyrat e përshtatjes së operacioneve të dezinformimit për të cenuar zhvillimet politike kombëtare në kuadër të përmbushjes së objektivave ruse. Tashmë dihet se Rusia ka përdorur konceptin e informacionit sovjetik të luftës të “kontrollit reflektiv”⁵¹, që ka të bëjë me cenimin e mjedisit të informacionit në mënyrë të atillë që kundërshtari “të marrë me vullnetin e vet vendime të paracaktuara, që dëshirohen nga pala tjetër”.⁵² Strategjia bazohet te masa aktive, si shpërndarja e të dhënave ose lajmeve të rreme në momente të volitshme për të shkaktuar reagime të caktuara dhe për të shfrytëzuar cënueshmëritë sociale dhe psikologjike. Kjo strategji nuk mbështetet konkretisht te krijimi i një imazhi pozitiv të Rusisë, por priret të nxisë shfaqjen e narrativave të caktuara, si dhe të shtyjë dhe fuqizojë aktorët dhe rrjetet politike, interesat e të cilëve (të qëllimshëm ose jo) përputhen

47 Dezinformimi përkufizohet si shpërndarja e qëllimshme e informacioneve të rreme ose çorientuese, duke synuar mashtrimin ose manipulimin e audiencës për përfitime politike, financiare ose sociale. Kjo praktikë është e ndryshme nga keqinformimi, që ka të bëjë me ndarjen e paqëllimshme të informacioneve të rreme. Dezinformimi ka për qëllim ndikimin e opinionit publik, cenimin e kohezionit social, ose minimin e besimit tek institucionet.

48 Një sondazh i fundit konstatoi se 40 për qind e shqiptarëve e shohin ndikimin e Rusisë në Shqipëri si “jashtëzakonisht të dëmshëm”, duke qenë në vend të dytë, pas Iranit (43 për qind). Burimi: “Public perceptions on influence of External Actors Towards Albania” [Perceptimet publike për ndikimin e Aktorëve të Jashtëm ndaj Shqipërisë]. Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 2023

49 “Russian state-sponsored disinformation narratives in Albania” [Narrativat e Dezinformimit të sponsorizuara nga shteti rus në Shqipëri] – BIRN Albania

50 “The Kremlin Playbook in Europe” [Doracaku i strategjisë së Kremlinit në Evropë] – Qendra për Studimin e Demokracisë

51 “Disinformation and Reflexive Control: The New Cold War” [Dezinformimi dhe kontrolli reflektiv: Lufta e Ftohtë e re] – Annie Kowalevski – Shqyrtimi i Studimeve për Sigurinë në Georgetown

52 Po aty.

me objektivat e Rusisë.

Që prej zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA, ku u vendos theksi tek operacionet e ndikimit të Kremlinit, këto të fundit janë rafinuar edhe më tej në qasje, duke “ndërhyrë te zërat autentikë dhe institucionet e brendshme për të promovuar narrativat e tyre, në përpjekje për t’i modifikuar ato në mbështetje të Rusisë duke fshehur origjinën e tyre, si dhe duke përshtatur sjelljen e llogarive robote dhe *trolls* në internet që të duken më të vërtetë”.⁵³ Terreni ku dezinformimi rus zhvillohet mund të jetë tërësisht vendas dhe të pasqyrojë pakënaqësinë e vërtetë ndaj Brukselit ose Uashingtonit nga grupe interesi të caktuara (p.sh. nga elementë të krimit të organizuar), ose cenueshmëri reale shoqërore dhe të lidhura me identitetin (p.sh. nga ekstremistë të krahut të djathtë ose fetarë). Dezinformimi që e ka burimin jashtë vendit mund të jetë i vështirë që të menaxhohet dhe pikaset, por mund të shërbejë si një burim i rëndësishëm për nxitjen e këtyre narrativave, duke theksuar qëndrimet kundër Perëndimit dhe më e rëndësishmja, duke fuqizuar rrjetet politike të brendshme, që Rusia i konsideron si të dobishme për objektivat e vet. Në një shoqëri me polarizim aq të theksuar sa Shqipëria, ku zgjedhjet kanë qenë historikisht (megjithëse jo vitet e fundit) me rezultat të ngushtë, këto lloje rrjetesh mund të shndërrohen në faktorë të rëndësishëm me fuqi vetoje, që mund të pengojnë ndryshimin e gjendjes aktuale, si dhe të veprojnë si burime me ndikim për mobilizimin e votuesve. Në planin afatgjatë, ato mund t’i kthejnë narrativat pakta aktuale anti-perëndimore në qendër të vëmendjes.

Një nga momentet kyç për shpërndarjen e dezinformimit rus në ekosistemin e informimit të Shqipërisë lidhet me luftën në Ukrainë. Një nga studimet e BIRN-it⁵⁴ konstatoi se, gjatë tetë muajve të parë të vitit 2022, në portalet e lajmeve në gjuhën

shqipe u përhapën lajme të rreme për luftën në Ukrainë. Këto lajme të rreme, që e patën burimin kryesisht nga jashtë vendit dhe u shpërndanë në mediat sociale, janë përkthyer dhe ripublikuar nga faqet e internetit të mediave, televizionet, radiot dhe gazetatat vendase, kryesisht për arsye tregtare dhe pa ndonjë sfond ideologjik të qartë. Studimi arsyetonte se shpërndarja e dezinformimit për konfliktin është në një nivel më të lartë nga sa mendohej, ku mediat tradicionale kanë rishpërndarë numrin më të madh të lajmeve të rreme. Portalet e lajmeve në internet kanë rishpërndarë një numër më të madh lajmesh të rreme në krahasim me mediat e tjera, duke qenë se kanë mungesë të burimeve për të ngritur struktura efektive redaksionale, ndaj mbështeten vetëm te kopjimi dhe ndarja e përmbajtjeve nga mediat e tjera pa verifikuar vërtetësinë e ngjarjeve, fotografive dhe videove në fjalë.⁵⁵ Studimi tregoi edhe se përdoruesit e mediave sociale kanë një nivel ndërveprimi më të lartë me lajmet e rreme dhe mashtrimet, por njëkohësisht kanë nivele më të ulëta ndërveprimi me artikujt që demaskojnë këto ngjarje. Megjithatë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se studimi ka nxjerrë në pah se shumica e lajmeve të rreme qarkulluese kishin mesazhe në mbështetje të Ukrainës.⁵⁶

19. Në shumë demokraci, përpjekjet ruse për luftën e informacionit kanë dëshmuar se kanë mbështetur grupe dhe rrjete ekstremiste që promovojnë narrativa kundër të drejtave të grave dhe të personave LGBTQI+, si një portë hyrëse për t’u dhënë shtysë kompleteve anti-perëndimore te konservatorët socialë. Këto narrativa kanë pasur njëfarë pasqyrimi në Shqipëri gjatë viteve të shkuara për shkak të një larmie aktorësh dhe rrjetesh mjaft aktive me akses në median tradicionale dhe në mediat online që janë mjaft të cenueshme nga titujt bombastikë mashtrues dhe lajmet e rreme.

53 “Influenced by Russia: The Targets and Intentions of Information Operations” [Ndikuar nga Rusia: Objektivat dhe synimet e operacioneve informuese] Maria Snegovaya për Institut Montagne:
54 “Lajmet e rreme mbi pushtimin rus të Ukrainës në mediat shqipfolëse” – BIRN Albania.
55 Po aty.
56 Po aty.

Një nga elementet në strategjinë e Kremlinit në shumë vende të Evropës ka të bëjë me promovimin e narrativave që synojnë ta paraqesin Perëndimin si të pamoralshëm sa u përket vlerave tradicionale dhe të nxisin reagime shoqërore konservatore ndaj Perëndimit. Një çështje me vëmendje të veçantë është ajo e gjinisë dhe e të drejtave të personave LGBTQI+, që priret të paraqitet si agjendë perëndimore për të shkatërruar familjet tradicionale.⁵⁷ Rusia ka financuar lëvizje ultrakonservatore dhe fetare ekstremiste, që përdorin këtë lloj argumenti,⁵⁸ dhe është vlerësuar si një “aktor i fuqishëm madhor në mobilizimin kundër gjinisë në nivel botëror”.⁵⁹ Ky financim është gjurmuar nga disa studime, që kanë konstatuar se ai kryhet nëpërmjet oligarkëve dhe “parave të zeza”, të kanalizuar drejt aktorëve politikë nëpërmjet pastruesve të parave dhe agjencive me financim shtetëror.⁶⁰ Megjithëse ka qenë e pamundur të përcaktohet sasia e financimit prej pastruesve të parave dhe agjencive shtetërore, sipas një studimi në shkallë të gjerë, financimi rus për lëvizjen kundër barazisë gjinore nëpërmjet oligarkëve nga viti 2009 deri në 2018, përlllogaritet të ketë qenë rreth 188 milionë dollarë amerikanë.⁶¹ Një sasi e konsiderueshme e këtyre parave është shpenzuar për dezinformimin, në veçanti atë në mediat sociale, ku grupe *trolls* në internet ngacmojnë dhe kanosin

rregullisht gratë dhe aktivistët për të drejtat e personave LGBTQI+.⁶²

Nuk ka prova që tregojnë se financimi rus është përdorur në Shqipëri për mbështetjen e këtyre kauzave, kryesisht për shkak se shumica e këtyre burimeve vjen nëpërmjet kanaleve informale dhe niveli i transparencës i organizatave fetare është shumë i ulët.⁶³ Në fakt, një sasi edhe më e madhe financimi për këto kauza në nivel botëror sigurohet nëpërmjet lëvizjeve të krishtera ungjillore në SHBA.⁶⁴ Megjithatë, gjatë viteve të fundit, diskutimi kundër të barazisë gjinore në Shqipëri ka ardhur në rritje.⁶⁵ Për shembull, “Aleanca për Mbrojtjen e Familjes” është mbështetur nga përpjekje të përbashkëta nga klerikët protestantë dhe myslimanë kundër martesës brenda të njëjtës gjini⁶⁶ ose të drejtave prindërore për personat LGBTQI+.⁶⁷ Kjo përkon me gjetjet e një studimi global për ndikimin e huaj “se rrjetet fetare luajnë një rol formal dhe informal në mobilizimin kundër barazisë gjinore”.⁶⁸ Shumë nga narrativat e promovuara nga këto grupe në Shqipëri, veçanërisht në mediat sociale, u mbivendosen përpjekjeve globale të dezinformimit të aktorëve të huaj në lidhje me gjininë.⁶⁹

Ekziston një nivel mbivendosjeje ndërmjet rrjeteve dhe aktorëve që mbështesin argumentet anti-gender

57 “Disinformation campaigns about LGBTI+ people in the EU and foreign influence” [Fushatat e dezinformimit rreth personave LGBTI+ në BE dhe ndikimi i huaj] Cecilia Strand dhe Jakob Svenson. Raportim për Komisionin e INGE-së të Parlamentit Evropian:
58 “We know Russia funds Eruope’s far Right. But what does it get in return?” [E dimë se Rusia financon ekstremistët e djathtë të Evropës. Por çfarë përfiton prej kësaj?] – Neil Datta – Open Democracy
59 “Tip of the Iceberg: Religious Extremist Funders against Human Rights for Sexuality and Reproductive Health in Europe 2009 -2018” [Maja e ajsbergut: Financuesit ekstremistë fetarë kundër të drejtave të njeriut për seksualitetin dhe shëndetin riprodhues në Evropë 2009-2018] Forumi Parlamentar Evropian për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese.
60 Po aty.
61 Po aty.
62 “Gendered Disinformation:” Tactics, Themes and Trends by Foreign Malign Actors” [Dezinformimi gjinor: Taktikat, tematikat dhe tendencat nga aktorët dashakeqë të huaj] U.S. Departamenti i Shtetit, Qendra Botërore e Angazhimit.
63 Përfundim i autorëve duke u mbështetur tek intervistat me ekspertët.
64 “Tip of the Iceberg: Religious Extremist Funders against Human Rights for Sexuality and Reproductive Health in Europe 2009 -2018” [Maja e ajsbergut: Financuesit ekstremistë fetarë kundër të drejtave të njeriut për seksualitetin dhe shëndetin riprodhues në Evropë 2009-2018] Forumi Parlamentar Evropian për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese.
65 Përfundim i bazuar tek intervistat me ekspertët e medias në Shqipëri.
66 “Të mbrojmë familjen: Ahmet Kalaja i bashkohet pastorit Akil Pano” Vizion Plus.
67 “Fitore e madhe e familjes, pastori Akil Pano fiton gjyqin kundër agjendës së komunitetit LGBT”. NewsBomb
68 “Tip of the Iceberg: Religious Extremist Funders against Human Rights for Sexuality and Reproductive Health in Europe 2009 -2018” [Maja e ajsbergut: Financuesit ekstremistë fetarë kundër të drejtave të njeriut për seksualitetin dhe shëndetin riprodhues në Evropë 2009-2018] Forumi Parlamentar Evropian për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese.
69 “Malign Creativity: How Gender, Sex and Lies are Weaponized Against Women Online” [Krijimtaria dashakeqe: Si gjinia, seksi dhe gënjeshttrat përdoren kundër grave online] Qendra Wilson.

me individët që promovojnë teoritë e konspiracionit anti-perëndimor, për shembull ato në lidhje me planet e Soros-it për shpopullimin e Shqipërisë,⁷⁰ ose teoritë e konspiracionit për origjinën perëndimore të Covid-19-s⁷¹, tematika që janë theksuar edhe nëpërmjet dezinformimit rus.⁷² Këto narrativa dhe zakonisht, artikujt e lajmeve të rreme nga jashtë vendit, jo vetëm që kanë depërtuar në botën tejte të parregulluar të portaleve *online*, por disa prej ithtarëve të tyre kanë arritur të shfaqen në programet kryesore të medias tradicionale.⁷³ Disa prej këtyre aktorëve, si për shembull në rastin e një hoxhe ekstremist me ndjekje të gjerë publike, janë përqaftuar nga elitat politike.⁷⁴ Hapësira mediatike në rritje për këto narrativa dhe pushteti politik në rritje i këtyre rrjeteve mund t'u shërbejnë aktorëve të huaj që të zgjerojnë ndikimin e tyre.

20. Ekzistojnë disa tregues se dezinformimi rus mund të jetë duke synuar përshkallëzimin e qëndrimeve nacionaliste dhe ekstremiste të djathta te shqiptarët në rajon, si edhe narrativave që hedhin dyshim mbi politikën rajonale të Shqipërisë dhe ecurinë e saj drejt aderimit në BE.

Një element famëkeq i strategjisë ruse për dezinformimin në Evropën Perëndimore është përpjekja e përshkallëzimit të narrativave të partive politike ekstremiste të djathta dhe të majta, që mbështesin argumentet sovraniste që kritikojnë BE-në, SHBA-në dhe NATO-n, si një mënyrë për të

nxitur ndasitë në Perëndim.⁷⁵ Kjo përpjekje kryhet nëpërmjet përmbajtjes nga mediat tradicionale, si Sputnik dhe RT, ose grupeve *trolls* në platforma të ndryshme të mediave sociale.⁷⁶ Në Ballkanin Perëndimor, Rusia ndjek një strategji të ngjashme, që ka për synim t'i pengojë vendet e rajonit që të zgjidhin mosmarrëveshjet dypalëshe dhe të arrijnë të realizojnë aspiratat e tyre për anëtarësi të plotë në BE. Një shembull i kohëve të fundit i këtij angazhimi u konstatua në vitin 2018 në Maqedoninë e Veriut gjatë përpjekjeve për arritjen e një marrëveshjeje për përplasjen me Greqinë për emrin e vendit, që do t'i hapte rrugën Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në NATO. Dezinformimi rus i shtyu aktorët dhe partitë nacionaliste që të synonin minimin e marrëveshjes në të dyja vendet,⁷⁷ ndërsa një oligark rus u arrestua në Greqi për financimin e organizatave ekstremiste të djathta për këtë fushatë.⁷⁸

Përpjekjet dezinformuese ruse të drejtuara ndaj grupeve ekstremiste të djathta janë më të theksuara në Serbi, ku qëndrimet nacionaliste synojnë të pengojnë marrëveshjen e normalizimit me Kosovën, të nxisin ndasitë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe të ruajnë qëndrimin favorizues ndaj Rusisë në Serbi. Një nga efektet anësore të kësaj përpjekjeje është amplifikimi i nacionalizmit të shqiptarëve. Një veçori e shpeshtë e dezinformimit rus dhe zërave në mbështetje të Rusisë në Serbi gjatë viteve të fundit ka qenë vendosja e theksit te kërcënimi i Shqipërisë së Madhe.⁷⁹ Për shembull, Sputnik Serbia

trajton rregullisht përkujtimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe i paraqet deklaratat nga drejtuesit e Shqipërisë dhe Kosovës si shenja të një projekti aktiv për bashkimin e shqiptarëve.⁸⁰ Ai paraqet narrativën e serbëve nën rrethimin e fqinjëve “klientë të Amerikës” dhe i trajton armiqhtë e Serbisë si të vetët. Nëpërmjet nxitjes së frikës për nacionalizmin shqiptar, Rusia shfrytëzon tensionet dhe dobësitë ekzistuese ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, në përpjekje për t'i penguar që të formojnë aleanca të forta, që mund t'i kundërvihen ndikimit rus. Kjo taktikë për të paraqitur lidhjen e Shqipërisë me projekte nacionaliste agresive mund të cenojë edhe imazhin dhe përpjekjet e Shqipërisë drejt integritetit evropian. Në periudhën menjëherë pas fillimit të agresionit në Ukrainë, Kremlinin veçoi shqiptarët, kosovarët dhe boshnjakët ndër grupet e luftëtarëve të huaj që luftonin për Ukrainën.⁸¹ Në anën tjetër të strategjisë së dezinformimit të Rusisë për Ukrainën, të cilën e paraqet si shtet nazist, edhe Shqipëria e Madhe e viteve 1939-1944 paraqitet si një projekt nazist dhe mbështetja e Perëndimit për pavarësinë aktuale të Kosovës si vijimësi e këtij projekti.⁸² Kjo strategji synon të shfrytëzojë problematikën historike dhe qëndrimet nacionaliste për të destabilizuar rajonin dhe për të ruajtur mbështetjen e interesave rusë nga Serbia. Ky manipulim i informacionit mund të pengojë ecurinë e rajonit drejt integritetit evropian dhe zhvillimit demokratik.

Interesi strategjik parësor i Rusisë për mbështetjen dhe përshkallëzimin e qëndrimeve ekstremiste të djathta në Shqipëri lidhet me strategjinë për nxitjen e nacionalizmit në Ballkan. Ekspertët e dezinformimit sugjerojnë se tema më e shpeshtë e dezinformimit që e ka fillesën në Serbi është narrativa e luftës së afërt

në Kosovë.⁸³ Megjithëse në Shqipëri nuk ekzistojnë grupe ekstremiste të djathta të mirënjohura (madje, as të vogla), në internet ka pasur një rritje të veprimtarisë nga grupet që promovojnë hapur idetë fashiste.⁸⁴ Në Twitter gjenden mbi 500 llogari nacionaliste shqiptare anonime dhe të paverifikuara, shumica prej të cilave duken si llogari robote që promovojnë narrativa nacionaliste dhe, shpesh, antiperëndimore, dhe disa prej tyre ndërveprojnë me ose ripostojnë nga llogari robote në mbështetje të Rusisë.⁸⁵ Shumica e këtyre llogarive kanë bërë edhe thirrje për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, duke nxitur gjuhën e urrejtjes kundër serbëve ose ndasinë fetare ndërmjet shqiptarëve, ose duke promovuar teoritë konspirative anti-perëndimore.⁸⁶

Dezinformimi nga Rusia mund të ketë si qëllim edhe shfrytëzimin e tensioneve ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë duke përdorur si pikënisje elementët e ekstremit të djathtë në Greqi. Për shembull, arrestimi i kandidatit me etni greke për kryebashkiak të Himarës (i akuzuar për blerje votash) shkaktoi një përplasje të fortë politike ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Sipas artikujve të lajmeve, kandidati për kryebashkiak Fredi Beleri ka pasur disa kontakte në moshën 20-vjeçare me organizatën paraushtarake Fronti për Çlirimin e Epirit të Veriut (MAVI)⁸⁷ dhe është dyshuar nga disa kanale mediatike shqipfolëse se ka marrë pjesë në vrasjen e ushtarëve shqiptarë të kontrollit kufitar,⁸⁸ megjithëse ai nuk është akuzuar asnjëherë zyrtarisht për këto vepra. Gjatë fazës parazgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2023, Beleri u kritikua për narrativën e tij antishqiptare, si dhe për deklaratat e bëra gjatë takimeve në Athinë, ku u shpreh se, nëse do të zgjidhej, do të zbatonte planin për “helenizimin

70 “Goxhaj: Soros ka në agjendë shpopullimin e Shqipërisë.”

71 “Conspiracies and Covid-19 in the Balkans.” [Teoritë e konspiracionit dhe Covid-19 në Ballkan] BIEPAG

72 “Study Shows How Russian, Chinese Disinformatino About Covid 19 Evolved During the Pandemic” [Studimi tregon se si u zhvillua dezinformimi rus dhe kinez rreth Covid-19-s gjatë pandemisë] Radio Free Europe.

73 “Albanian Broadcasters Happy to Host Antivaxxer Conspiracy Theorists” [Televizionet shqiptare mirëpresin teoricienët e konspiracionit kundër vaksinimit] Balkan Insight

74 “Ahmet Kalaja këndon lutjet fetare në iftarin e shtuar nga Edi Rama” – TV21.

75 “Divide and Rule: How Russia Wants to Win the Information Cold War” [Përçja e sundo: Si Rusia dëshiron të fitojë Luftën e Ftohtë të Informimit] Visegrad Insight

76 “The St. Petersburg Troll Factor Targets Elections from Germany to the United States” [Faktorët tallës të Shën Pjetërburgut shënjestrojnë zgjedhjet nga Gjermania e deri në Shtetet e Bashkuara] EUvsDisinfo.

77 “How Disinformation Harmed the Referendum in Macedonia” [Si e dëmtoi dezinformimi referendumin në Maqedoni] Fondi Marshall Gjerman i SHBA-së.

78 “Russian Businessman Behind Unrest in Macedonia” [Biznesmeni rus ishte shkaku i trazirave në Maqedoni]. OCCRP

79 Shihni këtë punim të Sputnik si shembull ilustrues: “Greater Albania Initiative Can Trigger Great Balkan War” [Nisma për Shqipërinë e Madhe mund t'i japë shkas Luftës së Madhe Ballkanike]

80 Shihni këtë punim të Sputnik si shembull ilustrues: “Kurti Slavi Prizrensku Ligu, Velikoalbanski I protivsrpski pokret”

81 “Albania, Kosovo, Bosnia Deny Sending Mercenaries to Ukraine” [Shqipëria, Kosova dhe Bosnja mohojnë të kenë dërguar merce-narë në Ukrainë]. Balkan Insight

82 Shihni këtë punim të Sputnik si shembull: “Ko je symbol Kosova Dzafer Deva, Hitler ga odlikovao, CIA mu oprala biografiju”

83 Intervistë me kreun e një organizate për verifikimin e fakteve.

84 “BIRN prezanton Hartën interaktive të grupeve të djathta dhe ekstremiste.” Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative

85 Shqyrtim i bazës së të dhënave dhe analizë narrativash nga autorët.

86 Po aty.

87 “Let him be sworn in, Greece tells Albania.” [Lëreni të betohet, i thotë Greqia Shqipërisë] Ekathimerini.

88 “Masakra e Peshkëpisë/ Si u vranë dy ushtarakët shqiptarë, Fredi Beleri nën hetim.” Dosja.

e Himarës”.⁸⁹ Gjatë vizitave në Athinë, Beleri u pa duke u takuar me anëtarë të grupeve ekstremiste të djathta greke, si Thanos Plevris, Eleftherios Oikonomou, Babis Karathanos (shpallur *non-grata* në Shqipëri), si dhe me anëtarë të partisë së shpërbërë “Agimi i Artë”. Agimi i Artë, së bashku me parti të tjera ekstremiste të djathta të Evropës Perëndimore, janë akuzuar për marrjen e mbështetjes financiare prej Rusisë.⁹⁰ Kjo lidhje sugjeron se përpjekjet ruse për dezinformim mund të jenë duke shfrytëzuar këto rrjete ekstremiste të djathta për të thelluar tensionet etnike dhe politike ekzistuese ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se shumë prej këtyre narrativave, veçanërisht ato në lidhje me synimet dhe veprimet e Belerit, kanë pasur kundërshtime të forta dhe janë nxitur nga aktorë të caktuar për përplasje politike dhe nga kanale mediatike të caktuara.

21. Dezinformimi nga aktorët e huaj shpeshherë synon të nxisë mosbesimin e publikut ndaj institucioneve, reformave dhe qeverive demokratike. Narrativat mediatike që kanë vënë në pikëpyetje besueshmërinë e zgjedhjeve dhe integritetin e institucioneve, sidomos reforma në drejtësië sponsorizuar nga Perëndimi, kanë qenë të pranishme në Shqipëri. Megjithëse këto narrativa janë kryesisht produkt i polarizimit politik vendas, sulmeve të sponsorizuara nga grupe interesi vendase ose i padrejtësive të vërteta qytetare me institucionet e dobëta, ato janë ushqyer, me raste, nga ndërhyrje të dyshuara të huaja nëpërmjet sulmeve kibernetike dhe shpërndarjes në masë të të dhënave .

Aktorët e huaj, si Rusia dhe Irani, njihen për përdorimin e gjerë të sulmeve kibernetike për të fituar akses tek infrastruktura kritike e vendeve kundërshtarë dhe për të siguruar informacione delikate, disa prej të cilave i publikojnë në media si pjesë e operacioneve të ndikimit. Një shembull i njohur është hakerimi i sistemit të postës elektronike të Partisë Demokratike të SHBA-së dhe nxjerrja e informacioneve në Wikileaks përpara zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA.⁹¹ Sulmet kibernetike ruse kanë qenë të shpeshta edhe gjatë momenteve me tensione politike në vendet evropiane, duke përfshirë Malin e Zi dhe Gjeorgjinë.⁹² Sulmet kibernetike janë në rritje: në periudhën përpara dhe pas fillimit të agresionit kundër Ukrainës, sulmet kibernetike ruse ndaj vendeve anëtare të NATO-s u katërfishuan në vitin 2022 në krahasim me vitin 2020.⁹³

Në vitin 2022, Shqipëria u përball me një sulm kibernetik madhor, për të cilin FBI-ja akuzoi Iranin.⁹⁴ Hakerat arritën të depërtonin thellë në sistemet e brendshme qeveritare të Shqipërisë dhe të nxirrnin të dhëna nga rrjetet e ndryshme qeveritare, çka bëri që shumë sisteme të mos funksiononin për javë të tëra. Më pas, ky sulm u shoqërua me nxjerrjen e të dhënave në masë në kanalin Telegram nga një grup hakerash të vetëquajtur ‘Drejtësia e Atdheut’. Këto nxjerrje të dhënash përfshinë të dhëna të policisë së shtetit dhe, madje, identitetet dhe të dhënat personale të 600 oficerëve shqiptarë të shërbimit informativ.⁹⁵ Incidenti cenoi besimin e publikut ndaj institucioneve dhe nxori në pah mangësitë e infrastrukturës së sigurisë kibernetike në Shqipëri.

Sulmet kibernetike nuk kanë qenë i vetmi burim i ndarjes së të dhënave në masë, pasi ka pasur edhe dy nxjerrje të dhënash madhore në nivel të brendshëm fizikisht, si pasojë e korrupsionit. Në prill të vitit 2021, dy javë përpara zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, një ndarje të dhënash në masë në një portal shqiptar zbuloi informacionet private dhe të dhënat personale të thujse 910.000 individëve.⁹⁶ Këto të dhëna, që përmbanin informacione private të qytetarëve, që mund të ishin marrë vetëm nëpërmjet sistemeve qeveritare, ishin një dokument i brendshëm i partisë qeverisëse për mobilizimin e votuesve. Në dhjetor të po atij viti, pati një tjetër shkelje të dhënash prej Administratës Tatimore, duke bërë publike pagat mujore, pozicionin e punës, emrat dhe numrin e kartës së identitetit të thujse 630.000 qytetarëve.⁹⁷ Më pas, pati edhe një tjetër nxjerrje të dhënash për targat e automjeteve. Këto baza të dhënash u shpërndanë në masë nëpërmjet WhatsApp-it, dhe mediat i trajtuan pagat e personave publikë gjerësisht. Katër zyrtarë të qeverisë u proceduan penalisht për nxjerrjen e të dhënave në këmbim të parave. Të paktën njëri nga personat e përfshirë u raportua se kishte lidhje biznesi me një oligark rus të teknologjisë financiare.⁹⁸

Raportet kanë dokumentuar përdorimin e medias për shantazhimin ose zbatimin e agjendave të fshehta, që nuk janë medoemos në të mirë të publikut.⁹⁹ Ky fenomen është kryesisht i lidhur me portalet anonime dhe sensacionale në internet, që shpeshherë sulmojnë me qëllim institucionet dhe individët nëpërmjet raportimeve spekuluese dhe të paverifikuara, që nuk përmbushin asnjë kriter gazetarie. Disa bashkëpunëtorë nga OSHC-të u

shprehën gjatë intervistave se shumë nga qindra portalet e parregulluara financohen nëpërmjet parave të korrupsionit dhe përdoren nga grupe të ndryshme interesi për të “larë hesapet” dhe për të ushtruar shantazh.^{100 101} Sistemi i ri gjyqësor i reformuar, i ngritur me ndihmën e BE-së dhe SHBA-së, është një nga objektivat kryesorë të sulmeve që hedhin dyshim mbi integritetin e gjyqtarëve¹⁰² dhe prokurorëve¹⁰³, si dhe që nxisin kritikën ndaj diplomatëve të huaj, si Ambasadori i SHBA-së ose ata të BE-së. Këto portale *online* e thellojnë më shumë problematikën nëpërmjet nxitjes së narrativave të krijuara nga aktorë politikë të njohur dhe figura të tjera me pushtet, duke u mësuar dhe ekzagjeruar ngjarjet e raportuara në median tradicionale. Ky amplifikim jo vetëm që e zgjeron shtrirjen e këtyre narrativave, por i bën ato të tingëllojnë si të vërteta, çka ndikon te perceptimi dhe diskursi publik.

Ky fenomen nuk haset vetëm te portalet *online*, duke qenë se ekzistojnë raporte të besueshme se edhe media audiovizive në Shqipëri është përfshirë në praktika të ngjashme.¹⁰⁴

Implikimet e këtyre praktikave janë të shumanshme. Ato cenojnë besimin e publikut ndaj medias dhe institucioneve politike, kontribuojnë në polarizimin dhe keqinformimin e publikut, si dhe shndërrohen në pengesë për përpjekjet reale të gazetarëve. Manipulimi i medias për përfitime personale dhe politike paraqet një rrezik të konsiderueshëm ndaj demokracisë dhe integritetit të diskursit publik në Shqipëri. Gjithashtu, këto cënueshmëri mund të shfrytëzohen nga ndikime dashakeqe për të destabilizuar më tej rajonin. Ky

89 “Petros Beleris: Politics and Money are Behind My Father’s Arrest”. [Petro Beleri: Arsyeja e arrestimit të babait tim është politika dhe paratë] Balkan Insight.

90 “Natural allies: the Kremlin connections of the Greek far-right” [Aleatë të natyrshëm: Lidhjet e Kremlinit me ekstremin e djathtë grek] Political Capital (Hungari).

91 “How the Russians hacked the DNC and passed its emails to Wikileaks.” [Si e hakeruan rusët DNC-në dhe ia përcollën e-mail-et Wikileaks-it] Washington Post.

92 “Russia’s strategy in Cyberspace” [Strategjia e Rusisë në hapësirën kibernetike] NATO Stratcom

93 “Russian Cyberattacks on NATO spiked in 2022”. [Sulmet kibernetike ruse ndaj NATO-s u shtuan në 2022]. The Defence Post.

94 “FBI: Iranian Hackers Accessed Albanian Systems Over Year Ago” [Hakerat iraniane aksesuan sistemet shqiptare mbi një vit më parë] – BIRN

95 “Iran’s Balkan front: The roots and consequences of Iranian cyberattacks against Albania” [Fronti ballkanik i Iranit: rrënjët dhe pasojat e sulmeve kibernetike të Iranit kundër Shqipërisë] – Gerta Zaimi – The Middle East Institute

96 “Personal data – chronicle of a “nonexistent” crime; Investigation of data leaks, too little too late” [Të dhënat personale - kronikë e një “krimi të paqenë”; Hetimi i nxjerrjes së të dhënave, tepër i vonë] - Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore

97 Po aty

98 “Personi i arrestuar në lidhje me skandalin e rrjedhjes së listës së pagave punon për miliarderin rus.” EuroNews Albania

99 Treguesit e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor

100 Përfundim i autorëve duke u mbështetur te të paktën 4 intervista me ekspertët.

101 Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri 2023 - Departamenti i Shtetit i SHBA-së

102 Deklaratë për shtyp e Këshillit të Lartë Gjyqësor

103 Shembull i sulmeve kundër Prokurorit Klodjan Braho - Lexoni artikullin [këtu](#) dhe shembull i një padie për shpifje kundër gazetarit Isa Myzraj nga ish-Prokurori për ekspozimin e mënyrës se si portalet *online* po sulmonin anëtarët e Operacionit të Monitorimit Ndërkombëtar [këtu](#).

104 Treguesit e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor

shfrytëzim përkeqëson sfidat me të cilat përballen gazetarët dhe kanalet mediatike që bëjnë përpjekje konkrete për të respektuar standardet etike dhe ofruar informacione të sakta. Gjithashtu, ndërlikon përpjekjet për të garantuar llogaridhënien e aktorëve me pushtet, duke qenë se kufiri ndërmjet gazetarisë së besueshme dhe narrativave manipuluese bëhet tejte i paqartë. Si rrjedhojë, aftësia e publikut për të marrë vendime të informuara cenohet në mënyrë të ndjeshme.

22. Përpjekjet kineze për dezinformim në Shqipëri, që synojnë të ndërtojnë një imazh pozitiv të vendit, me sa duket po japin fryte nëpërmjet bashkëpunimit të strukturuar me platforma mediatike në Shqipëri, marrëdhënieve me gazetarë miqësorë me Kinën, si dhe bashkëpunimit kulturor nëpërmjet Institutit Konfuci. Nga ana tjetër, Turqia është një tjetër aktor rajonal me një gjurmë mediatike, përpjekjet e së cilës për dezinformim përqendrohen kryesisht te shënjestrimi i drejtuesve të komunitetit islamik në Shqipëri, që ajo i konsideron të lidhur me “rrjetin e Gylenit”.

Përmbajtjet miqësore me Kinën në mediat shqipfolëse janë shtuar ndjeshëm gjatë viteve. Një studim i vitit 2020 vlerësoi se nga një sërë artikujsh të shqyrtuar, 47 për qind e paraqisnin Kinën në mënyrë pozitive.¹⁰⁵ Perceptimet publike për rolin e ndikimit të Kinës janë përkeqësuar disi gjatë viteve të fundit, por vijojnë të jenë pozitive (21,7 për qind) ose asnjënjë (47 për qind).¹⁰⁶ Megjithatë nuk ekzistojnë platforma mediatike të njohura publikisht se janë në pronësi të Kinës, Radioja Ndërkombëtare e Kinës (CRI) publikon materiale në gjuhën shqipe¹⁰⁷, si dhe ka një stacion radioje në shqip, të aksesueshëm në Tiranë dhe Durrës (Radio Ejani).¹⁰⁸ Në përgjithësi, besohet se Kina po

ndjek një strategji të përqendruar në bashkëpunim me analistët dhe opinionistët vendas për të ndërtuar këtë imazh dhe më e rëndësishmja, për të pakësuar përmbajtjet kritikuese.¹⁰⁹ Mediat publike, si Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) dhe Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), përfshihen në bashkëpunim të strukturuar me Kinën nëpërmjet marrëveshjeve për ndarjen dhe prodhimin e përmbajtjeve me homologët kinezë.¹¹⁰ Përpjekjet për ndërtimin e imazhit të Kinës kryhen edhe nëpërmjet Institutit Konfuci, që është ngritur në vitin 2013 në Shqipëri. Instituti ofron kurse të gjuhës kineze për publikun e gjerë dhe bashkëpunon me institucione akademike të ndryshme për promovimin e kërkimit. Në juridiksione të tjera, ka pasur shqetësime të konsiderueshme sa u përket veprimtarive të këtij Instituti, dhe disa vende kanë vendosur ta reduktojnë prezencën e tyre. Deri më tani, Instituti ka potencial të kufizuar për të ndikuar te vendimmarrja në Shqipëri, pavarësisht disa lidhjeve personale ndërmjet drejtuesve të institutit dhe deputetëve vendas. Një studim rreth përpjekjeve diplomatike të Kinës në Shqipëri¹¹¹ nëpërmjet mediave shtetërore (Radioja Ndërkombëtare e Kinës) në gjuhën shqipe tregon se Kina paraqitet si një ekonomi me rritje të shpejtë, novatore dhe me aftësi ripërtëritëse, duke e krahasuar në mënyrë të favorshme me SHBA-në, Japoninë dhe vendet e BE-së. Shpeshherë, ky lloj portretizimi bën një krahasim të favorshëm të Kinës me SHBA-në, Japoninë dhe vendet e BE-së. Studimi nxjerr në pah një anshmëri të qartë në mbulimin e lajmeve botërore, me fokus të veçantë të kritikave ndaj SHBA-së, Japonisë dhe Evropës, ndërsa vendet afrikane mbulohen në mënyrë më pozitive për shkak të shtrirjes së ndikimit kinez në kontinent.

105 “Chinese influence in Albania.” [Ndikimi kinez në Shqipëri]. Qendra për Analizën e Politikave Evropiane (CEPA).
106 Burimi Baro: “Public perceptions on influence of External Actors Towards Albania” [Perceptimet publike për ndikimin e Aktorëve të Jashtëm ndaj Shqipërisë]. Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor.
107 Shihni, për shembull: China Radio International in Albanian [China Radio International në shqip].
108 Radio Ejani.
109 “Chinese influence in Albania.” [Ndikimi kinez në Shqipëri]. Qendra për Analizën e Politikave Evropiane (CEPA).
110 “Kina rrit ndikimin mbi mediat publike shqiptare, veren raporti” – Reporter.al
111 Media Analysis – China’s Public Diplomacy in Albania [Analizë e medias - Diplomacia publike e Kinës në Shqipëri] - SCiDEV dhe BIRN Albania

Mbulimi mediatik i NATO-s nga ana e Kinës përqendrohet te temat e zgjerimit dhe paqëndrueshmërisë. Në Ballkan, portretizimet mediatike e vendosin theksin te marrëdhëniet pozitive dhe në rritje me Kinën. Mbulimi i BE-së synon krijimin e përçarjes ndërmjet BE-së dhe SHBA-së. Analiza tregon se kanalet në gjuhën shqipe të CRI-së shërbejnë si instrumente për diplomacinë publike të Kinës, duke formësuar opinionin publik në favor të Kinës. Gjithashtu, nënvizon edhe interesat më të gjerë gjeopolitikë, ekonomikë dhe shoqërorë të Kinës, si dhe strategjinë e saj për shtrirjen e ndikimit në nivel botëror.¹¹²

Turqia është një tjetër vend që zë një hapësirë të konsiderueshme në median shqipfolëse në formën e kanaleve informative në shqip (Anadolu Agency dhe TRT Shqip). Përpjekjet dezinformuese të Turqisë në Shqipëri lidhen në mënyrë të veçantë me sulmet ndaj rrjetit të Gylenit dhe përfshijnë sulme të shpeshta kundër komunitetit islamik të Shqipërisë¹¹³, të cilin Turqia e sheh si të ndikuar nga rrjeti i Gylenit. Gjatë intervistave u shprehën shqetësime në lidhje me kushtëzimet që kishin të bënin me rolin e investitorëve turq në Shqipëri sa i përket kësaj çështjeje. Në vitet e fundit, media të ndryshme *online* në Shqipëri kanë treguar afërsi dhe lidhje gjithnjë e në rritje me Turqinë. Edhe pse këto kanale mediatike nuk janë domosdoshmërisht me ndikim ose shumë popullore, ato paraqesin narrativa urrejtjeje ose publikojnë përmbajtje propagandistike që favorizon Turqinë dhe denigron rivalët ose kundërshtarët e saj politikë.¹¹⁴ Gjithashtu, ka pasur shqetësime edhe në lidhje me marrëveshjen e kohëve të fundit ndërmjet transmetuesit të shërbimit publik në Shqipëri, RTSH-së, dhe transmetuesit publik në Turqi, TRT-së, që u nënshkrua gjatë vizitës zyrtare të Kryeministrit Rama në Turqi në shkurt të vitit 2024 dhe në lidhje me takimet e tij me Presidentin Recep

Tayyip Erdogan.¹¹⁵ Kritikët e vendosin theksin te mungesa e transparencës dhe rregullsisë së procesit gjatë hartimit të marrëveshjes dhe ngrenë pikëpyetje lidhur me përfitimet e mundshme për publikun shqiptar. Gjithashtu, ekziston edhe frika se kjo marrëveshje mund të përdoret si një kanal për shpërndarjen e propagandës turke në Shqipëri, çka mund të përshkallëzojë ndikimin e narrativave të shtetit turk në vend.

Marrëdhënia diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Iranit, e ngritur në vitin 1999, po bëhet gjithnjë e më e tensionuar, e përkeqësuar nga pritja e Mujahedeen El-Khalq (MEK) në Shqipëri, i cili është një grup opozitar iranian, dhe sulmi kibernetik ndaj infrastrukturës digjitale shqiptare në vitin 2022, i aluduar se u krye nga katër grupe të lidhura me Iranin, që synonin ndërprerjen e shërbimeve publike, vjedhjen e të dhënave dhe marrjen e kontrollit të kanaleve të komunikimit qeveritar. Një analizë e artikujve të Pars Today në shqip prej shtatorit të vitit 2021 deri në shtator të vitit 2022¹¹⁶ nxori në pah një sërë anshmërish tematike në narrativat e shtypit. Është e qartë se Irani e shfrytëzon ndjeshëm median për të formësuar perceptimet e publikut për t’i orientuar drejt interesave dhe ideologjisë gjeopolitike të vendit. Mbulimi është qartazi në përkrahje të Rusisë, duke e paraqitur si një aktor global të suksesshëm, veçanërisht sa i përket konfliktit me Ukrainën, ndërsa vendet perëndimore i paraqet në mënyrë negative.

a. Cilat janë cenueshmëritë institucionale kryesore në Shqipëri?

23. Marrëdhënia simbiotike ndërmjet pronarëve të medias, biznesit dhe politikës pengon gazetarinë profesionale në interes të publikut në Shqipëri. Më konkretisht, shkalla e lartë e informalitetit në sektorin e medias dhe niveli i ulët i transparencës/

112 Media Analysis – China’s Public Diplomacy in Albania [Analizë e medias - Diplomacia publike e Kinës në Shqipëri] - SCiDEV dhe BIRN Albania
113 “Dizinformim me lajmin se donacionet e komunitetit mysliman për tërmetin në Turqi ndryshuan destinacion” – Faktoje.al
114 Gjuha e urrejtjes, propaganda dhe dezinformimi në median shqiptare – Instituti Shqiptar i Medias
115 “Turkey-Albania Media Deal Risks ‘Exporting Erdogan’s Propaganda’ – Experts” [Marrëveshja për median ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë rrezikon ‘Eksportimin e propagandës së Erdoganit’ - Ekspertët] – BalkanInsight
116 Analizë e medias - Propaganda e Iranit në Shqipëri - SCiDEV dhe BIRN Albania

mbikëqyrjes së financimeve të medias si dhe çështjet e konfliktit të interesit në Shqipëri krijojnë hapësirë për financim nga aktorë të huaj. Gjithashtu, në botën e medias *online* shumë të parregulluar, pronësia anonime krijon hapësirë për pandëshkueshmëri dhe për mungesë llogaridhënie në lidhje me dezinformimin. Vendimmarrësit, organizatat mediatike, komuniteti gazetaresk dhe shoqëria civile duhet të punojnë së bashku për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie më të madhe për pronësinë e mediave, financimet dhe konfliktin e interesit, në një mënyrë që nuk cenon lirinë e shprehjes dhe që respekton standardet ndërkombëtare.

Tregu i reklamave për shoqëritë mediatike në Shqipëri vijon të jetë i kufizuar, veçanërisht nëse merret parasysh numri tejte i lartë i platformave mediatike.¹¹⁷ Tregu i reklamave ka një ndikim të madh tek integriteti i mediave në Shqipëri për shkak të një boshllëku ligjor, madhësisë së tregut dhe varësisë së medias nga aktorët ekonomikë dhe politikë. Këta faktorë, të ndërthurur me nivelin e ulët të transparencës, sugjerojnë një korrelacion të drejtpërdrejtë ndërmjet reklamuesve dhe përmbajtjes mediatike. Krahës kësaj, ekzistojnë gjasa për keqpërdorimin e reklamave shtetërore dhe fondeve publike për të nxitur agjendën e partisë politike në pushtet.¹¹⁸ Në Shqipëri, reklamimi në median e shkruar dhe atë *online* është thajse i parregulluar përtej detyrimeve tatimore të përgjithshme. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) monitoron vëllimet e reklamave, por ka mungesë transparence sa u përket pozicioneve në treg.¹¹⁹ Raporti vjetor i Bashkimit Evropian për Shqipërinë theksoi se “Shqipëria

nuk disponon ende legjislacion për të forcuar transparencën në reklamimin publik”.¹²⁰ Në kuadër të procesit të aderimit në BE, AMA duhet të zhvillojë një mekanizëm për matjen e audiencës dhe të sigurojë se reklamimi shpërndahet në përputhje me rezultatet e matjes së audiencës, gjë që në Shqipëri mungon deri më tani.¹²¹ Financimi shtetëror për mediat private nëpërmjet reklamave dhe aktiviteteve publike kryhet përmes ndërmjetësuesve, si shoqëritë e komunikacionit, ndaj ka mungesë transparence, çka ngre shqetësime lidhur me kriteret e shpërndarjes së fondeve për secilën media dhe paraqet konflikte interesi.¹²² Reklamimi politik ka një ndikim të lartë te media, duke qenë se pronarët i shfrytëzojnë platformat e tyre për favore politike, duke shkaktuar ndikim redaksional të papërshtatshëm dhe një marrëdhënie të ngushtë ndërmjet mediave, politikës dhe interesave të biznesit.¹²³

Përshtypja e përgjithshme e ekspertëve të medias në Shqipëri është se shumica e mediave tradicionale mbështeten te burime informale financimi për të mbuluar shpenzimet përkatëse. Këtu përfshihen burimet që e kanë fillësën prej veprimtarive të tjera të punës së pronarëve, ose prej veprimtarive informale ose të jashtëligjshme, çka krijon një rrugëkalim të lehtë për financimin nga aktorët e huaj. Kjo është problematike, duke marrë parasysh përqendrimin e lartë të pronësisë së mediave në konglomeratet e mediave tradicionale kryesore dhe ndikimin e madh të interesave të biznesit të pronarëve të mediave ndaj linjave redaksionale.¹²⁴ Përqendrimi i lartë i pronësisë së audiencave dhe mediave përbën një kërcënim strukturor ndaj lirisë së medias, pasi cenon pluralizmin e zërave të nevojshëm për një shoqëri të informuar. Monitorimi i Pronësisë së Mediave për

Shqipërinë tregon se të ardhurat dhe kontrolli janë të përqendruara në duart e pak grupeve mediatike nën pronësi familjare, që mbizotërojnë në tregun mediatik, qoftë në atë televiziv dhe të shtypur, dhe e përdorin median për të realizuar interesat e tyre politikë dhe ekonomikë, të lidhur me biznese fitimprurëse në tregje me nivel të lartë rregullimi.¹²⁵ Të ardhurat e përfituara nga pronarët e mediave nëpërmjet veprimtarive mediatike janë të papërfillshme në krahasim me ato të përfituara prej veprimtarive të tjera të punës. Këto interesa biznesi janë përqendruar kryesisht te sektorët me shkallë të lartë informaliteti dhe varen nga fondet publike shtetërore nëpërmjet koncesioneve ose subvencioneve. Subvencionet dhe kontratat qeveritare nuk shfrytëzohen vetëm për kanalet mediatike, por edhe për bizneset jomediatike të pronarëve, çka sjell një ndërthurje të mëtejshme të interesave ekonomikë me vendimet redaksionale.¹²⁶

Ligji shqiptar për Mediat audiovizive nuk parashikon kërkesa konkrete në lidhje me transparencën financiare për mediat sa i përket veprimtarisë së tyre. Nuk ka përcaktim kërkesash ligjore që shoqëritë mediatike të raportojnë për financat e tyre përtej detyrimit për t'u raportuar autoriteteve tatimore si biznese private të regjistruara. Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka kontroll mbi origjinën e kapitalit të mediave të licencuara dhe, sikurse në sektorë të tjerë ekonomikë me lidhje të forta me politikën, veprimtaria e shoqërive mediatike i nënshtrohet mbikëqyrjes tatimore nga Administrata Tatimore.¹²⁷ I vetmi përjashtim është transmetuesi i shërbimit publik, RTSH, që i duhet t'i dorëzojë Kuvendit një raport të përvitshëm, që përfshin burimet financiare dhe shpenzimet.¹²⁸ Nuk ka asnjë të dhënë të disponueshme

për përqendrimin e pjesëve të tregut të reklamimit *online* në ekosistemin mediatik të Shqipërisë, duke përfshirë platformat, mediat tradicionale me prezencë në internet, ose mediat plotësisht digjitale. Gjithashtu, ka mungesë edhe të të dhënave të përqindjeve të audiencës për aktorët kryesorë në tregun digjital.¹²⁹ Në Shqipëri mungon një kuadër ligjor i posaçëm për tregun e reklamimit digjital, duke mos pasur asnjë masë për shpërblimin e publikuesve nga platformat digjitale, si dhe asnjë procedurë tatimore ndaj shërbimeve digjitale. Platformat digjitale dhe ndërmjetëse, si motorët e kërkimit dhe rrjetet sociale, vijnë të jenë të parregulluara dhe të paregjistruara nga autoritetet tatimore, pavarësisht pjesës së konsiderueshme që kanë në tregun e reklamimit online.¹³⁰ Në shkurt të vitit 2023, organizatat për lirinë e mediave ngritën shqetësime sa u përket hetimeve dhe gjobitjeve me përzgjedhje nga Drejtoria Tatimore, që shënjestruan mediat kritike ndaj qeverisë.¹³¹ Organizatat për lirinë e medias i bënë thirrje autoritetit tatimor që të qartësonte metodologjinë e përdorur për identifikimin e sektorëve me risk të lartë dhe kriteret e përzgjedhjes së kanaleve mediatike për gjobitje dhe të bënte publikë emrat e të gjitha kanaleve mediatike të gjobitura, bashkë me shumën përkatëse të gjobave,¹³² por kjo nuk ndodhi. Megjithatë shqetësimet lidhur me evazionin fiskal ose mbajtjen e dyfishtë të librave kontabël janë të vlefshme, organizatat për lirinë e medias kanë parashtruar argumentin se sigurimi i paanshmërisë dhe mosdiskriminimit gjatë kryerjes së hetimit është me rëndësi themelore.

Sa i përket transparencës për pronësinë e mediave, regjistri kombëtar i biznesit për median tradicionale dhe ndryshimet e fundit të Ligjit për Mediat

117 Raporti mbi pluralizmin në media – Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias

118 Tregu i reklamave në Shqipëri – Instituti Shqiptar i Medias

119 Treguesit e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor

120 Raporti vjetor i BE-së për Shqipërinë 2023 – Komisioni Evropian

121 AMA organizon tryezën e dytë për matjen e audiencës – Autoriteti i Mediave Audiovizive

122 Barometri i Informimit të Pastër për Shqipërinë 2023 - IREX dhe Raporti mbi pluralizmin në media – Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias

123 Treguesit e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor

124 “Albania: Media freedom in decline due to lack of pluralism and transparency” [Shqipëri: Liria e medias në rënie për shkak të mungesës së pluralizmit dhe transparencës]. Article 19.

125 Monitorimi i Pronësisë së Medias në Shqipëri – BIRN Albania

126 Po aty.

127 Përfundim i autorëve duke u mbështetur tek intervistat

128 Statuti i RTSH-së

129 Raporti mbi pluralizmin në media – Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias

130 Po aty

131 “Albanian Tax Inspectors Fine Critical Media Outlets” [Inspektorët tatimorë në Shqipëri gjobisin kanalet mediatike kritikuese] – BalkanInsight

132 Shihni deklaratën nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt

audiovizive kanë përfshirë në mënyrë të posaçme kërkesa për pronësinë përfituese.¹³³ Parashikohet se AMA do ta rishikojë sërish ligjin për të rritur transparencën proaktive për pronësinë e mediave dhe për të garantuar harmonizimin me standardet e BE-së.¹³⁴ Nga ana tjetër, kanalet mediatike *online* në Shqipëri nuk janë të rregulluara dhe detyrimi i tyre i vetëm është të regjistrojnë faqen e internetit, që mund të kryhet nga çdo individ ose subjekt tregtar apo jofitimprurës.¹³⁵ Nëse janë regjistruar si subjekt tregtar ose jofitimprurës, ato duhet të zbatojnë kuadrin ligjor për pronarët përfitues, pasqyrat financiare dhe bilancet, si dhe rregulloret përkatëse.¹³⁶ Megjithatë, një sërë raportesh¹³⁷ kanë ngritur shqetësime lidhur me portalet *online*, pronësia e së cilave është anonime, që nuk kanë deklarata pronësie dhe nuk respektojnë standardet profesionale të gazetarisë, duke kryer vetëm kopjim dhe ndarje të përmbajtjeve pa verifikim burimesh dhe faktesh. Po bëhen përpjekje për të forcuar vetërregullimin, si ngritja e Aleancës për Media Etike në Shqipëri¹³⁸ ose zbatimi i Nismës për Besimin te Gazetaria¹³⁹, që duhet të fuqizohen më tej.

Këto cenueshmëri mundësojnë hapësirë që aktorët e huaj të promovojnë narrativa të njëanshme dhe i bëjnë kanalet mediatike të prekshme nga dezinformimi dhe ndikimi i huaj. Përmirësimi i transparencës së pronësisë, financimit dhe konfliktit të interesave, fuqizimi i kuadreve rregullatorë për reklamimin digjital, nxitja e ngritjes së mekanizmave të vetërregullimit dhe njohurive për median dhe informimin, si dhe mbështetja e gazetarisë së pavarur janë thelbësore për pakësimin e këtyre rreziqeve.

Rekomandime

- Shqipëria duhet të harmonizojë kuadrin ligjor me Aktin evropian për Lirinë e medias, Aktin për Shërbimet Digjitale dhe Standardet e Këshillit të Evropës për lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes, si dhe të zbatojë rekomandimet e Komisionit të Venecias. Në mënyrë më konkrete, ndryshimet ligjore dhe rregullatore, që duhet të kryhen me transparencë të plotë dhe nëpërmjet një procesi konsultimi të rregullt me organizatat e medias, komunitetin gazetaresk, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, duhet të përfshijnë aspekte kyçe, si:
- Mediat audiovizive duhet të bëjnë publike identitetet e pronarëve përfitues, si dhe të personave që kontrollojnë ose përfitojnë nga shoqëria, me qëllim parandalimin e ndikimit të fshehur ose konflikteve të interesit.
 - Informacioni për pronësinë duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm për publikun nëpërmjet bazave të të dhënave ose regjistrave të mediave, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.
 - Mediat audiovizive duhet të bëjnë të ditur burimet e financimit, duke përfshirë çdo marrëdhënie financiare me partitë politike, qeveritë, ose subjekte të huaja, për të siguruar pavarësi dhe për të parandaluar ndikimet e papërshtatshme.
 - Të ngrihen mekanizma për auditimin dhe verifikimin e rregullt të informacionit për pronësinë nga organe të pavarura, për të siguruar pajtueshmëri dhe saktësi.

- Sa u përket mediave online, Shqipëria duhet t'u përmbahet rekomandimeve të Komisionit të Venecias¹⁴⁰ për forcimin e vetërregullimit dhe më konkretisht:
- Të mbështetet ngritja dhe fuqizimi i një organi vetërregullator të pavarur dhe funksional, të aftë për të garantuar një sistem efektiv dhe të respektuar për llogaridhënien e mediave në fushën e mediave online.
 - Të mbështeten dhe nxiten nismat si Nisma për Besimin te Gazetaria (JTI), që përcakton standarde konkrete për transparencën, duke përfshirë zbulimin e pronësisë, që organizatat e mediave online mund ta zbatojnë për të përmirësuar besimin e publikut.

Të mbështeten përpjekjet e aktorëve të shoqërisë civile për hetimin dhe ekspozimin e lidhjeve ndërmjet pronarëve të mediave dhe interesave të tyre të tjera të biznesit, si dhe të zbatohen masat mbrojtëse për sinjalizuesit që ekspozojnë pronësitë e fshehta ose konfliktet e interesit në organizatat e medias, për të nxitur transparencën dhe llogaridhënien.

Vendimmarrësit në Shqipëri duhet të bëjnë përpjekje konkrete në drejtim të përafrimit të legjislacionit me Aktin Evropian të Shërbimeve Digjitale dhe Aktin për Lirinë e Medias si një qasje e përshtatshme kur bëhet fjalë për ndryshimet e mundshme ligjore për trajtimin e dezinformimit.

24. Organizatat e medias, komuniteti gazetaresk dhe aktorët e shoqërisë civile, bashkërisht me palët e tjera të interesit, si institucionet e pavarura, duhet të përshkallëzojnë përpjekjet për vetërregullimin, mbështetjen e gazetarisë në të mirë të interesit publik dhe hartimin e programeve formale dhe informale, që nxisin edukimin për median dhe informacionin. Forcimi i kapaciteteve të redaktorëve dhe gazetarëve për të identifikuar dhe luftuar

- 140 Rekomandimet e Komisionit të Venecias
141 Kuadri kombëtar rregullator dhe vetërregullator kundër gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit në Shqipëri - Instituti Shqiptar i Medias
142 Nenet 267 dhe 271.
143 Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2020 – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt
144 Deklaratë nga Reporterët pa Kufj
145 Opinion i Komisionit të Venecias

narrativat e huaja të dëmshme, së bashku me mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve, përfshirë kontrollin e fakteve dhe qëndrueshmërinë e sigurisë kibernetike, janë hapa të rëndësishëm për trajtimin e dezinformimit në Shqipëri.

Legjislacioni shqiptar nuk përfshin përkufizim të dezinformimit dhe as dispozita të posaçme për rregullimin e tij.¹⁴¹ Disa nga aspektet e dezinformimit trajtohen nëpërmjet Kodit Penal (ato që lidhen me sigurinë dhe rendin publik).¹⁴² Kodi i Transmetimit i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) parashikon kërkesa për informacion të vërtetë dhe të saktë dhe AMA ka autoritetin të rregullojë përmbajtjen për mediat që ka nën mbikëqyrje. Megjithatë, bota kaotike e portaleve *online*, shumica e së cilave janë anonime, krijon një boshllëk kritik.

Në dhjetor të vitit 2019, Qeveria e Shqipërisë propozoi dy projektligje për rregullimin e medias. Këto ligje përfshinë ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Këto ndryshime, të njohura si “paketa anti shpifje” ose “ligji për mediat *online*”, patën një kundërshtim të fuqishëm nga shoqëria civile dhe organizatat e medias, si dhe nga rrjetet dhe shoqatat mediatike rajonale dhe ndërkombëtare.¹⁴³ Kritikët u shprehën se ndryshimet i garantonin pushtet rregullator të konsiderueshëm Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), pavarësia dhe profesionalizmi i të cilit ishin të dyshimtë, çka mund ta shndërronte AMA-n në një instrument censurimi.¹⁴⁴ Komisioni i Venecias i refuzoi ndryshimet, duke shprehur shqetësimin se ato mund të kufizojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave *online*.¹⁴⁵ Në vitin 2022, Qeveria e tërhoqi plotësisht paketën kundër shpifjes, duke mos kryer asnjë ndryshim ligjor të ri

133 Ndryshimet e ligjit mund t'i gjeni në adresën: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2023/04/13/30/f051e7ee-ef08-41f8-8b73-253e0947bae6>
134 Udhërrëfyes për Shtetin e së drejtës - Këshilli i Ministrave
135 Raporti mbi pluralizmin në media – Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Medias
136 Treguesit e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor
137 “Albania: Media pluralism and transparency concerns fuel deterioration in media freedom” [Shqipëri: Shqetësimet për pluralizmin dhe transparencën e medias nxit degradimin e lirisë së medias] – Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias
138 Ngritja e Aleancës për Media Etike
139 Më shumë në JTI

gjatë vitit.¹⁴⁶ Megjithëse Kryeministri vijon të shprehë synimin për të garantuar rregullimin e mediave *online* gjatë deklaratave të tij publike, asnjë propozim i ri nuk është parashtruar deri në maj të vitit 2024.

Sa u përket përpjekjeve për të bllokuar ose filtruar përmbajtjet në internet, në vitin 2019 dhe 2020 u konstatuan disa raste kufizimesh arbitrare të përmbajtjes së mediave *online* me arsyetimin e shkaktimit të panikut publik në rastet e tërmetit dhe pandemisë së CoVID-19-s.¹⁴⁷ Për shkak të shkaktimit të panikut publik në emergjencën e periudhës pas tërmetit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) mbylli disa portale interneti, të perceptuara si kritikuese ndaj qeverisë.¹⁴⁸ Për shembull, në muajin prill 2020, një kërkesë ndaj AMA-s për të bllokuar një faqe specifike në platformën e njohur *online* të gazetarisë Medium.com, krijuesi i së cilës kishte ngarkuar dhe po kryente transmetimin e një kopjeje të piratuar të një filmi nga komediani shqiptar Ermal Mamaqi, rezultoi në bllokimin e përkohshëm të të gjithë platformës nga disa Ofrues të Shërbimit të Internetit (OSHI).¹⁴⁹ Në përgjigje të kësaj, Këshilli Shqiptar i Medias kritikoi bllokimin e Medium.com si censurë. Që prej asaj kohe, AMA ka krijuar një procedurë të brendshme për shmangien e problemeve të tilla dhe në vitet 2022-2023 nuk pati asnjë raportim të ngjashëm.¹⁵⁰

Në vitin 2020, Këshilli Shqiptar i Medias ngriti Aleancën Shqiptare për Media Etike si një mekanizëm vetërregullimi për të zbatuar Kodin e Etikës së medias në vend. Aleanca përbëhet nga një grup vullnetar i kanaleve mediatike shqiptare, që kanë marrë përsipër zbatimin rigoroz të Kodit të Etikës për Gazetarët.¹⁵¹ Në kuadër të zbatimit të një mekanizmi vetërregullimi funksional, aleanca shqyrton ankesat nga publiku lidhur me shkeljet e etikës të mediave *online* dhe ofron rekomandime ndaj

kanaleve mediatike, por që nuk janë të detyrueshme. Gjithashtu, aleanca ka hartuar edhe “Udhëzimet etike për gazetarinë *online*” për të garantuar zbatimin e praktikave etike nga ana e mediave *online*. Megjithatë, ky zbatim vijon të jetë i dobët dhe i pastrukturuar.

Rekomandime
- Organet publike dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të fuqizojnë programet formale dhe informale ekzistuese, si dhe të hartojnë programe të reja dhe të qëndrueshme, që promovojnë edukimin e publikut për median dhe informacionin, duke u mundësuar qytetarëve që të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin që konsumojnë dhe të reduktojnë ndikimin e dezinformimit. - Mekanizmi i vetërregullimit duhet të përmirësohet duke i bërë rekomandimet të detyrueshme dhe duke siguruar zbatimin rigoroz të Udhëzimeve etike për gazetarinë online dhe Kodit të etikës së medias. Në këtë mënyrë, llogaridhënia dhe standardet etike në industrinë mediatike do të përmirësohen. - Organizatat e medias, donatorët, organizatat e shoqërisë civile dhe palët përkatëse të interesit duhet të investojnë në programe trajnimi për redaktorët dhe gazetarët, që të përmirësojnë aftësitë e tyre të verifikimit të fakteve, identifikimit të narrativave të huaja dashakeqe dhe për të ndërtuar qëndrueshmëri në sigurinë kibernetike. Në këtë mënyrë, profesionistët e medias do të fuqizohen për të luftuar me efektivitet dezinformimin. - Kanalet mediatike, në prezencën e tyre digjitale (online dhe në media sociale) duhet të ofrojnë mundësi që përdoruesit të paraqesin ankesa, si dhe të respektojnë parimet e korrigjimeve të publikimeve sipas nevojës. Krahas kësaj, kanalet

146 Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2022 – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt
147 Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2020 – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt
148 Po aty.
149 Qeverisja e internetit në Shqipëri
150 Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2022 – Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt
151 Po aty.

- mediatike, në prezencën e tyre digjitale (online dhe në media sociale) duhet të kontrollojnë në mënyrë të përgjegjshme komentet për të mbrojtur lirinë e shprehjes, por duke respektuar privatësinë dhe dinjitetin e përdoruesve.
- Studiuesit dhe shoqëria civile, bashkë me mediat e pavarura, duhet të vijnë me monitorimin dhe analizimin e përmbajtjes së mediave të huaja me financim shtetëror për të kuptuar strategjitë dhe temat e mesazheve të tyre, si dhe ndikimin e mundshëm ndaj opinionit publik. Në këtë mënyrë, narrativat e huaja dashakeqe do të mund të identifikohen dhe luftohen.
- Nismat ekzistuese për verifikimin e fakteve nga organizatat e medias dhe platformat e veçanta të verifikuesve të fakteve duhet të përmirësohen, për të siguruar saktësinë e informacionit të shpërndarë. Në këtë mënyrë, besimi i publikut ndaj medias do të rritet dhe do të përmirësohet lufta kundër dezinformimit.
- AMA dhe AKEP-i duhet të krijojnë procedura të qarta dhe të drejta për kufizimet e nevojshme të përmbajtjeve, duke u bazuar te kuadri ligjor dhe duke shmangur veprimet arbitrare, që mund të konsiderohen si censurë, si dhe të sigurojnë se masat e ndërmarra do të jenë të justifikuara dhe proporcionale.
- Të propozohen ndryshime ligjore për të siguruar pavarësinë dhe profesionalizmin e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe organeve të tjera rregullatore.

25. Shqipëria ka ngritur një arkitekturë institucionale dhe ka hartuar një kuadër ligjor për sigurinë kibernetike, por institucionet vijnë të përballen me kufizime të konsiderueshme sa i përket kapacitetit njerëzor dhe integritetit të stafit për kryerjen e funksioneve delikate kyçe të menaxhimit të të dhënave. Shtrirja e partneriteteve ndërkombëtare, programet e reja edukuese dhe vlerësimet e përmirësuara të integritetit konsiderohen si aspekte thelbësore për arritjen e rezultateve më të mira.

152 “Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2020-2025” Qeveria Shqiptare.
153 “Pasiguria e të dhënave personale rrezikon ‘qeverisjen digjitale’ të Shqipërisë” – Reporter.

Shqipëria ka ngritur një arkitekturë institucionale dhe ka hartuar një kuadër ligjor për sigurinë kibernetike, që përfshin dokumente politikash, si Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike. Megjithatë, incidentet e fundit të theksuara në këtë raport nxorën në pah një sërë cenueshmërisht ndaj depërtimit të aktorëve të huaj, që cenojnë mjedisin e informacionit ose përdorin të dhënat personale për veprimtari zgjedhore. Dy cenueshmëritë institucionale kryesore kanë të bëjnë me çështjet e kapacitetit dhe integritetit institucional. Sa u përket kapaciteteve, shumica e institucioneve publike shfaq mangësi në trajtimin e të dhënave dhe në infrastrukturën kritike. Këto mangësi lidhen, së pari, me mungesën e instrumenteve për sigurimin e informacionit kibernetik në organet ligjzbatuese, ose në burimet njerëzore në institucionet kyçe, sikurse është theksuar edhe në Strategjinë për Sigurinë Kibernetike.¹⁵² Megjithatë, institucioni kryesor dhe pika kritike për parandalimin është Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), organi kombëtar koordinues për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike dhe operatorëve të infrastrukturës kritike. Mangësitë në kapacitet ekzistojnë edhe në organet ligjzbatuese kryesore përgjegjëse, duke përfshirë Njësitë e Hetimit të Krimit Kibernetik në prokurori dhe Policinë e Shtetit. Gjatë muajve të fundit, Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me vende të ndryshme në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në fjalë. Megjithatë, disa nga skandalet madhore në Shqipëri nuk ishin rezultat i hakerimit aq sa ishin pasojë e rrjedhjeve të brendshme të informacionit nga anëtarët e stafit. Nxjerrja e të dhënave personale të qytetarëve (si tatimet) erdhi si rezultat i zyrtarëve të korruptuar në këto institucione, të nxitur nga përfitime financiare (korrupsioni) ose nga besnikëria ndaj partive politike.¹⁵³ Si rrjedhojë, nevojiten masa mbrojtëse institucionale më të forta për të siguruar integritetin e burimeve njerëzore në pozicione që trajtojnë të dhëna delikate.

Rekomandime

- Shqipëria duhet të harmonizojë plotësisht ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian.
- T'i jepet prioritet zhvillimit të kapaciteteve për departamentet e TI-së në institucionet kyçe që punojnë me të dhëna delikate, veçanërisht AKSCESK, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), agjencitë ligjzbatuese, Regjistri Kombëtar i Biznesit dhe të tjera.
- Të kryhet hartëzimi i funksioneve të shërbimit civil me akses te të dhëna delikate ose tek infrastruktura kritike dhe të hartohet një plan integriteti i posaçëm për këto pozicione, duke përfshirë një program specifik për zhvillimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e procedurave dhe infrastrukturave ekzistuese.
- Të vijohet me kërkimin e ndihmës dhe lidhjen e marrëveshjeve të partneritetit me vendet me aftësi të mira sigurie kibernetike, veçanërisht për ngritjen e kapaciteteve ligjzbatuese.
- Të ngrihen kapacitetet e shoqërisë civile dhe redaktorëve mediatikë sa i përket trajtimit dhe raportimit të të dhënave personale të marra nëpërmjet sulmeve kibernetike.
- T'u jepet prioritet programeve edukuese për sigurinë kibernetike dhe Kërkimit dhe Zhvillimit në sektor nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe sektorit privat.
- Të ndërtohet qëndrueshmëria kibernetike e mediave, gazetarëve, mbikëqyrësve, aktivistëve dhe individëve të tjerë për të garantuar llogaridhënien e personave në pushtet.

06

RRUGA 3: FLUKSET E KAPITALIT GËRRYES

a. Si shfaqet kjo ndërhyrje?

26. Megjithëse në Shqipëri nuk janë konstatuar investime të konsiderueshme të huaja direkte (IHD) nga burime të njohura kapitali gërryes, vendi nuk ka qenë i paprekshëm nga risku që elitat vendase të angazhoheshin në transaksione me individë dhe subjekte të huaja me agjenda të fshehta. Shkalla e disa projekteve të investimit, sidomos ato në pasuritë e paluajtshme, si dhe në PPP, të cilave shpesh u mungon transparencja, krijojnë hapësirë për kanalizimin e kapitalit gërryes, i cili mund të përdoret për të ndikuar në politikën shqiptare.

Struktura e flukseve të IHD-ve në Shqipëri (shihni Shtojcën 2) redukton shqetësimet për format më të dukshme të kapitalit gërryes, që lidhet shpeshherë me investime infrastrukturore të mëdha, me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ose me naftën, gazin dhe minierat, dhe që e ka fillesën te burime famëkeqe, si ato të Rusisë dhe Iranit ose Kinës. Së fundmi, janë ngritur shqetësime dhe ka pasur debate në lidhje me rritjen e fluksit të IHD-ve dhe blerjeve nga Hungaria dhe rolin e mundshëm për të shërbyer si kanale për transferimin e kapitalit rus. Megjithatë, shumica e të intervistuarve nuk i konsideron këto shqetësime si të rëndësishme. Një fushë me shqetësim më të madh mendohet të jenë interesat e mbivendosur të politikanëve, investitorëve të huaj dhe figurave

të krimit të organizuar. Disa nga të intervistuarit shprehën shqetësime të papërcaktuara për lidhjet e mundshme të krimit të organizuar shqiptar me organizatat e tjera kriminale ruse, por pa dhënë hollësi për këtë. Disa prej tyre sugjeruan edhe se ekzistojnë gjasa që biznesmenët vendas mund të kenë lidhje me investitorë rusë, çështje kjo që është diskutuar edhe në media.¹⁵⁴ Një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve i pohuan këto shqetësime nëpërmjet shembujve seriozë, që përfshinin veprimtarinë e oligarkut rus të dënuar Oleg Deripaska në Shqipëri (shihni Kutizën 7).

Kutiza 7: Deripaska në Shqipëri

Oligarku rus Oleg Deripaska ka qenë një investitor aktiv në Rusi, me interesa të shumtë në shoqëri tregtare të mirënjohura evropiane dhe aziatike, ku përfshihet edhe Strabag, një shoqëri austriake në të cilën ai zotëronte një përqindje të konsiderueshme aksionesh. Më 8 prill 2018, Oleg Deripaska u dënua nga SHBA-ja për veprimet e kryera ose të supozuara për ose në emër të, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari të lartë të Qeverisë së Federatës Ruse, dhe për veprimtarinë në sektorin energjetik të ekonomisë së Federatës Ruse. Deripaska kishte kryer investime të konsiderueshme në Shqipëri. Nëpërmjet përdorimit të strukturës së korporatës së subjekteve të ndryshme në të cilat ishte aksionar, duke përfshirë shoqëritë Strabag dhe Trema Engineering 2, si dhe marrëveshjeve të sipërmarrjes së përbashkët me bizneset vendase, Deripaska përfitoi një sërë kontratash. Gjatë periudhës 2019-2021, pas dënimit nga SHBA-ja, Fondi Shqiptar i Zhvillimit mbështeti disa nga projektet e zbatuara nga shoqëritë në të cilat Deripaska ishte pjesë e listës së aksionarëve.

Investimet në pasuri të paluajtshme në sektorin e hotelierisë kanë sjellë një rritje domethënëse të pikave turistike, në pjesët qendrore dhe jugore të vendit dhe në kryeqytetin e Tiranës, çka përbën një tjetër fushë madhore shqetësuese. Shumica e investimeve është zbatuar nga investitorët vendas ose ata nga Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilët, në disa raste, kanë lidhur marrëveshje franshize me marka të mirënjohura ndërkombëtare të hotelierisë. Vlen të theksohet se, disa nga këto projekte kanë fituar edhe statusin e investitorëve strategjikë sipas Ligjit 55/2015 “Për

investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. “Rezidenca Vlora Marina” dhe “Durrës Marina & Yachts” janë dy investime strategjike që përfshijnë ndërtimin e porteve dhe njësive për akomodimin e turistëve dhe banorëve në dy qytetet shqiptare, për të cilat parashikohet edhe ndërtimi i godinave të banimit dhe atyre të hotelierisë (shihni Kutizën 8 dhe 9 më poshtë). Disa nga të intervistuarit ngritën shqetësime për blerjet e mundshme nga individë të lidhur me krimin transkombëtar, përfshirë grupe shqiptare dhe të mafies italiane, por aktualisht nuk ka asnjë provë për përfshirjen e drejtpërdrejtë të individëve ose subjekteve nga vende jomiqësore në zbatimin e këtyre projekteve. Disa prej tyre përmendën edhe faktin se në blerjen e pronave në tregun e pakicës mund të jenë përfshirë edhe individë rusë.

Kutiza 8: Durrës Marina & Yachts

Projekti “Durrës Marina & Yachts” është një projekt ambicioz që synon ta transformojë qytetin. Një nga objektivat kryesorë të këtij projekti është zhvendosja e portit industrial nga vendndodhja aktuale në qendër të qytetit te një vendndodhje tjetër, në pjesën veriore të qytetit. Zhvillimi i projektit, që i filloi shitjet në dhjetor të vitit 2022, është një përpjekje bashkëpunuese ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë (që zotëron 33% të aksioneve nëpërmjet shoqërisë “Albanian Seaports Development Company”) dhe dy shoqërive nga Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA), konkretisht “Eagle Hills Real Estate Development” sh.a., dhe “Nshmi Development LLC” (që së bashku zotërojnë 67% të aksioneve). Pavarësisht të qenit një investim që zotëron një pozicion strategjik dhe përfiton nga lehtësirat tatimore për infrastrukturën dhe ndërtimin, plani i biznesit ka marrë kritika nga mediat dhe të intervistuarit për shkak të fokusit të theksuar te zhvillimi i hapësirave të banimit. Parashikohet se një përqindje e vogël, konkretisht më pak se 5%, e ndërtimit të planifikuar do të shërbejë për qëllime hotelierie dhe ngritjen e dyqaneve me pakicë. Krahas kësaj, koncepti përfshin gjithsej 280 struktura ankorimi të projektuara posaçërisht për jahtet. Plan i financimit të apartamenteve lehtëson pagesat paraprake dhe shitjen e apartamenteve në një mënyrë të barasvlershme me praktikën e zakonshme në vend. Investimi fillestar i projektit arrin vlerën e 595 milionë eurove.

Kutiza 9:

Vlora Marina

Vlora Marina Residences është subjekti përgjegjës për ndërtimin e godinave të banimit në projektin Vlora Marina, që u përcaktua si një investim strategjik nga Këshilli për Investimet Strategjike më 29 mars 2021. Vlora Marina zotëron 72% të aksioneve në Vlora Marina Residences, Balfin zotëron 10% të aksioneve dhe Brunos zotëron 18% të aksioneve. Projekti Vlora Marina, që është përcaktuar si një investim strategjik, parashikohet të kryhet nëpërmjet një investimi prej 105 milionë eurosh dhe do të punësojë 1.000 persona gjatë ndërtimit dhe operimit. Statusi i këtij projekti nënvizon se do të ndërtohen njësi akomodimi, hotele dhe shërbime standarde në zonën në kufi me infrastrukturën portuale. Projekti parashikon zhvillimin kompleks të zonës pranë projektit koncesionar të Marinës Vlorë nëpërmjet ndërtimit të strukturave të akomodimit, zonave të banimit dhe shërbimeve në kapacitetet përkatëse.

Është konstatuar se shumë nga partneritetet publike private (PPP) në Shqipëri kanë përdorur subjekte të ngritura në juridiksione që lejojnë ekzistencën e shoqërive guaskë, si Vendet e Ulëta, ose në parajsë të tjera fiskale. PPP-të kanë ngjallur debat të konsiderueshëm lidhur me cilësinë e projekteve, procesin e përzgjedhjes së projekteve dhe shoqëritë e përfshira në zbatimin e tyre, si dhe për raste të supozuara korrupsioni. Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) po heton disa PPP në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë sektorin e përpunimit të mbetjeve dhe atë të kujdesit shëndetësor. Disa raste kanë rezultuar në arrestimin dhe burgosjen e politikanëve shqiptarë . Megjithatë këto raste mund të jenë thjesht skandale korrupsioni me përfshirjen e elitës politike vendase, natyra e dyshimtë dhe ndërkombëtare e transaksioneve krijojnë hapësirë dhe cënueshmëri që mund të shfrytëzohen nga aktorët e huaj.

27. Gjurma e IHD-ve kineze në Shqipëri është e kufizuar në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Shumë nisma nuk janë konkretizuar dhe disa investitorë kinezë në sektorë strategjikë janë tërhequr, duke ulur mundësinë për varësi politike. Drejtuesit e Shqipërisë kanë qenë skeptikë për përfitimet ekonomike të bashkëpunimit nëpërmjet formatit 16+1, por kanë qëndruar në grup për të vijuar dialogun me Pekinin.

Disa nisma ndërmjet qeverive kanë mbështetur rritjen e numrit të IHD-ve kineze në Ballkanin Perëndimor. Në prill të vitit 2012, përfaqësues të shtetit kinez paraqitën deklaratën “Dymbëdhjetë masa për promovimin e bashkëpunimit miqësor me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore” në Varshavë, duke prezantuar formatin gjashtëmbëdhjetë plus një (16+1).¹⁵⁵ Më pas, formati 16+1 u përdor si një platformë kritike për promovimin e Nismës “Brez dhe Rrugë” (BRI) në Ballkan dhe në vende të tjera të Evropës Lindore, duke anashkaluar rolin e Bashkimit Evropian dhe duke përfituar nga ndasitë ekzistuese. Shqipëria iu bashkua formatit 16+1 dhe mori pjesë në mënyrë aktive në takime që prej fillimit të tij. Për të tërhequr më shumë investime kineze, delegacionet shqiptare kanë kryer vizita të shpeshta në Kinë dhe në Rajonin e Posaçëm Administrativ të Hong Kongut për të promovuar burimet dhe mundësitë që Shqipëria ofron për investitorët e mundshëm nga Hong Kongu dhe Kina.

Që prej nisjes së BRI-së, veçanërisht prej vitit 2013 deri në 2023, pati shumë premtime dhe diskutime për investime, por pak prej tyre u zbatuan. Prania e Kinës në sektorët strategjikë është e kufizuar (shihni Kutizën 10). Disa shoqëri kineze, duke përfshirë Everbright (që kontrollonte Aeroportin e Rinasit) dhe Wenzhou Mining, i kanë tërhequr investimet e tyre gjatë dekadës së fundit.¹⁵⁶ Edhe përpara nisjes formale të BRI-së, Korporata Shtetërore e Kinës për Inxhinierinë e Ndërtimit interesohej që të përfshihej në ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”, një nga rrugët kryesore të vendit, që

lidh Shqipërinë me Maqedoninë e Veriut. Kryeministri Berisha e konsideroi këtë ofertë tërheqëse në vitin 2013.¹⁵⁷ Qeveria socialiste, nën drejtimin e Edi Ramës, që erdhi në pushtet në shtator të vitit 2013, nuk e zbatoi këtë transaksion. Disa nga të intervistuarit pohuan se arsyeja përse Qeveria shqiptare vendosi të kryente ndërtimin e rrugës me investitorë të tjerë bazohej te vlerësimi i kushteve ekonomike të ofruara nga shoqëria kineze. Vlen të përmendet se Shqipëria vijon të jetë i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor (pa përfshirë Kosovën) ku shoqëritë kineze nuk kishin fituar asnjë tender për punë publike në infrastrukturë deri në fund të vitit 2018.¹⁵⁸

I vetmi IHD kinez i rëndësishëm ende i pranishëm në Shqipëri është Korporata “Geo-Jade Petroleum” pas blerjes së shoqërisë kanadeze të naftës “Bankers Petroleum”. “Bankers Petroleum” filloi eksplorimin në Shqipëri në vitin 2004 dhe siguroi një pozicion dominues në nxjerrjen e naftës në Shqipëri pasi drejtuesit e shoqërisë kishin reputacion të mirë në vend. Korporata “Geo-Jade Petroleum” e bleu “Bankers Petroleum” në vitin 2016 për 393 milionë euro. Blerja u pasua nga një investim shtesë prej 2 miliardë dollarësh në prodhimin e naftës. Një tjetër shoqëri kineze ende e pranishme në Shqipëri është “Sinomine Resource Exploration”, që ka themeluar një shoqëri bijë në Shqipëri dhe punon për ndërtimin e minierave dhe hartimin e testeve gjeologjike në bashkëpunim me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Themeluesi i “Alibaba”, Jack Ma, vizitoi Shqipërinë gjatë verës së vitit 2023. Vizita nxiti disa diskutime në media në lidhje me investime të mundshme. Më herët, kur Jack Ma po rekrutonte staf për “Alibaba”, udhëtimet e tij në vende të ndryshme u paraprinin blerjeve ose investimeve madhore në logjistikë, por tashmë ai nuk ka asnjë funksion drejtues.

Kutiza 10:

Prezenca kineze në sektorët strategjikë të Shqipërisë

Nafta, gazi dhe miniera. Në prill të vitit 2016, shoqëria kineze «Geo-Jade Petroleum» pagoi 575 milionë dollarë për blerjen e fushave naftëmbajtëse në Patos-Marinzë dhe Kuçovë prej shoqërisë kanadeze të naftës «Bankers Petroleum». Krahas kësaj, shoqëria kineze «Sinomine Resource Exploration» ka themeluar një shoqëri bijë në Shqipëri. Kjo shoqëri bashkëpunon me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar për kryerjen e testeve gjeologjike dhe punon për zhvillimin e minierave. Vitet e fundit, në sektorin e naftës dhe gazit në Shqipëri ka pasur rritje investimesh prej shoqërive perëndimore, si «Shell» dhe «Eni». «Shell» ka kryer disa zbulime të rëndësishme në Shpirag, por nevojiten eksplorime të mëtejshme për të vlerësuar realizueshmërinë ekonomike të procesit të nxjerrjes.

Aeroportet: Në vitin 2004, qeveria e Nanos nënshkroi një kontratë koncesioni për Aeroportin e Rinasit, i vetmi aeroport në Shqipëri, ndaj një subjekti të përbërë nga tri shoqëri (Fondi Amerikano-Shqiptar i Ndërmarrjeve, DEG-Investimet Gjermane, dhe AviAlliance GmbH). Kontrata përfshinte një klauzolë për monopolin, që e pengonte qeverinë shqiptare të ndërtonte aeroporte të tjera. Koncesionari i huaj ia transferoi të drejtat e menaxhimit të aeroportit «Real Fortress Private Limited», një shoqëri nën pronësinë e grupit kinez të shërbimeve financiare «China Everbright», një ndërmarrje shtetërore (NSH) kineze. “China Everbright” mori koncesionin ndaj Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës deri në vitin 2025 me mundësinë e shtyrjes dyvjeçare të afatit. Pavarësisht kontratës afatgjatë, parashikimit pozitiv dhe në një kohë kur aeroporti ishte i vetmi në Shqipëri, “China Everbright” vendosi të tërhiqej dhe t’ia transferonte të drejtat Grupit Kastrati, një investitor vendas.

Telekomunikacioni: Vitin e kaluar, Grupi “4iG” bleu operatorët fiks dhe celularë “ALBtelecom” dhe “ONE Telecommunications” në Shqipëri, të cilët më pas u bashkuan në një operator të vetëm telekomunikacioni, duke i siguruar operatorit hungarez një pozicion mbizotërues në tregun shqiptar, çka mund të shkaktojë deformime të tregut. “Huawei” dhe shoqëri të tjera kineze që ofrojnë zgjidhje dhe produkte TIK-u bashkëpunojnë me “4iG” dhe shoqëritë e tjera të mëdha të telekomunikacionit që operojnë në Shqipëri. Disa nga këto shoqëri kineze konsiderohen si kërcënim ndaj sigurisë së rrjeteve të telekomunikacioneve në disa nga vendet e NATO-s, të cilat kanë vendosur të reduktojnë përdorimin e produkteve të tyre. Madje, SHBA-ja i ka sanksionuar disa prej këtyre shoqërive. “Hikvision” është një tjetër shoqëri kineze e sanksionuar nga SHBA-ja, produktet e së cilës përdoren gjerësisht në Shqipëri.

155 Formati njihej me emrin 17+1

156 Kromi shqiptar zotërohej nga Balfin Group. Shihni: <https://www.reuters.com/article/uk-albania-mine-chinese-idUKKBN15P1CK>

157 “Berisha: kompania kineze, ofertë të leverdisshme për Rrugën e Arbrit”. Shqiptarja.com.

158 “The Pragmatic Engagement of China in the Western Balkans” [Angazhimi pragmatik i Kinës në Ballkanin Perëndimor] – Instituti i CDI-së.

b. Cilat janë cenueshmëritë institucionale madhore në Shqipëri?

28. Shqipëria ka një regjim të hapur të investimeve të huaja të parashikuar për të tërhequr IHD, por i mungon një mekanizëm i vlerësimit formal, i cili do të kufizonte ose ndalonte IHD-të që kërcënojnë sigurinë kombëtare ose rendin publik. Shqipërisë i nevojitet një legjislacion i ri që krijon një Mekanizëm të qëndrueshëm të Shqyrtimit të Investimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, i cili siguron mbrojtjen e duhur për sigurinë kombëtare dhe rendin publik, dhe mbron konkurrencën.

Shqipëria ka një regjim të hapur të investimeve të huaja të parashikuar për të tërhequr IHD, në nivelin e traktateve dhe legjislacionit kombëtar. Ligji për Investimet e huaja parashikon masa mbrojtëse të posaçme për investorët e huaj. Ai lejon 100% pronësi të huaj të shoqërive, me përjashtim të transportit ajror të pasagjerëve brenda dhe jashtë vendit, si dhe transmetimit televiziv. Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare sipas Organizatës Botërore të Tregtisë dhe parimeve që formësojnë ligjin ekonomik ndërkombëtar. Legjislacioni shqiptar nuk bën dallim ndërmjet investimeve vendase dhe të huaja. Ligji për Investimet e huaja i mundëson Shqipërisë të ndërmarrë çdo lloj veprimi që e shihet të nevojshëm për ruajtjen e rendit publik, për përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare të lidhura me ruajtjen ose krijimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ose për mbrojtjen e sigurisë kombëtare apo interesave të mbrojtjes. Me arsyetimin e ruajtjes së sigurisë kombëtare dhe rendit publik, Shqipëria mund të kufizojë dhe refuzojë investimet e huaja. Megjithatë, ligji nuk shtjellon sa u përket situatave që mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe rendin publik.

Si pasojë e drejtpërdrejtë, qeveria shqiptare gëzon autoritet të konsiderueshëm për përcaktimin e mënyrës së interpretimit të rendit publik dhe sigurisë

kombëtare. Pavarësisht kësaj, nuk ka asnjë kërkesë ndaj organeve rregullatore për miratimin paraprak ose vlerësimin e investimeve të huaja. Investorët e huaj duhet të respektojnë ligjin shqiptar nëse hyjnë në tregun shqiptar, në varësi të llojit të veprimtarisë që do të kryhet (financiare, energjetikë dhe minierë, transport, infrastrukturë për komunikimet elektronike, etj.). Megjithëse legjislacioni në fuqi kontrollon dhe vendos kufizime, këto ligje nuk përfshijnë parashikime për kontrollin në kuadër të sigurisë kombëtare dhe rendit publik. Një dispozitë e re në Ligjin për Naftën, e përfshirë në vitin 2017, i lejon qeverisë që të refuzojë një marrëveshje për ndarjen e naftës ose shitjen e aksioneve në një marrëveshje për ndarjen e naftës ndaj investorëve të mundshëm për shkak të shqetësimeve për sigurinë kombëtare.

Një tjetër rast është ai i sektorit të telekomunikacionit. Shqipëria ka ndjekur “Nismën për Rrjete të Pastra” (CNI) të udhëhequr nga Amerika. CNI-ja synon të sigurojë standardet e besimit digjital në të gjitha koalicionet e demokracive, si dhe të përcaktojë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj mbrojtjes së aseteve të kombit, si dhe të privatësisë së qytetarëve dhe informacioneve më delikate të shoqërive, nga ndërhyrjet agresive nga aktorë dashakeqë, si Partia Komuniste Kineze.¹⁵⁹ Në mënyrë të veçantë, ajo thekson rreziqet e sigurisë për vendet që mbështeten te teknologjia 5G kineze,¹⁶⁰ dhe në veçanti te gjigantët kinezë të telekomunikacionit, si “Huawei” dhe “ZTE”, që ishin të gatshëm për të kryesuar në teknologjinë 5G. Administrata e Trump-it krijoi CNI-në, që pati një mbështetje të konsiderueshme dhe u pranua nga më shumë se 60 vende. Megjithatë, CNI-ja nuk krijon detyrime ligjore të zbatueshme, por vetëm pritshmëri politikash në lidhje me investimet në këta sektorë. Në mënyrë që këto pritshmëri politikash të shndërrohen në instrumente legjislative vendase domethënëse, autoritetet shqiptare duhet të përfshijnë norma të reja për të zvogëluar boshllëkun rregullator.

159 Shihni përshkrimin e “Rrjetit të pastër” në faqen e Departamentit të Shtetit: <https://2017-2021.state.gov/the-clean-network/>
160 “Albania steps up 5G aspirations with the new draft law” [Shqipëria përshkallëzon aspiratat për 5G me projektligjin e ri] EURACTIV.

Shqipërisë i nevojitet një ligj i ri që parashikon një Mekanizëm për Shqyrtimin e Investimeve (MSHI) dhe që përfshin përkufizime të qarta të: a) sigurisë kombëtare; b) infrastrukturës kritike (energjetika, transporti, uji, shëndetësia, komunikimet, media, përpunimi ose ruajtja e të dhënave, infrastruktura zgjedhore ose financiare, si dhe strukturat delikate dhe investimet në blerje toke dhe pasurie të paluajtshme që janë thelbësore për përdorimin e infrastrukturave në fjalë); c) teknologjitë kritike dhe objektet me përdorim të dyfishtë (duke përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën, gjysmëpërcjellësit, sigurinë kibernetike, kuantumin, hapësirën ajrore, mbrojtjen, ruajtjen e energjisë dhe teknologjitë bërthamore, nanoteknologjitë dhe bioteknologjitë); d) aksesin ose aftësinë për të kontrolluar informacionet delikate (përfshirë të dhënat personale) dhe; e) lirinë dhe pluralizmin e medias. Ligji për MSHI-në duhet të parashikojë edhe kufizimin e pushtetit diskrecional të qeverisë sa i përket zbatimit të tij.

Rekomandime

- Nevojitet hartimi i një ligji të ri, që parashikon ngritjen e një mekanizmi për shqyrtimin e investimeve me përkufizime të qarta të: a) sigurisë kombëtare; b) infrastrukturës kritike; c) teknologjive kritike dhe objekteve me përdorim të dyfishtë; d) aksesit ose aftësisë për të kontrolluar informacione delikate dhe e) lirisë dhe pluralizmit të medias.
- MSHI-ja krijon një pushtet diskrecional të konsiderueshëm, që i akordohet një autoriteti të caktuar. Nëse ekzekutivi kontrollon MSHI-në, atëherë ka gjasë që partia qeverisëse të përfitojë pushtet dhe diskrecion shtesë. Për këtë arsye, duhet që, gjatë hartimit të legjislacionit për MSHI-në, të ruhet balanca ndërmjet ndikimit të ekzekutivit duke përfshirë autoritetin e grupeve të interesit, si komuniteti i biznesit, në procesin e vendimmarrjes.

161 Rregullorja e BE-së 2019/452, Neni 13 Bashkëpunimi ndërkombëtar. Shtetet Anëtare dhe Komisioni mund të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve të treta për çështjet që kanë të bëjnë me shqyrtimin e investimeve të huaja direkte bazuar te siguria dhe rendi publik.

- Ligji duhet të marrë parasysh edhe ndikimin e investimeve të caktuara te konkurrenca e tregut. Në disa sektorë, vlerësimi do të paraqesë pengesa të konsiderueshme për shkak të teknologjive të avancuara të përdorura në disa projekte investimi dhe mungesës së transparencës sa i përket natyrës së investorëve pjesëmarrës në projekt. Për të trajtuar këto pengesa, ligji i ri duhet të mundësojë bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe efektiv ndërmjet MSHI-së shqiptare dhe MSHI-së në rajon dhe në BE. Në këtë këndvështrim, Rregullorja e BE-së 2019/452 parashikon ngritjen e një platforme për bashkëpunim¹⁶¹, që do të shtrihet tek autoritetet e BE-së dhe shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s.
- Reforma e Ligjit shqiptar për investimet e huaja duhet të marrë parasysh edhe nevojën për koordinim me mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Ligji duhet të pengojë aksesin tek arbitrazhi ndërmjet investorëve dhe shtetit për vendimet e marra në kuadër të mbrojtjes së sigurisë kombëtare në përputhje me dispozitën e shqyrtimit të MSHI-së.

29. Flukset e kapitalit gërryes mund të përfitojnë nga abuzimet me masat mbrojtëse në Marrëveshjet e Investimeve Ndërkombëtare (IIA). Aktorët mashtrues po përpiqen të përdorin mbrojtje në arbitrazhin ndërmjet investorëve dhe shtetit për të sfiduar masat ndëshkuese të qeverisë. Gjuha e IIA-ve duhet të përditësohet për të qartësuar të drejtën sovranë për të mbrojtur rendin publik, sigurinë kombëtare dhe sektorët e ndjeshëm ekonomikë dhe strategjikë. Agjencitë qeveritare dhe autoritetet e pavarura duhet të përmirësojnë koordinimin dhe të sigurojnë përputhshmëri rregullatore në rastin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare, caktimin e statusit të Investorit Strategjik, zbatimin e dispozitave të Pronarit të Vetëm Përfitues (PVP) dhe konkurrencën e tregut.

Shqipëria ka lidhur marrëveshje dypalëshe investimi me 45 vende. Ajo ka nënshkruar marrëveshje për tregtinë e lirë me BE-në, vendet e CEFTA-s (Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë

dhe Moldavi), vendet e EFTA-s (Zvicër, Lihtenshtejn, Norvegji dhe Islandë) dhe me Turqinë. Rrjeti shqiptar i marrëveshjeve përfshin edhe marrëveshjet me Kinën dhe Rusinë. Këto marrëveshje u mundësojnë investitorëve të ngrenë çështje të arbitrazhit investitor-shtet kundër Shqipërisë nëse mendohet se autoritetet shqiptare nuk i kanë respektuar detyrimet e marrëveshjes. Ka shqetësime serioze se investitorët e lidhur me krimin e organizuar në Shqipëri po e përdorin sistemin për të kushtëzuar vendimet gjyqësore dhe qeveritare. Ky shqetësim ka ndërlikime praktike të rëndësishme. Departamenti Amerikan i Thesarit e ka sanksionuar Ylli Ndroqin, i cili është ende nën hetim në Shqipëri. Pas hetimit nga autoritetet ligjzbatuese shqiptare, pasuritë e tij u ngrinë sipas ligjit të Shqipërisë për antimaftan. Bashkëshortja e tij, Mimoza Ndroqi, parashtroi një pretendim në arbitrazhin ndërkombëtar (UNCITRAL) sipas marrëveshjes dypalëshe të investimeve Bullgari-Shqipëri, si një investitore bullgare. Investitori po i kërkon shtetit shqiptar të paguajë 128 milionë euro si kompensim për sekuestrimin e aseteve të biznesit në përputhje me ligjin për antimaftan. Përballja me këto pretendime mund të përfaqësojë një risk të konsiderueshëm ekonomik për shtetet, jo vetëm në rastin e rezultateve negative të mosmarrëveshjes. Madje edhe në ato raste kur shteti ia ka dalë të mbrojë pozicionin e vet, mund t'i duhet të mbulojë tarifat e larta ligjore për të mbrojtur zbatimin e vendimeve të rendit publik. Marrëveshjet ndërkombëtare të investimeve njohin zakonisht të drejtat e kombeve sovraane për të marrë masa për mbrojtjen e interesave të tyre themelore të sigurisë dhe rendin publik si pjesë të përjashtimeve. Qeveria shqiptare duhet të përditësojë rrjetin e IIA-ve, duke përdorur formulime të qarta të dispozitave lidhur me rendin publik dhe sigurinë themelore, dhe masat e marra për arsye ekonomike dhe sigurie. Këto masa do të përmirësonin të kuptuarit e rëndësisë së dispozitave dhe do të rrisnin parashikueshmërinë ligjore, dhe me gjasë do t'i shkurajonin aktorët që të nisin procese të gjata arbitrazhi investitor-shtet, si një mekanizëm për të kushtëzuar sjelljen e shtetit. Vendimet e marra për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe rendin publik, dhe nën autoritetin e MSHI-së, mund të bien ndesh me dispozita të ndryshme të IIA-ve, përfshirë trajtimin e drejtë dhe të barabartë, trajtimin kombëtar dhe detyrimet e kombit më të favorizuar. Gjuha e përjashtimeve në IIA lidhet po ashtu me vendimet e marra për një MSHI të ardhshme.

Duke pasur si objektiv kryesor promovimin dhe tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në sektorët e konsideruar strategjikë, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 55/2015 *“Për investimet strategjike”* (“Ligji

55/2015”), i cili hyri në fuqi më 1 janar 2016. Për të rritur investimet strategjike vendase dhe të huaja në sektorë strategjikë, ligji krijoi procedura administrative të posaçme që favorizonin, lehtësonin ose përshpejtonin mbështetjen dhe shërbimet për investitorët që marrin kualifikimin si investitorë strategjikë. Përcaktimi i statusit të investitorit strategjik kushtëzohet nga vlera ekonomike e investimit dhe numri i vendeve të punës të krijuara në sektorë specifkë. Organi vendimmarrës për pranimin ose refuzimin e statusit të Investitorit Strategjik është Komiteti i Investimeve Strategjike, një organ administrativ kolegial pranë Këshillit të Ministrave, të cilin e kryeson Kryeministri dhe anëtarët e të cilit përfshijnë Zëvendës Kryeministrin, shtatë ministra dhe Avokatin e Shtetit. Institucioni më i rëndësishëm për zbatimin e këtij ligji është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). AIDA shërben si një “dritare unike” për t'u ofruar shërbime investitorëve që aplikojnë dhe kërkojnë të përfitojnë nga statusi i Investitorit Strategjik. Ligji 55/2015 ka mbështetur kryesisht investitorët vendas, ndërsa investitorët e huaj kanë treguar interes të kufizuar për incentivat e dhëna nga ligji. Fillimisht, Ligji 55/2015 ishte parashikuar si një regjim i përkohshëm dhe afatshkurtër, por efektshmëria e tij është rritur vazhdimisht dhe me ndryshimet e fundit, është planifikuar që të mbetet në fuqi deri në fund të vitit 2024. Megjithëse u miratua me shpresa të mëdha për sa u përket investimeve të huaja, Ligji 55/2015 nuk e ka realizuar ende potencialin e tij të plotë. Nuk është e qartë nëse ligji nuk i përmbushi pritshmëritë lidhur me investimet e huaja direkte. Nga ana tjetër, marrja e statusit të investitorit strategjik nga investitorët vendas pranë strukturës së pushtetit të partisë drejtuese ka sjellë hetime mbi procedurat dhe ka ngjallur debat publik.

Shqipëria po përdor gjerësisht PPP-të për të financuar projekte të mëdha infrastrukturore, që, sipas përlllogaritjeve më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), arrijnë deri në 40 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2022. Këto investime jo vetëm që përbëjnë një formë të borxhit të fshehur, por ngrenë edhe pikëpyetje për origjinën e financimit. FMN-ja ka vlerësuar ndikimin e projekteve ekzistuese dhe të atyre në proces, si dhe ndikimin e tyre në buxhet dhe financat publike për shkak të riskut financiar. FMN-ja ka shprehur edhe shqetësime lidhur me pikat e dobëta të kuadrit menaxhues dhe koordinues të PPP-ve. Një risk tjetër lidhur me PPP-të është ai i origjinës ose natyrës së investitorëve. Në disa PPP, subjektet e juridiksioneve të huaja kanë përfituar nga manteli mbrojtës i

korporatës dhe avantazhet e tjera rregullatore për origjinën e investitorëve duke iu shmangur ligjeve penale dhe tatimore vendase. Aktualisht ato janë nën hetim nga agjencitë ligjzbatuese shqiptare. Për të trajtuar nevojat infrastrukturore, Shqipëria duhet të marrë në konsideratë krijimin e institucioneve, si fondi sovran i pasurive që duhet të menaxhojë më mirë asetet shtetërore dhe të zbatojë investime afatgjata.

Për trajtimin e disa mangësive rregullatore në legjislacionin vendas, më 27 janar 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 6/2022 “Për ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues” (“Ligji PVP”)), në fuqi prej 2 marsit 2022. Ndryshimet rritën numrin e subjekteve që kanë detyrim të regjistrohen në regjistrin e PVP-ve duke shtyrë afatin e regjistrimit, dhe duke futur regjistrimin e njëkohshëm të PVP-ve së bashku me themelimin e subjektit të detyruar, si dhe rritën disa penalitete në rastin e mospërmbushjes së kërkesave ligjore. Ligji nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues” (piketa 1) përmbush një nga rekomandimet e MONEYVAL.¹⁶² Ligji përfshin pjesërisht Direktivën e BE-së 2015/849 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit. Ekspertët vendas të intervistuar dhe të pyetur për PVP-të vlerësuan progresin në këtë fushë dhe shprehën dyshime lidhur me nevojën për reforma të mëtejshme në këtë fushë.

Rekomandime

- Vendimet e marra në përputhje me ligjin për MSHI-në ka gjasa të bien ndesh me dispozitat e IIA-ve, si për shembull trajtimi kombëtar, trajtimi i kombit më të favorizuar, dhe trajtimi i drejtë dhe i barabartë. Për të ulur riskun për arbitrazhin ndërmjet investitorit dhe shtetit, rekomandohet përditësimi i gjuhës së Marrëveshjeve Dypalëshe të Investimeve me

qëllim marrjen në konsideratë dhe mbrojtjen më të mirë të së drejtës sovraane të shtetit për të nxjerrë ligje dhe për të marrë vendime në fusha të ndjeshme, si siguria kombëtare, siguria energjetike dhe mjedisi.

- Në rastin e kontratave të prokurimit publik dhe të PPP-ve në veçanti, edhe FMN-ja ka nxjerrë në pah nevojën për të dyfishuar përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të luajtur një rol efektiv kontrollues në përzgjedhjen e projekteve dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në vlerësim dhe monitorim.¹⁶³
- Në kontekstin e problemeve të mëdha dhe shumëdimensionale lidhur me PPP-të, rekomandohet që të vlerësohet përdorimi i modeleve të tjera, si përdorimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe i mjeteve të tjera sovraane të investimeve, kapitaleve dhe fondeve sovraane të pasurisë.
- Ndërmarrjet e reja shtetërore ose fondet sovraane të pasurisë duhet të mësojnë nga përvojat e homologëve të tyre në lidhje me qeverisjen e korporatave duke u mbështetur te parimet ndërkombëtare dhe institucionet ndërkombëtare, si Udhëzimet e OECD-së për Qeverisjen e Korporatave të Ndërmarrjeve Shtetërore, Parimet e Santiagos dhe Forumi Ndërkombëtar i Fondeve Sovraane të Pasurisë. Fondet sovraane të pasurisë mund të angazhohen në mënyrë efektive për të përfshirë fonde të tjera në projektet e investimeve të përbashkëta. Këta lloj investitorësh kanë një horizont më të gjatë investimesh dhe ndonjëherë priren të veprojnë si aktorë ekonomikë përgjegjës.

162 Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit - MONEYVAL është një organ monitorues i përhershëm i Këshillit të Evropës, që i është ngarkuar detyra për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare kryesore për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të efektshmërisë së zbatimit të tyre, si dhe me detyrën për të dhënë rekomandime për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre. Nëpërmjet një procesi dinamik të vlerësimeve reciproke, rishikimit nga kolegët dhe ndjekjes së rregullt të raporteve të tij, MONEYVAL synon të përmirësojë kapacitetet e autoriteteve kombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në mënyrë më efektive. <https://www.coe.int/en/web/moneyval/moneyval-brief>.

163 2022, Konsultim për nenin IV—Deklaratë për shtyp; Raport i staftit; dhe Deklarata nga Drejtori Ekzekutiv për Shqipërinë

07

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: REKOMANDIME

Financat politike dhe zgjedhore

- Duhet të propozohen rregullime ligjore (ligje dhe akte nënligjore) për të trajtuar çështjen e zhvillimit të fushatës nga palë të treta/jogarues, përfshirë reklamat digjitale me pagesë. Këto rregullime ligjore duhet të përshtaten për të shmangur kufizimin e parregullt të lirisë legjitime të shprehjes.
- Duhet t'i kushtohet vëmendje parandalimit të personave juridikë për të shërbyer si kanale për financimet e huaja. Mënyra më e drejtpërdrejtë për ta ulur këtë mundësi për ndërhyrje të huaja do të ishte ndalimi i dhurimeve politike dhe i shpenzimeve zgjedhore nga këto subjekte. Mund të jetë e dobishme që të konsultohen autoritete rregullatore të financimit të partive politike në vende evropiane ku janë miratuar këto ndalime, për të përcaktuar nëse kanë sjellë pasoja ose probleme të paqëllimshme.
- Aktualisht, ligji trajton vetëm ndihmën/dhurimet “e huaja” për partitë dhe kandidatët. Ai nuk i ndalon personat/subjektet e huaja për të bërë shpenzime në lidhje me zgjedhjet. Ky përjashtim duhet të rregullohet me ndryshime ligjore dhe ligji duhet të përfshijë një përkufizim se çfarë do të thotë termi “subjekt i huaj”. Gjithashtu, ligji duhet të përcaktojë se çfarë quhet “dhuratë” ose “ndihmë”.
- Për të rritur parandalimin, ligji duhet ta bëjë të paligjshëm inkurajimin/nxitjen e dhurimeve të huaja/shpenzimeve për fushata dhe duhet të përfshihet si vepër penale në Kodin Penal.
- KQZ-ja duhet të marrë në konsideratë ndryshimin e deklaratave të dhuruesve për t'u kërkuar atyre që të pohojnë se po e bëjnë dhurimin nga fondet e veta dhe jo në emër të dikujt tjetër.
- Po ashtu, rekomandohet ndryshimi i ligjit për të rritur sanksionet për financimin ose lejimin e përdorimit të emrit si dhurues fiktiv.
- Do të ishte e vlefshme që të shqyrtoheshin alternativat për lidhjen e bazës së të dhënave të dhuruesit të KQZ-së me bazat e tjera përkatëse publike të të dhënave për të sinjalizuar situatat e dhuruesve fiktivë.
- Ligji për partitë politike dhe Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohen për të ndaluar transaksionet në kriptomonedha në lidhje me dhurimet politike dhe shpenzimet e partive/zgjedhore. Kuvendi duhet të miratojë legjislacion gjithëpërfshirës dhe të qartë që përputhet me qëllimin e ndalimit të parave të huaja që futen në procesin zgjedhor, mbështetur në përvojën dhe pikëpamjet e institucionit(-eve) mbikëqyrës (-e), organizatave të shoqërisë civile dhe atyre që do të rregullohen me ligj.
- Institucionet mbikëqyrëse kanë nevojë për burime të mjaftueshme (njerëzore, financiare dhe teknike) për të ndërmarrë veprime këshillimore, mbikëqyrëse dhe zbatuese me qëllim që të kuptohen dhe zbatohen rregullat që ndalojnë financimet e huaja
- Rregullat duhet të ofrojnë transparencë për paratë e përdorura në lidhje me zgjedhjet për të siguruar që publikimi i të dhënave financiare të bëhet në mënyrë të tillë që të shkarkohen dhe të lexohen elektronikisht, dhe që informacioni të vihet në dispozicion të publikut në kohë.

- Të gjitha institucionet e përfshira në mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave që parandalojnë financimet e huaja (p.sh., Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, institucionet kundër pastrimit të parave dhe gjykatat) duhet të punojnë së bashku dhe të tregojnë vullnet politik për zbatimin e ligjit kundër financimeve të huaja.
- Të rivlerësohen kërkesat e KQZ-së për burime njerëzore dhe teknike për të përfshirë sfidat e rregullimit të shpenzimeve të palëve të treta, reklamat në mediat sociale dhe forcimin e ndalimeve të burimeve të huaja të financimit.
- Të merret parasysh krijimi i një grupi pune ndërinstitutional që synon financimin e huaj të partive politike dhe shpenzimet për zgjedhje.

Manipulimi i mjedisit të informacionit dhe siguria kibernetike

- Shqipëria duhet të harmonizojë kuadrin ligjor me Aktin evropian për lirinë e medias, Aktin për shërbimet digjitale dhe Standardet e Këshillit të Evropës për lirinë e medias dhe të shprehjes, si dhe të zbatojë rekomandimet e Komisionit të Venecias. Më konkretisht, ndryshimet ligjore dhe rregullatore, që duhet të kryhen me transparencë të plotë dhe nëpërmjet një procesi konsultimi të rregullt me organizatat e medias, komunitetin gazetaresk, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, duhet të përfshijnë aspekte kyçe, si:
- Mediat audiovizive duhet të bëjnë publike identitetet e pronarëve përfitues, si dhe të personave që kontrollojnë ose përfitojnë nga shoqëria tregtare, me qëllim parandalimin e ndikimit të fshehur ose konflikteve të interesit.
- Informacioni për pronësinë duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm për publikun nëpërmjet bazave të të dhënave ose regjistrave të mediave, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.
- Mediat audiovizive duhet të bëjnë të ditur burimet e financimit, duke përfshirë çdo marrëdhënie financiare me partitë politike, qeveritë, ose subjektet e huaja, për të siguruar pavarësi dhe për të parandaluar ndikimet e papërshtatshme.
- Të ngrihen mekanizma për auditimin dhe verifikimin e rregullt të informacionit për pronësinë nga organe të pavarura, për të siguruar pajtueshmëri dhe saktësi.
- Sa u përket mediave online, Shqipëria duhet t'u përmbahet rekomandimeve të Komisionit të Venecias¹⁶⁴ për forcimin e vetërregullimit dhe më konkretisht:
- Të mbështetet ngritja dhe fuqizimi i një organi vetërregullator të pavarur dhe funksional, të aftë për të garantuar një sistem efektiv dhe të respektuar për llogaridhënien e mediave në fushën e mediave online.
- Të mbështeten dhe nxitën nismat si Nisma për Besimin te Gazetaria (NBG), që përcakton standarde konkrete për transparencën, duke përfshirë zbulimin e pronësisë, që organizatat e mediave online mund ta zbatojnë për të përmirësuar besimin e publikut.
- Të mbështeten përpjekjet e aktorëve të shoqërisë civile për hetimin dhe ekspozimin e lidhjeve ndërmjet pronarëve të mediave dhe interesave të tyre të tjera të biznesit, si dhe të zbatohen masat mbrojtëse për sinjalizuesit që ekspozojnë pronësitë e fshehta ose konfliktet e interesit në organizatat e medias, për të nxitur transparencën dhe llogaridhënien.
- Vendimmarrësit në Shqipëri duhet të bëjnë përpjekje konkrete në drejtim të përafrimit të legjislacionit me Aktin Evropian të Shërbimit Digjital dhe Aktin për Lirinë e Medias si një qasje e përshtatshme kur bëhet fjalë për ndryshimet e mundshme ligjore për trajtimin e dezinformimit.
- Të prioritetizohet zhvillimi i kapaciteteve për departamentet e TI-së në institucionet kyç që punojnë me të dhëna delikate, veçanërisht AKCESK, AKSHI, agjencitë ligjzbatuese, Regjistri Kombëtar i Biznesit dhe të tjera.

- Të kryhet hartëzimi i funksioneve të shërbimit civil me akses te të dhëna delikate ose tek infrastruktura kritike dhe të hartohet një plan integriteti i posaçëm për këto pozicione, duke përfshirë një program specifik për zhvillimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e procedurave dhe infrastrukturave ekzistuese.
- Të vijohet me kërkimin e ndihmës dhe lidhjen e marrëveshjeve të partneritetit me vendet me siguri të lartë kibernetike, veçanërisht për ngritjen e kapaciteteve ligjzbatuese.
- Të ngrihen kapacitetet e shoqërisë civile dhe redaktorëve mediatikë sa i përket trajtimit dhe raportimit të të dhënave personale të marra nëpërmjet sulmeve kibernetike.
- Të priorizohen programet edukuese për sigurinë kibernetike dhe K&ZH në sektor nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe sektorit privat.
- Të përmirësohen aftësitë ripërtëritëse kibernetike të mediave, gazetarëve, mbikëqyrësve, aktivistëve dhe individëve të tjerë për të garantuar llogaridhënien e personave në pushtet.

Flukset e kapitalit gërryes

- Nevojitet hartimi i një ligji të ri, që parashikon ngritjen e një mekanizmi për shqyrtimin e investimeve me përkufizime të qarta të: a) sigurisë kombëtare; b) infrastrukturës kritike; c) teknologjive kritike dhe objekteve me përdorim të dyfishtë; d) aksesit ose aftësisë për të kontrolluar informacione delikate dhe; e) lirisë dhe pluralizmit të medias.
- MSHI-ja krijon një pushtet diskrecional të konsiderueshëm, që i akordohet një autoriteti të caktuar. Nëse ekzekutivi kontrollon MSHI-në, atëherë ka gjasë që partia qeverisëse të përfitojë pushtet dhe diskrecion shtesë. Për këtë arsye, duhet që, gjatë hartimit të legjislacionit për MSHI-në, të ruhet balanca ndërmjet ndikimit të pushtetit ekzekutiv duke përfshirë autoritetin e grupeve të interesit, si komuniteti i biznesit, në procesin e vendimmarrjes.
- Ligji duhet të marrë parasysh edhe ndikimin e investimeve të caktuara te konkurrenca e tregut. Në disa sektorë, vlerësimi do të paraqesë pengesa të konsiderueshme për shkak të teknologjive të avancuara të përdorura në disa projekte investimi dhe mungesës së transparencës sa i përket natyrës së investitorëve pjesëmarrës në projekt. Për të trajtuar këto pengesa, ligji i ri duhet të mundësojë bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe efektiv ndërmjet MSHI-së shqiptare dhe MSHI-së në rajon dhe në BE. Në këtë këndvështrim, Rregullorja e BE-së 2019/452 parashikon ngritjen e një platforme për bashkëpunim, që do të shtrihet tek autoritetet e BE-së dhe shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s.
- Reforma e Ligjit shqiptar për investimet e huaja duhet të marrë parasysh edhe nevojën për koordinimin me mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Ligji duhet të pengojë aksesin tek arbitrazhi investor-shtet për vendimet e marra në kuadër të mbrojtjes së sigurisë kombëtare në përputhje me parashikimin e shqyrtimit të MSHI-së.
- Vendimet e marra në përputhje me ligjin për MSHI-në ka gjasa të bien ndesh me dispozitat e IIA-ve, si për shembull trajtimi kombëtar, trajtimi i kombit më të favorizuar, dhe trajtimi i drejtë dhe i barabartë. Për të ulur riskun për arbitrazhin ndërmjet investorit dhe shtetit, rekomandohet përditësimi i gjuhës së Marrëveshjeve Dypalëshe të Investimeve me qëllim marrjen në konsideratë dhe mbrojtjen më të mirë të së drejtës sovrane të shtetit për të nxjerrë ligje dhe për të marrë vendime në fusha të ndjeshme, si siguria kombëtare, siguria energjetike dhe mjedisi.
- Në rastin e kontratave të prokurimit publik dhe të PPP-ve në veçanti, edhe FMN-ja ka nxjerrë në pah nevojën për të dyfishuar përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të luajtur një rol efektiv kontrollues në përzgjedhjen e projekteve dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në vlerësim dhe monitorim.

- Në kontekstin e problemeve të mëdha dhe shumëdimensionale lidhur me PPP-të, rekomandohet që të vlerësohet përdorimi i modeleve të tjera, si përdorimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe i mjeteve të tjera sovrane të investimeve, kapitaleve dhe fondeve sovrane të pasurisë.
- Ndërmarrjet e reja shtetërore ose fondet sovrane të pasurisë duhet të mësojnë nga përvojat e homologëve të tyre në lidhje me qeverisjen e korporatave duke u mbështetur te parimet dhe institucionet ndërkombëtare, si Udhëzimet e OECD-së për Qeverisjen e Korporatave të Ndërmarrjeve Shtetërore, Parimet e Santiagos dhe Forumi Ndërkombëtar i Fondeve Sovrane të Pasurisë. Fondet sovrane të pasurisë mund të angazhohen në mënyrë efektive për të përfshirë fonde të tjera në projektet e investimeve të përbashkëta. Këta lloj investitorësh kanë një horizont më të gjatë investimesh dhe ndonjëherë prirjen të veprojnë si aktorë ekonomikë përgjegjës.

SHTOJCA 2: STOKU I IHD-VE¹⁶⁵

	PËRSHKRIMI I INDEKSIT	TREMUJORI I 2023 - NË MILIONË EURO
	Detyrimet gjithsej të IHD-ve	11,725
1	Vendet e Ulëta	1,945
2	Zvicra	1 914
3	Kanadaja	1,491
4	Italia	1,256
5	Turqia	877
6	Austria	738
7	Bullgaria	725
8	Franca	460
9	Gjermania	323
10	Hungaria	300
11	Qipro	241
12	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	238
13	Të tjera për qëllime konfidenciale	229
14	Kosova	225
15	Greqia	217
16	Mbretëria e Bashkuar	120
17	Libani	92
18	Maqedonia e Veriut	78
19	Serbia	45
20	Sllovenia	42
21	Republika Çeke	40
22	Polonia	37
23	Emiratet e Bashkuara Arabe	30
24	Organizata Ndërkombëtare	28
25	Luksemburgu	26
26	Panamaja	22
27	Belgjika	19
28	Kroacia	18
29	Bosnja dhe Hercegovina	11
30	Norvegjia	10
31	Rumania	7
32	Kina	6
33	Egjipti	6
34	Spanja	6
35	Izraeli	3
36	Mali i Zi	3
37	Japonia	0
38	Kuvajti	-11
39	Ishujt Kajman	-31
40	Ishujt e Virgjër (Britanikë)	-60

165 Detajim i autorit të të dhënave të Bankës Qendrore të Shqipërisë.

SHTOJCA 3: TREGTIA – MALLRAT E IMPORTUAR¹⁶⁶

		2019	2020	2021	2022
1	Italia	164188132320	151977595145	194442667769	205878480181
2	Turqia	61798320418	57943017052	86104198961	114616505451
3	Kina	59727400785	54038084268	65201986390	77476282403
4	Greqia	54335541139	54453545102	64024209022	74469117872
5	Gjermania	46481728211	46600998174	54952339719	58563057785
6	Arabia Saudite	581033644	440311926	11018530597	33693808881
7	Serbia	23053025350	22971334399	28030655762	32196575705
8	Zvicra	15337279666	10228063606	12743025809	21520005934
9	Polonia	10558762769	10307407469	12387364677	16616614306
10	Kosova	7734718299	8305297218	15441315934	16604265837
11	Spanja	11533678798	9787749017	11520524352	16340438856
12	Maqedonia e Veriut	8570961294	9074174364	13674706721	15483118251
13	Franca	13027095625	11837723800	12779883600	14094403100
14	Shtetet e Bashkuara	12337672756	9400846253	14570394628	13072680945
15	Rumania	8231211350	5873907086	7262080116	12130001207
16	Sllovenia	6837108154	4698130386	5362339228	12063411903
17	Bullgaria	8201890444	7616942824	10121117978	11169207723
18	Rusia	11617088516	13513114488	15036667744	10925711725
19	Algjeria	533584051	2358231593	7136970577	10735157291
20	Kroacia	7219366355	6143394821	7899170395	10582784371
21	R. Çeke	7413208164	6707902506	8400607428	9473676579
22	Vendet e Ulëta	6252337374	6418115222	7701349888	8736146033
23	India	4541442915	4675004531	6563188859	8376827467
24	Koreja e Jugut	2666621808	3630688602	6094799709	7545389515
25	Mbretëria e Bashkuar	5640534754	5124576521	6538085965	7405162849
26	Belgjika	4321186166	4701758934	7364547516	6954766544
27	Azerbajxhani	71088936	479588978	2566716711	6904624741
28	Austria	6830021219	5832051508	6971483487	6896245507
29	Hungaria	4054166460	4215320608	5457664518	5974563354
30	Izraeli	6374286813	1948776840	4141207191	5820877029

166 Detajim i autorit, Instituti Shqiptar i Statistikave.

CËNUESHMËRIA E POLITIKËS SHQIPTARE NGA NDËRHJRJET E HUAJA



Qershor 2024